



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 26

Tiranë – E hënë, 20 shkurt 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 81, datë 14.2.2023	2389
Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023– 2025 dhe të planeve të veprimtimit 2023–2025.....	



VENDIM
Nr. 81, datë 14.2.2023

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË
NDËRSEKTORIALE PËR
PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT TË
DHUNSHËM DHE LUFTËN KUNDËR
TERRORIZMIT 2023–2025 DHE TË
PLANEVE TË VEPRIMIT 2023–2025**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe të planeve të veprimit 2023–2025, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 930, datë 18.11.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit”, dhe vendimi nr. 1137, datë 16.12.2020, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit, 2021–2025 dhe planit të veprimit 2021–2023”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, ministritë dhe institucionet përgjegjëse, të përmendura në tekstin e kësaj strategjie dhe planeve të veprimit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

**STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE
PËR PARANDALIMIN E EKSTREMIZMIT
TË DHUNSHËM DHE LUFTËN KUNDËR
TERRORIZMIT DHE PLANET E VEPRIMIT
2023–2025**

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtimeve

Përkufizime

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrje

Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe

luftën kundër terrorizmit 2021–2025 dhe lidhja me dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare

Metodologjia

1.1 Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

1.1.1 Kuadri ligjor

1.1.2 Instrumentet ligjore ndërkombëtare

1.1.2.1 Konventat dhe protokollet ndërkombëtare

1.1.2.2 Marrëveshje dypalëshe në fushën e luftës kundër terrorizmit

1.1.2 Kuadri institucional

2.1 Arritjet dhe mësimet

2.2.1 Analiza e situatës

2.2.2 Faktorët e riskut dhe kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi në Shqipëri

2.2.3 Dënimet

2.2.4 Masat e marra në luftën kundër terrorizmit

2.2.5 Financimi i terrorizmit

2.2.6 Të dhëna nga raporte ndërkombëtare për situatën e Shqipërisë në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin

2.2.7 Drejtimet kryesore që do të trajtohen në këtë strategji

3.1 Vizioni i Strategjisë

3.1.1 Vizioni

3.1.2 Misioni

3.1.3 Indikatorët e impaktit dhe indikatorët e rezultatit

PJESA II. QËLLIMI I STRATEGJISË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE

QASJA 1. PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT

QËLLIMI I POLITIKËS 1: MBAJTJA E KËRCËNIMIT TERRORIST NË NIVEL “TË ULËT”

Objektivi specifik 1.1: Parandalimi i terrorizmit

Objektivi specifik 1.2: Parandalimi i financimit të terrorizmit

Objektivi specifik 1.3: Intensifikimi i masave për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individ të dyshuar për vepra me qëllime terroriste

Objektivi specifik 1.4: Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të agjencive inteligjente, ligjzbatuese për parandalimin e ekstremizmit të



dhunshëm dhe në luftën kundër terrorizmit në vend dhe me shërbime homologe/partnere

QËLLIMI I POLITIKËS 2. NDËRPRERJA E AKTIVITETEVE NË FAQET DHE PLATFORMAT DIGJITALE QË TËRHEQIN INDIVIDË NË TERRORIZËM.

Objektivi specifik 2.1: Parandalimi i radikalizimit nëpërmjet internetit

Objektivi specifik 2.2: Rritja e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë darknet-in

Objektivi specifik 2.3: Parandalimi i radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar dhe me prodhuesit e aplikacioneve online

QËLLIMI I POLITIKËS 3: NJOHJA E KËRCËNIMEVE TË TERRORIZMIT NË VENDIN TONË PËRMES IDENTIFIKIMIT TË HERSHËM TË GRUPEVE TË SYNUARA DHE METODAVE RADIKALE

Objektivi specifik 3.1: Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm

QËLLIMI I POLITIKËS 4: ZGJERIMI I KAPACITETEVE OPERACIONALE TË POLICISË DHE KAPACITETEVE TË INSTITUCIONEVE TË INTELIGJENCËS

Objektivi specifik 4.1: Rritja e parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin.

QËLLIMI I POLITIKËS 5: ZHVILLIMI I KOMUNIKIMIT STRATEGJIK

Objektivi specifik 5.1: Shkëmbimi i përvojës dhe ekspertizës me vendet e rajonit

Objektivi specifik 5.2: Krijimi i një rrjeti komunikimi të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të përfshira me qëllim krijimin e mekanizmave për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Objektivi specifik 5.3: Komunikimi strategjik dhe kundërnarrativa online e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

QASJA 2. HETIMI I VEPRAVE TË TERRORIZMIT, ZBULIMI DHE GODITJA E TERRORISTËVE/GRUPEVE TERRORISTE DUKE ELIMINUAR KËRCËNIMET E TERRORIZMIT

QËLLIMI I POLITIKËS 6: IDENTIFIKIMI, HETIMI, ZBULIMI E VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E TERRORIZMIT DHE FINANCIMIT TË TIJ DHE GODITJA E INDIVIDËVE GRUPEVE TERRORISTE

Objektivi specifik 6.1: Hetimi i terrorizmit dhe burimeve të tij

Objektivi specifik 6.2: Bashkëpunimi dhe koordinimi me agjencitë inteligjente e ligjzbatuese dhe institucione që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit.

Objektivi specifik 6.3 Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve njerëzore, profesionale e logjistike të strukturave të antiterrorit.

QËLLIMI I POLITIKËS 7: PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË MBLEDHJES, RUAJTJES, ANALIZIMIT DHE SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT.

Objektivi specifik 7.1: Krijimi i një sistemi të sigurt të komunikimit për transmetimin e informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit

Objektivi specifik 7.2: Vlerësimi periodik i nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm, si derivate të terrorizmit

Objektivi specifik 7.3 Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me agjencitë inteligjente dhe ligjzbatuese në vend dhe ato të huaja me përgjegjësi në luftën kundër terrorizmit për përcaktimin e nivelit të kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar modus operandi dhe ndikimit të tij në Shqipëri

Objektivi specifik 7.4: Sigurimi i informacionit për terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, sabotazhin dhe Armët e Dëmtimit në Masë dhe informimi i institucioneve vendimarrëse, politikëbërëse, institucioneve dhe strukturave të tjera kompetente/përgjegjëse shtetërore dhe të zbatimit të ligjit

Objektivi specifik 7.5: Konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me: strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit; institucionet e sistemit të sigurisë kombëtare; shërbimet inteligjente të vendeve aleate dhe partnere

QASJA 3. REAGIMI, REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI

QËLLIMI I POLITIKËS 8: REAGIM NËPËRMJET FORCIMIT TË KAPACITETEVE TË INSTITUCIONEVE PËRKA-



TËSE PËR TËNË PËRNGJIGJUR SULMEVE TERRORISTE

Objektivi specifik 8.1: Konsolidimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile, në nivelin qendror dhe atë lokal

QËLLIMI I POLITIKËS 9: REAGIM NËPËRMJET REDUKTIMIT DHE LEHTËSIMIT TË PASOJAVE TË FENOMENEVE TË RADIKALIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT

Objektivi specifik 9.1: Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e dhënies së ndihmës viktimave të terrorizmit sipas konventës evropiane për kompensimin e viktimave të terrorizmit

Objektivi specifik 9.2: Përmirësim i infrastrukturës dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve publike rehabilitimin dhe riintegrimin për personat e radikalizuar ose të kthyerit nga zonat e konfliktit

Objektivi specifik 9.3: Fuqizimi ekonomik i personave të radikalizuar dhe familjeve të kthyer nga vendet e luftës përmes integritit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim

Objektivi specifik 9.4: Rritja e aksesit të personave të riintegruar dhe të kthyer nga vendet e luftës në programet e strehimit social

QËLLIMI I POLITIKËS 10: PËRGATITJA PËR MENAXHIMIN E INCIDENTEVE TERRORISTE QË PËRFSHIJNË PËRDORIMIN E MATERIALEVE KIMIKE, BIOLOGJIKE, RADIOLOGJIKE, BËRTHAMORE DHE EKSPLOZIVE (CBRNE)

Objektivi specifik 10.1: Reagimi i shpejtë sipas protokolleve ndërkombëtare ndaj incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRNE)

QASJA 4. MBROJTJA

QËLLIMI I POLITIKËS 11: RITJJA E NIVELIT TË SIGURISË NË FUSHËN E TRANSPORTIT, TREGTISË, SHKËMBIMIT TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

Objektivi specifik 11.1: Reduktimi i rreziqeve që rrjedhin nga transferimet e ndaluara të mjeteve dhe materialeve që mund të përdoren për të kryer një sulm apo akt terrorist

Objektivi specifik 11.2: Rritja e aftësive për të zbuluar aktivitetin terrorist duke përfshirë kontrollin dhe mbrojtjen e materialeve kimike,

biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRNE) **QËLLIMI I POLITIKËS 12: RITJJA E NIVELIT TË RUAJTJES DHE MBROJTJES SË INFRASTRUKTURËS KRITIKE**

Objektivi specifik 12.1: Hartimi i planeve të bashkëpunimit midis strukturave ligjzbatuese dhe institucioneve përgjegjëse që kanë në administrim infrastrukturën kritike të vendit për parandalimin e akteve të mundshme terroriste

QËLLIMI I POLITIKËS 13: MBROJTJA NGA KËRCËNIMET TERRORISTE QË CENOJNË VENDDISLO-KIMET/ INFRASTRUKTURËN, PAJISJET KRITIKE DHE SISTEMET E MBROJTJES DHE FARSH-së

Objektivi specifik 13.1: Identifikimi i nevojave dhe standardeve të mbrojtjes nga kërcënimet terroriste

Objektivi specifik 13.2: Konsolidimi i kapaciteteve informative dhe profesionale-operacionale

PJESA III. MASAT PRIORITARE

PJESA IV. ZBATIMI, PËRNGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Implementimi/zbatimi i strategjisë

4.2 Përgjegjësia dhe angazhimet institucionale

4.3 Llogaridhënia dhe raportimi

PJESA V. PLANET E VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

LISTA E SHKURTIMEVE

AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
AAPSK	Agjencia e Administrimit të Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara
ADM	Armë të Dëmtimit në Masë
AISM	Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes
AKSHE	Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve
AKEP	Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
BSH	Banka e Shqipërisë
CBRN	Armë të Shkatërrimit në Masë
QKEDH	Qendra për Koordinimin kundër Ekstremizmit të Dhunshëm
DPB	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DAT	Drejtoria e Antiterrorit
DIH	Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor
DKEF	Drejtoria e Krimit Ekonomiko Financiar
DPD	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
DPKM	Drejtoria e Përgjithshme e Kufirit dhe Migracionit



DPKOKR	Drejtoria e Përgjithshme për Hetimin e Krimin të Organizuar dhe Krimeve të Rënda
DPPPP	Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave
DPRSP	Drejtoria e Përgjithshme e Rendit dhe për Sigurinë Publike
DPPSH	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
DPSHTRR	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
FA	Forcat e Armatosura
FSP	Forca e Sigurisë Portuale
IFB	Instituti i Fizikës Bërthamore
ISIL	Shteti Islamik i Irakut edhe Levantit
FAj	Komanda e Forcës Ajrore
KFD	Komanda e Forcës Detare
KM	Këshilli i Ministrave
KMR	Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
ME	Ministria e Energjisë dhe Industrisë
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MM	Ministria e Mbrojtjes
MB	Ministria e Brendshme
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MZHETTS	Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
PKR	Prokuroria e Krimeve të Rënda
PP	Prokuroria e Përgjithshme
SSK	Strategjia e Sigurisë Kombëtare
SHISH	Shërbimi Informativ i Shtetit
ZMR	Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet
DPSHP	Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës
SHKBB	Shërbimi i Kontrollit të Brendshëm të Burgjeve
QKPK	Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Rinjve dhe të Miturve
SHK	Shkolla e Magjistraturës
SPAK	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar
AS	Akademia e Sigurisë

PËRKUFIZIME

Ekstremizëm i dhunshëm, lidhet me ato besime dhe veprime që mbështesin ose përdorin dhunën e motivuar ideologjike për të ngulitur pikëpamje ideologjike, fetare ose politike radikale tek të tjerët. Ekstremizmi i dhunshëm është ai proces i adoptimit të pikëpamjeve radikale (politike,

ideologjike ose fetare) dhe kthimit të tyre në veprime të dhunshme nëpërmjet kërcënimit, nxitjes, inkurajimit bazuar në baza ideologjike më synimin për të shkaktuar frikë dhe pasiguri.

Faktorët shtytës janë kushtet e favorshme për ekstremizmin e dhunshëm dhe konteksti strukturor nga i cili ai krijohet ku përfshihen: mungesa e mundësive socio-ekonomike; marginalizimi dhe diskriminimi; qeverisja e dobët, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit; konfliktet e zgjatura dhe të pazgjidhura; dhe radikalizimi në burgje.

Faktorët tërheqës janë motivet dhe proceset individuale, të cilat luajnë një rol kyç në transformimin e ideve dhe pakënaqësive në veprime të dhunshme ekstremiste. Këto përfshijnë: motive individuale; pakënaqësitë kolektive dhe viktimizimi që rrjedhin nga dominimi, shtypja, nënshtrimi ose ndërhyrja e huaj; shtrembërimi dhe keqpërdorimi i besimeve, ideologjive politike dhe dallimeve etnike dhe kulturore; lidhshipi dhe rrjetet sociale.

Parandalimi dhe kundërshtimi i ekstremizmi i dhunshëm përfshin ndjekjen e një gamë të gjerë të aktiviteteve nga qeveritë dhe entitete të tjera për të parandaluar radikalizimin, të cilat në përgjithësi përfshijnë mesazhe përmes kanaleve të ndryshme më konvencionale si dhe të mediave sociale; angazhimin dhe përfshirjen e komunitetit përmes të gjitha mjeteve të disponueshme, si tryeza të rrumbullakëta ose diskutimeve të mekanizmave këshillimorë; ngritjen e kapaciteteve, me fokus veçanërisht të rinjtë dhe gratë, së bashku me iniciativat e tjera për zhvillimin, sigurinë dhe mbrojtjen e komunitetit; edukimin dhe trajnimin për një gamë të gjerë aktorësh, duke përfshirë përfaqësues të komunitetit dhe zyrtarët e zbatimit të ligjit.

Radikalizimi i dhunshëm, përbën kërcënim për shoqërinë kur lidhet me dhunën apo veprime të tjera të paligjshme, nëpërmjet metodave jo demokratike për të shkaktuar ndryshime të thella në shoqëri të cilat mund të përbëjnë rrezik për ekzistencën e sigurisë dhe rendit demokratik.

Kundëradikalizimi, tërësia e nismave konkrete shtetërore dhe publike, politikave dhe strategjive me qëllim parandalimin e radikalizimit të individëve dhe grupeve si edhe për ndërprerjen dhe financimin e kryerjes ose planifikimit të kryerjes së akteve të dhunës duke u bazuar në terma



ideologjike, programe sociale, politike, ligjore, arsimore dhe ekonomike të hartuara posaçërisht për t'i frenuar individët e pakënaqur (dhe ndoshta të radikalizuar) që të angazhohen në veprimtari terroriste.

Terrorizëm, akt i qëllimshëm që mund të dëmtojë seriozisht një vend apo një organizatë ndërkombëtare, i kryer me qëllimin shkaktimin e frikës së madhe te popullata, duke detyruar në mënyrë të pandershme një qeveri apo organizatë ndërkombëtare të kryejë apo të mos kryejë një veprim, duke destabilizuar seriozisht apo duke shkatërruar strukturat bazë politike, kushtetuese, ekonomike apo sociale me anë të atentateve ndaj jetës së personit, sulmeve ndaj integritetit fizik të një personi, rrëmbimit, marrjes peng të njerëzve, avionëve apo anijeve, ose me anë të prodhimit, mbajtjes apo transportit të armëve dhe lëndëve shpërthyes.

Kundërterrorizëm, të gjitha masat që synojnë pengimin e akteve terroriste dhe goditjen e organizatave terroriste. Ky koncept përfshin arrestimin e anëtarëve të dyshuar, ndërprerjen e sulmeve terroriste, të rekrutimit, të propagandës, të udhëtimit dhe logistikës së personave të angazhuar në veprimtari me qëllime terroriste, financimin e terrorizmit, mbrojtjen e objektivave të mundshëm nga aktet terroriste, si dhe mbledhjen dhe shkëmbimin e të dhënave/informacioneve në nivel ndërinstytucional dhe me vendet e huaja. Kundërterrorizmi është përgjegjësi kryesore e agjencive ligjzbatuese, agjencive të inteligjencës dhe – në disa raste – shërbimeve të inteligjencës së forcave të armatosura.

Luftëtarë të huaj terroristë, individë të cilët udhëtojnë drejt një shteti që nuk është shteti i tyre, i qëndrimit apo nënshtetësisë, me qëllim kryerjen, planifikimin, përgatitjen apo pjesëmarrjen në akte terroriste ose ofrimin a përfundimin e trajnimit terrorist, qoftë ai edhe në lidhje me një konflikt të armatosur

Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit – tërësia e masave dhe përpjekjeve operacionale si kundërpërgjigje ndaj përhapjes së ideve, mesazheve, ideologjive ekstremiste.

Reagimi ndaj terrorizmit – politika dhe masa efikase dhe efektive për të parandaluar kryerjen e çfarëdo akti terrorizmi dhe për t'iu përgjigjur sulmeve të tilla.

Financimi i terrorizmit – sigurimi dhe grumbullimi i fondeve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të paligjshme dhe më dashje, me synimin për t'u përdorur ose duke ditur se do përdoren plotësisht ose pjesërisht për të kryer vepra terroriste nga një person i vetëm ose organizate terroriste, në shkelje të konventave dhe traktateve kundër terrorizmit.

Hetimi i financimit të terrorizmit – hetimi i veprimtarisë për dhënien, grumbullimin dhe tjetërsimin fondeve, me çdo mjet, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë për të mbështetur veprimtari terroriste.

Raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD), formulari, me anë të të cilit subjektet, sipas përcaktimit të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar, raportojnë tek autoriteti përgjegjës për çdo transaksion dhe aktivitet të dyshimtë. Ky formular plotësohet nga subjektet, për rastet kur e dinë apo dyshojnë se po kryhet, është kryer apo tentohet të kryhet pastrimi i produkteve të veprës penale apo financimi i terrorizmit apo fondet e përfshira rrjedhin nga veprimtari kriminale.

Mbrojtja e infrastrukturës kritike, të gjitha aktivitetet që kanë për qëllim sigurimin e funksionalitetit, vazhdimësisë dhe integritetit të infrastrukturave kritike: sistemet e prodhimit, të transmetimit dhe të shpërndarjes së energjisë; prodhimi, rafinimi, trajtimi, magazinimi dhe shpërndarja e gazit nëpërmjet tubacioneve; nafta dhe prodhimi i produkteve të saj, magazinimi dhe shpërndarja nëpërmjet tubacioneve; telekomunikacioni (rrjetet, sistemet); furnizimi me ujë; bujqësia, prodhimi dhe shpërndarja e ushqimit; shëndeti publik (spitalet, qendrat shëndetësore dhe ambulancat); sistemet e transportit (furnizimi me lëndë djegëse, rrjeti hekurudhor, aeroportet, portet, transporti i brendshëm); shërbimet financiare (bankare, kleringu); shërbimet e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Viktima të terrorizmit, janë persona të cilët kanë pësuar individualisht apo kolektivisht një dëmim në formën e lëndimit fizik apo mendor, vuajtjes psikologjike, humbjes ekonomike apo kufizimit thelbësor të të drejtave të tyre, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të kryera në shkelje të legjislacioneve penale të zbatueshme në shtetet anëtare, duke përfshirë ligjet që parashikojnë krimin



e keqpërdorimit të pushtetit, të shkaktuar nga terrorizmi.

PJESA I: KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrje

Terrorizmi në të gjitha format dhe mënyrën e shfaqjes së tij përbën një kërcënim të përgjithshëm për paqen dhe sigurinë botërore. Fenomeni i terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar është një ndër sfidat më të vështira për të sotmen dhe për të ardhmen. Siguria kombëtare e Republikës së Shqipërisë përfaqëson tërësinë e mjeteve dhe instrumenteve shtetërore që sigurojnë mbrojtjen e qytetarëve, të shoqërisë dhe të shtetit shqiptar nga kërcënimet dhe rreziqet e jashtme e të brendshme. Terrorizmi vazhdon të konsiderohet një kërcënim për sigurinë, si në nivel vendi po ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, duke kërcënuar jo vetëm jetën dhe pronën, por edhe vlerat demokratike dhe vetë mënyrën e jetesës së shoqërisë. Dinamika globale e terrorizmit dhe shtrirja e tij, sidomos gjatë dy dekadave të fundit, ka përfshirë edhe vendin tonë, rajonin, Evropën dhe më gjerë. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë krijon kushte që vendi ynë të synohet si një pikë tranzitimi jo vetëm për trafiket e paligjshme, por dhe për përhapjen e terrorizmit. Shqipëria është ndër vendet e para të renditura në koalicionin kundër terrorizmit, përgjatë viteve ka përmirësuar legjislacionin si dhe ka ngritur kapacitete të reja të specializuara për të adresuar këtë fenomen. Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në përpjekjet e koordinuara të partnerëve të saj strategjikë SHBA dhe BE kundër fenomenit të terrorizmit. Nga viti 2013 vendi ynë ka të miratuar strategjinë kundër terrorizmit e cila përveçse ka krijuar mekanizmat e nevojshëm, ajo ka ofruar edhe një qasje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe goditjen e terrorizmit. Ky është dokumenti strategjik kryesor kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ai garanton vazhdimësinë në menaxhimin e këtij fenomeni dhe ka për qëllim fuqizimin e mëtejshëm të mekanizmave ekzistues, por dhe t'i përshtatet më mirë situatave dhe dinamikave aktuale të kërcënimeve nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi.

Që prej vitit 2014, Shqipëria është anëtare e Koalicionit Global kundër Shtetit Islamik dhe ka ratifikuar një sërë Konventash dhe Rezolutash në këtë drejtim. Shqipëria ka bërë progres në masat parandaluese kundër terrorizmit, radikalizmit dhe

ekstremizmit të dhunshëm, rritjen e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese dhe zhvillimin e politikave efektive në këtë fushë. Qeveria e Republikës së Shqipërisë, duke vlerësuar kërcënimet dhe pasojat që vijnë nga terrorizmi, që nga viti 2014 ka krijuar në Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Antiterrorit e cila ka për mision dhe detyrë funksionale, parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të autorëve për vepra penale me qëllime terroriste. Shërbimet inteligjente kombëtare dhe ato të mbrojtjes e kanë pjesë të misionit dhe përgjegjësi të tyre sigurimin e informacionit në kohë për parandalimin dhe goditjen e akteve terroriste, ndërsa, që nga viti 2018, është ngritur dhe funksionon Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) e cila ka për mision zhvillimin e kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm shtetërore dhe jo shtetërore të përfshirë në masat kundër ekstremizmit të dhunshëm, me qëllim mbrojtjen e shoqërisë shqiptare nga ky fenomen. Përgjegjësitë e qendrës janë zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm të përfshirë në masat kundër ekstremizmit të dhunshëm, promovimi i vlerave të tolerancës dhe të harmonisë fetare, i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, shtetit të së drejtës dhe demokracisë, si dhe mbrojtja e shoqërisë shqiptare nga ekstremizmi i dhunshëm.

Strategjia Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025 udhëhiqet nga prioritetet e qeverisë shqiptare në fushën e sigurisë dhe programi politik i Këshillit të Ministrave që ka të bëjë me komponentin “*Shqipëria e sigurt*”.

Ky dokument strategjik përfaqëson një vëmendje të shtuar ndaj parandalimit të akteve terroriste, parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet krijimit të komuniteteve dhe institucioneve më të qëndrueshme, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar dhe të të kthyerve nga zonat e konfliktit dhe familjeve të tyre, zhvillimin e një komunikimi strategjik dhe parandalimin e radikalizimit online. Kjo strategji do të shërbejë si instrumenti kryesor për të bashkërenduar ndërveprimin institucional kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit integron dy dimensionet e politikës shtetërore në lidhje me fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm



dhe terrorizmit, ndërsa planet përkatëse të veprimit (pavarësisht se janë dy të ndara) karakterizohen nga parime të harmonizuara, si:

- Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë;
- Parimi i sundimit të ligjit, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut, mosdiskriminimi dhe mbrojtja e të dhënave personale;
- Parimi i konfidencialitetit;
- Parimi i ruajtjes së sigurisë dhe sovranitetit;
- Parimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse kombëtare;
- Parimi i qeverisjes së mirë dhe nxitja e vlerave demokratike;
- Parimi i respektimit të aspekteve multietnike dhe multikulturore të Republikës së Shqipërisë;
- Parimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Qëllimi i Strategjisë Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025 dhe lidhja me dokumente strategjike kombëtare dhe ndërkombëtare

Strategjia Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025 përfaqëson dokumentin themelor kombëtar strategjik sektorial që përcakton **vizionin kombëtar** për krijimin e një shoqërie pa kërcënime terroriste, me imazhin e një vendi të sigurt dhe me standarde evropiane të respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Ky dokument kombinon agjendën kombëtare të integritetit në Bashkimin Evropian që ka të bëjë me përmbushjen e detyrimeve të kapitullit 24 në fushën e luftës kundër terrorizmit, me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit, me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit 2023–2025 inkuadrohet në shtyllën e parë të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet SKZHI, “Mirëqeverisja, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës”, e cila përcakton se vizioni do të arrihet përmes politikave dhe përparësive që synojnë **parandalimin dhe uljen e kërcënimeve terroriste** nëpërmjet:

- rritjes së rezultateve në luftën kundër terrorizmit përmes vendosjes dhe përdorimit të një sistemi efikas të vlerësimit të riskut, shoqëruar me forcimin institucional të njësive të angazhuara në këtë fushë. Rezultatet e pritshme, përfshijnë: i) rritje në numrin e operacioneve që përdorin metoda të

hetimeve speciale; ii) rritje në numrin e operacioneve ndërkombëtare të përbashkëta; dhe ii) rritje në shkallën e zbulimit dhe eliminimit të veprave penale terroriste dhe në hetimin e financimit të terrorizmit;

- ngritjes së një rrjeti të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të angazhuara në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

- rritjes së efikasitetit të hetimeve të krimeve kibernetike me përmbajtje radikaliste, ekstremiste dhe terroriste.

- parandalimit dhe uljes së kërcënimeve terroriste;

- krijimit të një shërbimi inteligjence dhe hetimor bashkëkohor;

- forcimit të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Lidhja me SKZHI e këtij dokumenti është në objektivat si më poshtë:

4.1 Rritja e numrit të hetimeve të veprave penale të lidhura me krimet kibernetike me përmbajtje radikale, ekstremiste dhe terroriste;

4.2 Rritja e numrit të hetimeve të rasteve të abuzimit të të miturve duke nxitur radikalizmin, ekstremizmin e dhunshëm apo terrorizmin përmes internetit;

4.3 Rritja e numrit të hetimeve për parandalimin e krimeve kibernetike;

5.1 Rritja e rezultateve në luftën kundër terrorizmit përmes vendosjes dhe përdorimit të një sistemi efikas të vlerësimit të riskut, shoqëruar me forcimin institucional të njësive të angazhuara në këtë fushë. Rezultatet e pritshme, përfshijnë: i) rritje në numrin e operacioneve që përdorin metoda të hetimeve speciale; ii) rritje në numrin e operacioneve ndërkombëtare të përbashkëta; dhe ii) rritje në shkallën e zbulimit dhe eliminimit të veprave penale terroriste;

5.4 Ngritja e një rrjeti të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të angazhuara në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit.

6.1 Rritja e kapaciteteve hetimore drejt hetimeve të bazuara në informacionin e zbulimit (inteligjencë);

6.3 Rritja e aftësive të Policisë Shkencore, me anë të futjes së teknologjive të reja të cilat do të bëjnë të mundur rritjen e numrit të ekzaminimeve



mjeko-ligjore në procesin e zbulimit dhe identifikimit të provave në vendin e krimit;

7.1 Zbatimi i marrëveshjeve ekzistuese dhe formave të reja të bashkëpunimit të policisë me vendet e rajonit dhe të BE-së; konkretisht përmes rritjes së shkëmbimit të informacionit me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in;

7.2 Rritja e numrit të operacioneve të përbashkëta me EUROPOL-in dhe përdorimi efektiv i mjeteve (programe, platforma, sisteme etj.) të EUROPOL për shkëmbimin e informacionit dhe hetimin e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit;

7.3 Një rritje në numrin e personave në kërkim, të ndaluar/arrestuar për vepra me qëllime terroriste.

Ky dokument strategjik ndërlihet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm përkatësisht me objektivin 16 “*Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i qasjes në drejtësi për të gjithë dhe ndërtimi i institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.*” ku qëllimi i politikave për realizimin e tij është:

16.1 Zvogëlimi i dukshëm i të gjitha formave të dhunës dhe normës së vdekshmërisë;

16.2 Ndalimi i abuzimit, shfrytëzimit, trafikimit dhe të gjitha formave të dhunës dhe të torturës ndaj fëmijëve;

16.a Forcimi i institucioneve kombëtare relevante, duke përfshirë bashkëpunimin ndërkombëtar, për ndërtimin e kapaciteteve në të gjitha nivelet, veçanërisht në vendet në zhvillim, për të parandaluar dhunën ekstremiste dhe për të luftuar terrorizmin dhe krimin.

Qëllimi i hartimit të këtij dokumenti është orientimi i politikave e aktiviteteve dhe forcimi i qasjes gjithëpërfshirëse në parandalimin e fenomeneve që çojnë në terrorizëm, mbrojtjen, hetimin, reagimin ndaj akteve dhe pasojave të akteve të terrorizmit duke synuar rehabilitimin, riintegrimin dhe kompesimin e viktimave që përballen me këto fenomene. Hartimi i kësaj strategjie e cila është në pajtuershtet me strategjinë e BE-së kundër terrorizmit¹, synon harmonizimin e veprimtarisë së strukturave, agjencive dhe institucioneve që kanë përgjegjësi në

parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit.

Parandalimi dhe goditja e terrorizmit vazhdon të mbetet një ndër prioritetet kryesore të institucioneve me përgjegjësi në këtë fushë. Strategjia e re kundër terrorizmit dhe ekstremizmit, si dhe masat e tjera legjislative dhe politike janë të ndërlidhura me Prioritetet e Qeverisë 2021–2025 dhe në Programin e Qeverisë ku një ndër prioritetet kryesore është *rendi dhe siguria publike* duke synuar arritjen e standardit të vendeve të BE-së në këtë fushë. Fokusi i prioriteteve strategjike dhe i veprimit në fushën e rendit dhe sigurisë së brendshme bazuar në Programin e Qeverisë 2021–2025 është:

- forcimi i institucioneve përgjegjëse për rendin dhe sigurinë;

- ndryshimi cilësisht i sistemit të kontrollit të territorit dhe policimit në komunitet në funksion të parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit;

- konsolidimi i bashkëpunimit ndërkombëtar me organizatat e specializuara në luftën kundër krimit;

- ngritja e skuadrave policore mobile të përbashkëta me vendet partnere si mundësi për shkëmbimin e shpejtë të informacionit;

- kryerja e operacioneve të përbashkëta të hetimit penal, mbrojtja më mirë e të dhënave dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë;

- përdorimi i metodave dhe teknologjisë bashkëkohore, dhe aftësimin e mëtjeshëm profesional të strukturave;

- krijimi i sistemeve të përbashkëta dhe të integruara të hedhjes dhe shkëmbimit të të dhënave për hetimin penal dhe inteligjencën.

Gjithashtu ai lidhet edhe me programin e qeverisë për periudhën 2021–2025 “Shqipëria e sigurt” për ashpërsimin e masave në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, në hetimin dhe ndjekjen e aseteve dhe pasurive të paligjshme të lidhura me krimin, duke rritur kapacitetet e strukturave.

Ky dokument ndërlihet me procesin e integritimit evropian dhe si i tillë është pjesë e PKIE-së, kapitulli 24 – Drejtësia, Liria dhe Siguria dhe nënkaptullit – Bashkëpunimi policor, lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmi, bashkëpunimi në çështjet e drogës”.

Strategjia për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit është

¹ Strategjia e KE-së për Antiterrorizmin 2005 dhe Strategjia e KE-së për Antiterrorizmin 2018–2022.



hartuar në harmoni me dokumentet e ngjashme dhe më të rëndësishme ndërkombëtare. Hartimi i kësaj strategjie e cila është në përputhje të plotë me Strategjinë së BE-së kundër terrorizmit në nenet 5, 82 dhe 84, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, ku është parashikuar bashkëpunimi ndërmjet vendit tonë dhe BE-së në fushën kundër terrorizmit, do të bazohet në një qasje me katër komponentë:

- a) Sinjalizimi/parandalimi
- b) Hetimi dhe goditja
- c) Reagimi, rehabilitimi dhe riintegrimi
- d) Mbrojtja

Strategjia bazohet njëkohësisht edhe në Strategjinë e Sigurisë Kombëtare në kuadër të fuqizimit të sigurisë dhe mbrojtjes ku një ndër objektivat kryesorë është ngritja e mekanizmave që garantojnë komunikimin, bashkërendimin dhe bashkëpunimin efektiv ndërinstitucional mes aktorëve kryesorë të sigurisë kombëtare, përmes forcimit të bashkëpunimit dypalësh dhe me institucionet e specializuara rajonale dhe ndërkombëtare për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin, trafiket e paligjshme, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin.

Metodologjia

Strategjia bazohet në konceptin e bashkëpunimit dhe gjithëpërfshirjes së të gjithë aktorëve që mund të kontribuojnë në arritjen e objektivave strategjike dhe që janë profilizuar në këtë drejtim duke u bazuar në analiza, vlerësime dhe veprime konkrete. Kjo qasje nënkupton bashkëpunim të ngushtë dhe shumëdimensional midis institucioneve shtetërore, strukturave private, shoqërisë civile, komunitetit akademiko-shkencor si dhe partnerëve në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtarë, duke promovuar një qasje adekuate ndaj kërcënimit të radikalizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Në këtë strategji përcaktohen objektiva të orientuar në garantimin e sigurisë nëpërmjet promovimit dhe mbrojtjes së vlerave themelore të njeriut të përcaktuara në katër fusha prioritete, si: 1) Parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit; 2) Mbrojtja, zbulimi dhe eliminimi kërcënimeve të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit; 3) Hetimi dhe ndjekja penale e terroristëve, 4) Reagimi operacional i strukturave në rast të një sulmi terrorist si edhe reagimi gjithëpërfshirës i strukturave dhe komunitetit për

rehabilitimin dhe riintegrimin e viktimave të fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Zhvillimi i strategjisë konsideron faktin se kërcënimi i terroristëve, organizatave dhe strukturave terroriste manifestohet si terrorizëm i frymëzuar nga ana fetare, terrorizëm etnik-nacionalist dhe separatist, terrorizëm i krahut të majtë dhe anarkik dhe terrorizëm i djathtë. Elementet kryesore të terrorizmit si një fenomen shoqëror, mund të shfaqen në të gjitha format e manifestimit që përfshijnë dhunën si metodë; nxitja e frikës dhe nxitja e ndryshimeve politike dhe shoqërore; arritja e objektivave të përcaktuara terroriste – detyrimi i qeverisë ose shoqërisë për të marrë ose mos marrë masa konkrete – arritja e objektivave politikë, fetarë ose ideologjikë; një numër i madh i viktimave, të cilat tregojnë spektakolaritetin për të cilin aspirojnë terroristët, si dhe paligjshmërinë dhe papranueshmërinë shoqërore.

Faktorë të rëndësishëm shkaktarë të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit të cilët ndikojnë në fushën dhe dimensionin e veprimtarive terroriste të organizatave terroriste, strukturave terroriste dhe individëve janë të ndryshëm. Këta faktorë fillojnë që nga hendeuku midis pritjeve dhe mundësisë së arritjes së objektivave të grupeve shoqërore në kushtet e ekzistencës sociale, ekonomike dhe ndryshimeve politike, përfshirë tendencat separatiste, por edhe në arritjen e monolitizmit etnik në një fushë të veçantë, aspektet ekonomike, sociale etj., duke evidentuar destabilitetin në sigurinë e komuniteteve dhe shoqërisë. Këto faktorë grupohen në dy kategori kryesore si: faktorë shtytës që i drejojnë individët drejt ekstremizmit të dhunshëm, si: marginalizimi, pabarazia, diskriminimi, persekutimi ose perceptimi i persekutimit, mundësia e kufizuar për arsim cilësor dhe të përshtatshëm, mohimi i të drejtave dhe lirive civile, dhe probleme të tjera mjedisore, historike dhe socialo-ekonomike, dhe faktorë nxitës që ushqejnë tërheqjen ndaj ekstremizmit të dhunshëm, si: ekzistenca e grupeve të mirorganizuara të ekstremizmit të dhunshëm me ligjërime imponuese dhe programe efektive, të cilat ofrojnë shërbime, të ardhura dhe/ose punësim në këmbim të anëtarësisë.

Radikalizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm lidhen me ato besime dhe veprime që mbështesin ose



përdorin dhunën e motivuar ideologjikisht për të ngulitur pikëpamje ideologjike, fetare, politike, nacionaliste etj. Prandaj, ndër të tjera kjo strategji synon të fokusohet edhe në analizimin e faktorëve shtytës dhe tërheqës, duke identifikuar kështu veprime dhe situata që krijohen si pasojë e deformimit të besimeve, për të nxitur individin në ndërmarrjen e veprimeve ekstreme të dhunshme.

Në përcaktimin e objektivave strategjikë, u morën parasysh të gjithë elementët më të rëndësishëm të kësaj metodologjie, faktorët e rrezikut që ndikojnë në zhvillimin e një kërcënimi në rast të shfaqjes së radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm, specifikat me të cilat përballlet Shqipëria në luftën kundër terrorizmit, përfshirë misionin dhe kapacitetet ekzistuese të sistemit të sigurisë në kuptimin më të gjerë, përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat. Aktivitetet konkrete për arritjen e objektivave të kësaj Strategjie do të përcaktohen në Planet e Veprimit për zbatimin e saj, dhe do të drejtohen kryesisht në zbutjen e faktorëve të ndërlikur të rrezikut.

Qasja gjithëpërfshirëse dhe konsolidimi i strukturave të inteligjencës vlerësohet si element thelbësor për suksesin në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, ku të gjitha institucionet veprojnë së bashku në përgjigje të kërcënimeve terroriste duke u fokusuar kryesisht te parandalimi i akteve të tilla. Republika e Shqipërisë do të zhvillojë kapacitetet parandaluese por edhe ato të hetimit, zbulimit, reagimit dhe mbrojtjes nga aktet terroriste, duke rritur bashkëpunimin rajonal dhe ndërkombëtar dhe duke shkëmbyer eksperiencën dhe praktikat për identifikimin dhe parandalimin e akteve duke respektuar edhe standardet dhe praktikatat ndërkombëtare. Kuadri ligjor dhe institucional në fuqi dhe lidhja me dokumentet dhe prioritetet strategjike të këtij dokumenti, përputhet plotësisht me dokumentet strategjike në nivel ndërkombëtar e kombëtar të miratuar nga Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave duke bërë që vizioni, objektivat strategjike dhe specifike e parashikuar të përputhen plotësisht me këta dokumente strategjike. Baza e suksesit të kësaj strategjie është ndjekja dhe zbatimimi nga të gjitha institucionet në të gjitha nivelet (qendrore dhe lokale), duke siguruar dhe duke rritur transparencën, përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien, në lidhje me zbatimin e saj.

Nisma për hartimin e kësaj strategjie të ndryshuar është ndërmarrë nga Ministria e Brendshme si institucion përgjegjës për fushën e rendit dhe sigurisë publike të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme” ku në pikën 3, germa “d” përcaktohet se, Ministria e Brendshme është përgjegjëse për hartimin dhe zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e *antiterrorit dhe ekstremizmit të dhunshëm*.

Pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 604, datë 20.10.2021 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme” lindi nevoja e rikonceptimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 me qëllim integrimin e dimensionit të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në qëllimet e politikave të kësaj strategjie. Me qëllim rishikimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2021–2025 në vijim edhe të kalimit të Qendrës për Koordinimin kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në varësi të Ministrisë së Brendshme me vendimin e Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 737, datë 13.12.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për ngritjen e Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) si institucion varësie i Ministrisë së Brendshme u riorganizua grupi i punës me urdhrin e Ministrit të Brendshëm nr. 73, datë 18.5.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e dokumentit strategjik për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm”. Grupi i Punës u kryesua nga Zëvendësministri i Brendshëm përgjegjës për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm me përfaqësues nga strukturat e Ministrisë së Brendshme si Drejtoria e Përgjithshme për Politikën e Rëndit dhe Sigurisë Publike, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Drejtoria e Rëndit Publik, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Antiterrorit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Agjencia e Mbrojtjes së Vetëqeverisjes Vendore (në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit me pushtetin lokal në realizimin e një sërë masash), në Ministrinë e Brendshme. Në këtë grup pune morën pjesë edhe përfaqësues nga ministritë e linjës dhe



agjencitë/institucionet e pavarura. Si rrjedhim, strategjia është konceptuar bazuar në qasjen ndërinstitucionale, gjithëpërfshirëse, dhe është bazuar në kontributet e ministrive të linjës si Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financës dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Drejtësisë, Ministria për Arsimin dhe Sportin, Ministria për Infrastrukturën dhe Energjinë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme si dhe institucione të tjera ligjzbatuese me rol të rëndësishëm në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, si Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, por edhe institucionet e pavarura si Prokuroria e Posaçme (SPAK), Komiteti Shtetëror për Kultet, Shërbimi Informativ Shtetëror, Banka e Shqipërisë, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, Autoriteti Mediave Audiovizive, Agjencia e Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Banka e Shqipërisë, Shkolla e Magjistraturës, Agjencia e Kombëtare për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike kanë dhënë kontribut të veçantë gjatë procesit të hartimit të kësaj strategjie.

Grupi i Punës ka realizuar detyrat si më poshtë:

- vlerësimin e situatës së ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit në Shqipëri bazuar në analizat e institucioneve dhe raporteve apo studimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke identifikuar objektiva specifike për periudhën 2023–2025;

- vlerësimin e opsioneve për formën e dokumentit strategjik;

- propozimin e masave në planet e veprimit për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit dhe reflektimin e ndryshimeve të kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, sipas fushës së përgjegjësisë institucionale;

- hartimin e drafteve të dokumenteve strategjike me strukturën, anekset përkatëse dhe metodologjinë e hartimit të dokumenteve strategjike sipas sistemit IPSIS;

- kostimin e masave bazuar në Programin Buxhetor Afatmesëm në fuqi dhe në asistencën e

huaj, përmes projekteve të miratuara ose atyre në zbatim;

- përcaktimin e treguesve të performancës së objektivave të dokumenteve strategjike dhe metodologjinë e matjes së tyre, në pasaportën e indikatorëve të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit dhe parandalimit dhe kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm;

- konsultimin e dokumenteve strategjike dhe reflektimin ose argumentimin e komenteve në draftin përfundimtar të tyre.

Në hartimin e këtij dokumenti krahas infrastrukturës ligjore, programeve të ndryshme shtetërore, në analizën për vlerësimin e gjendjes dhe planifikimin e prioriteteve, objektivave dhe përcaktimit të vizionit për të ardhmen, janë marrë në konsideratë edhe gjetjet dhe rekomandimet e progres raporteve të Komisionit Evropian për përmbushjen e detyrimeve të Shqipërisë në kuadër të integritetit në Bashkimin Evropian, komentet dhe konsultimet e zhvilluara me shoqërinë civile dhe organizatat e huaja partnere me fokus çështjet e sigurisë dhe veçanërisht ato të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe antiterrorizmit. Gjithashtu edhe analizat e institucioneve përgjegjëse për monitorimin e strategjisë së mëparshme të cilat kanë kontribuar në mënyrë thelbësore në përcaktimin e problematikave dhe sfidave në ardhmen bazuar në situatën aktuale dhe të pritshme të dinamikave në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit. Si të tilla përmendim analizën e riskut për financimin e terrorizmit nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, SHISH por edhe publikime të organizmave të tjerë si publikimi i raportit të Komitetit të Helsinkit “Bashkë kundër Ekstremizmit Terrorizmit dhe Radikalizmit 2018”, raportit “Radikalizmi i dhunshëm dhe ekstremizmi në Shqipëri (IDM 2015)”, raportet e Departamentit Amerikan të Shtetit, raportet e EUROPOL, raportet e Komisionit Evropian përmes misionit TAIEX mbi kapacitetet në fushën e kundërshtimit të ekstremizmit të dhunshëm, Marrëveshja për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor ndërmjet Komisionit Evropian dhe autoriteteve të Shqipërisë etj. Në kuadër të përfshirjes së praktikave dhe eksperiencave më të mira në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër



terrorizmit koncepti i strategjisë është konsultuar me një sërë organizatash që veprojnë në fushën e sigurisë, si: OSBE-ja, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, IOM në Tiranë, Ambasada e Holandës, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, Partners Albania. Me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Shqipëri u zhvillua më datë 9.12.2022 edhe një takim konsultues me ekspertë të Rrjetit të Ndërgjegjësimit ndaj Radikalizmit – RAN (Radicalization Awareness Network), Komisionit Evropian dhe të Delegacionit të BE për përmirësimin e përmbajtjes së draftit, si edhe integrimin e aspekteve kryesore të politikave të BE në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës ndaj terrorizmit. Komentet dhe sugjerimet e dërguara nga këto organizata kanë kontribuar në hartimin e kësaj strategjie. Drafti është publikuar për konsultim publik edhe në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike në linkun e konsultimit publik <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/507> të publikuar në datën 29.8.2022 dhe ka qëndruar në konsultim deri më datë 26.9.2022 ku ka qenë i disponueshëm për komente nga publiku i gjerë, organizatat e shoqërisë civile dhe çdo aktor i interesuar. Drafti është konsultuar në aspektin e objektivave strategjike kombëtare dhe përputhshmërisë me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim edhe me Agjencinë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

1.1 Kuadri ligjor dhe institucional, arritjet, mësimet

Kjo strategji plotëson detyrimin që rrjedh nga Strategjia e Sigurisë Kombëtare 2016–2020 për hartimin e strategjive sektoriale, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 dhe është komplementare me:

- Strategjinë Ndërsektoriale kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025;
- Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Kufirit 2021–2027;
- Strategjinë e Sigurisë Publike 2021–2025;
- Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë;
- Planin Kombëtar të Veprimit për Integrim Evropian 2021–2023;

- Strategjinë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2021–2025 dhe Planin e Veprimit 2021–2023;

- Strategjinë Ndërsektoriale të Sigurisë në Komunitet 2021–2026 dhe Planin e Veprimit 2021–2023;

- Strategjinë Kombëtare të Arsimit 2021–2026 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj;

- Strategjinë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planin e Veprimit 2020–2025;

- Strategjinë për Edukim Ligjor të Publikut 2019–2023 dhe Planin e Veprimit 2020–2023;

- Strategjinë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2020–2023 dhe Planin e Veprimit në zbatim të saj;

- Planin Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020–2022 dhe Planin e Veprimit për zbatimin e tij;

- Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022 dhe Plani i Veprimit për zbatimin e saj;

- Strategjinë Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe Planin e Veprimit për zbatimin e saj;

- Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025;

- Planin Kombëtar të Veprimit për Personat LGBTI+ 2021–2027;

Bashkërendimi i Strategjisë Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025 me strategjitë e tjera kombëtare e sidomos me atë kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021–2025 etj., është i një rëndësie të veçantë pasi në shumë vende është vërejtur një trend i afrimit të organizatave terroriste me organizatat kriminale. Përmes krimit të organizuar e sidomos pastrimit të parave, terroristëve iu mundësohet të fshehin dhe legjitimojnë produktet e krimit. Trafikimi dhe kultivimi i drogës u ofron terroristëve burim të vlefshëm të të ardhurave të cilat ata i shndërrojnë në fonde për qëllime trajnimit të terroristëve, sigurimin e pajisjeve logjistike dhe teknologjinë, si dhe sigurimin e infrastrukturës së nevojshme.

Për më tepër, Republika e Shqipërisë, si anëtare e koalicionit global kundër DAESH/ISIS dhe më gjerë ka treguar përkushtim dhe njëkohësisht ka marrë përgjegjësi dhe detyrime të caktuara, të cilat janë përfshirë në këtë strategji.

Dokumenti përmban objektivat strategjike dhe objektiva të tjerë specifike për secilën nga shtyllat e



sipërpërmendura. Strategjia do të shoqërohet me planin e veprimit për realizimin e objektivave dhe përcaktimin e mekanizmave implementues dhe koordinues.

1.1.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni shqiptar në fushën e luftës kundër terrorizmit është mjaft i gjerë dhe ka pësuar ndryshime e përmirësime të dukshme, bazuar në legjislacionin ndërkombëtar dhe u diktuar nga situata e terrorizmit në aspektin kombëtar e ndërkombëtar.

Në fushën e terrorizmit, Republika e Shqipërisë ka në zbatim një kuadër të plotë ligjor dhe mekanizma institucionale efektive, të cilat përfshijnë, edhe pse jo shteruese, aktet e mëposhtme:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;

- Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë (ndryshuar me ligjin nr. 36/2017, ligjin 89/2017) ku në nenin 28 të të cilit “Forma të veçanta të bashkëpunimit”, në pikën 2, jepet përkufizimi i organizatës terroriste dhe në vijim parashikohen veprat penale të kryera me qëllime terroriste, parashikuar në kreun VII të këtij kodi, si dhe nenet 265/a, 265/b dhe 265/c që parashikojnë sanksione për pjesëmarrësit në veprime luftarake në një shtet të huaj (ndryshime sipas ligjit nr. 98, datë 31.7.2014);

- Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar ku përcaktohet kompetenca e hetimit të veprave penale që lidhen me terrorizmin, si dhe ligji nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, në bazë të të cilit është krijuar Prokuroria e Posaçme, që ka në kompetencë hetimin e veprave të kryera nga grupet terroriste;

- Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008, “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar (ndryshuar me ligjin nr. 10 391, datë 3.3.2011; nr. 66/2012, datë 7.6.2012; nr. 44/2017, datë 6.4.2017; nr. 33/2019, datë 17.6.2019, nr. 120/2021, datë 2.12.2021). Ky ligj ka për qëllim të parandalojë pastrimin e parave dhe të produkteve që burojnë nga veprat penale, si dhe parandalimin e financimit të terrorizmit. Ky ligj gjithashtu parashikon detyrime dhe procedura për raportimin për subjektet e ligjit të strukturat përgjegjëse në funksion të zbatimit të tij,

kompetencat e autoriteteve mbikëqyrëse dhe autoritetit përgjegjës;

- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për eliminimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit, nëpërmjet masave ndaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017, 34/2019, datë 17.6.2019, nr. 85/2020, datë 2.7.2020) zbatohen edhe për pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, edhe për pjesëmarrje në organizata terroriste ose në banda të armatosura;

- Ligj nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar (ndryshuar me ligjin nr. 43/2017, datë 6.4.2017; nr. 32, datë 17.6.2019). Ky ligj është në përputhje me kërkesat e rezolutës 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Zbatimi i këtij ligji bëhet nga një sërë institucioneve dhe agjencish si Ministria e Drejtësisë, Banka e Shqipërisë, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPP) dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ndërsa administrimi i llogarive dhe asetëve të ngrira/sekuestruara/konfiskuara bëhet nga Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara. Me këto ndryshime është synuar përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga Rekomandimi 6 i FATF dhe kriteret përkatëse të këtij rekomandimi, për të kaluar nga pjesërisht në plotësisht i përmbushur, pasi ky rekomandim është në grupin e atyre që konsiderohen kyçe në sistemin parandalues dhe goditës ndaj terrorizmit dhe financimit të tij. Me ndryshimet ligjore është arritur që afatet për njoftim të Këshillit të Sigurimit të OKB të jenë të njëjta sipas kërkesave të rezolutave të komiteteve përkatëse; të ndiqen procedurat dhe formularët standarde, siç janë miratuar nga Komitetet përkatëse (Komiteti I 1267/1989 ose Komiteti i 1988); sigurimi i sa më shumë informacioni identifikues që të jetë e mundur, dhe informacioni të posaçëm që mbështet shpalljen, kur i kërkohet një vendi tjetër njohja e masave të nisura nën mekanizmin e bllokimit. Ndryshimet synojnë gjithashtu vendosjen e procedurave për paraqitjen pranë Komiteteve përkatës të OKB-së të kërkesave për heqje nga lista të personave apo enteve të shpallur sipas Regjimit të Sanksioneve të OKB-së të cilët sipas vlerësimit të vendit nuk plotësojnë kriteret për shpallje. Gjithashtu janë përcaktuar masa më shtrënguese që fondet dhe



asetet e personave apo enteve të shpallura të bllokohen pa njoftim paraprak;

- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 44, datë 10.6.2009, “Për miratimin e rregullores “Për parandalimin e pastrimit e parave dhe financimit të terrorizmit”;

- VKM nr. 140, datë 13.2.2008, “Për mënyrën e administrimit të pasurive të paluajtshme të sekuestruara, në kuadër të masave kundër financimit të terrorizmit”;

- Rekomandimi i vendimit Kuadër i KE-së, neni 5, dënimet - “Masat e ndëshkimit dhe dënimit të terroristëve”, dhe të nenit 2 të tij, për krimet e lidhura me grupet terroriste;

- Me ligjin nr. 9110, datë 24.7.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krimet e rënda”, u krijua Gjykata për Krime të Rënda, dhe Prokuroria për Krime të Rënda, e cila ka në kompetencë edhe hetimin e veprave penale në fushën kundër terrorizmit;

- Ligj nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;

- Ligj nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligj nr. 98/2016, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”

- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009, “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;

- Ligj nr. 108/2013, “Për të huajt” (ndryshuar me ligjin nr. 74/2016, datë 14.7.2016 dhe ligjin nr. 13/2020) i cili rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit dhe të daljes së të huajve në/nga Republika e Shqipërisë;

- Ligji nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”;

- Ligj nr. 79/2020, “Për ekzekutimin e vendimeve penale”;

- Ligj nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”;

- Vendim nr. 847, datë 24.12.2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 343, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrat dhe procedurat e raportimit të autoriteteve licencuese dhe/ose mbikëqyrëse”;

- Ligj nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”;

- Ligji nr. 112/2020, “Për regjistrin e pronarëve përfitues” ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 2020. Ligji parashikon që QKB-ja do të trajtojë procesin e regjistrimit të pronarëve përfitues të subjekteve raportuese në regjistrin e pronarëve përfitues. Regjistri i Pronarëve Përfitues do të jetë i aksesueshëm dhe i hapur për të gjitha institucionet shtetërore përgjegjëse për të marrë informacion mbi pronarët përfitues të subjekteve raportuese (përfshirë personat juridikë/bizneset);

- Në këtë drejtim Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr. 154/2020, datë 17.12.2020, “Për regjistrin qendror të llogarive bankare”. Kjo nismë ligjore është në përputhje me nenin 32/a të direktivës së BE-së kundër Pastrimit të Parave (direktiva 2015/849 e ndryshuar nga direktiva 2018/843);

- Ligj nr. 8457/1999, “Për informacionin e klasifikuar “Sekret shtetëror”, i ndryshuar me ligjin nr. 9541, datë 22.5.2006, “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror””;

- Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”, i cili përafrohet me direktivën (BE) 2016/1148 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 6 korrik 2016;

- Ligji nr. 71/2016, “Për kontrollin kufitar”, i ndryshuar, i cili përcakton rregullat për transmetimin e të dhënave të pasagjerit dhe regjimin e kontrollit kufitar të personave që kalojnë kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë.

- Udhëzimi i përbashkët nr. 464, datë 10.12.2020, “Për transmetimin e të dhënave të pasagjerit të njësia e informacionit të pasagjerit”.

- Ligji nr. 81/2020, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i cili përcakton të drejtat dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim, organizimin e sistemit të burgjeve, si dhe kompetencat dhe detyrat e organeve shtetërore kompetente.

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare;

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020, në rishikim për periudhën 2022–2030;

- Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2016–2020;

- Prioritetet e Ministrisë së Brendshme;

- Plani i Përbashkët i Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor ndërmjet



Shqipërisë dhe Komisionit Evropian. Rishikuar marrëveshja zbatuese dypalëshe mes Komisionit Evropian dhe autoriteteve shqiptare për implementimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor, nënshkruar më 9 dhjetor 2022.

1.1.2 Instrumentet ligjore ndërkombëtare

Ky dokument strategjik i referohet dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është palë dhe në veçanti në marrëveshjet e mëposhtme:

1. Plani i Përbashkët i Veprimit kundër terrorizmit për Ballkanin Perëndimor ndërmjet Shqipërisë dhe Komisionit Evropian;

2. Marrëveshje me EUROPOL, INTERPOL;

3. Konventa kundër krimit të organizuar transnacional;

4. Prioritetet e Shqipërisë në Këshillin e Sigurimit 2022–2023

5. Strategjia Globale e Kombeve të Bashkuara, Konventat dhe protokollet e Kombeve të Bashkuara kundër terrorizmit;

6. Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin e Terrorizmit.

7. Protokollin i bashkëpunimit me Maqedoninë e Veriut (2019) dhe Plani i Përbashkët i Veprimit në Luftën kundër Terrorizmit.

1.1.2.1 Konventat dhe protokollet ndërkombëtare

Republika e Shqipërisë në kuadër të bashkëpunimit në luftën kundër terrorizmit ka nënshkruar dhe ratifikuar konventat dhe protokollet ndërkombëtare që përbëjnë instrumentet e së drejtës ndërkombëtare në fushën e luftës kundër terrorizmit. Shqipëria u është bashkuar iniciativave të OKB-së për të luftuar terrorizmin dhe ka ratifikuar tashmë 12 prej tyre. Krahas tyre ekzistojnë edhe një sërë rezolutash të Këshillit të Sigurimit të OKB-së me vlerë detyruese për shtetet anëtare, si edhe konventa dhe protokolle të ashtuquajtura rajonale. Në këtë kuadër, Shqipëria aderon në të gjitha konventat dhe protokollet e Këshillit të Evropës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (aktualisht 16 të tilla) dhe konkretisht:

“Konventa mbi Veprat Penale dhe Aktet e tjera të Kryera në Bordin Avionit”, Tokio, 14.9.1963, ratifikuar me ligjin nr. 8197, datë 6.3.1999, Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.1997, faqe 52.

“Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme të Rrëmbimit të Avionit”, Hagë, 16.12.1970, ratifikuar me ligjin nr. 8197, datë 6.3.1997. Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.1997, faqe 52.

“Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Aviacionit Civil”, Montreal, datë 23.9.1971, ratifikuar me ligjin nr. 8191, datë 6.3.1997. Fletore Zyrtare nr. 3, datë 28.3.1997, faqe 52.

“Konventa mbi Parandalimin dhe Ndëshkimin e Krimeve kundër Personave me Imunitet Ndërkombëtar, përfshirë Agjentët Diplomatikë”, Nju-Jork, 14.12.1973, ratifikuar me ligjin nr. 8832, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 56, datë 21.12.2001, faqe 1762.

“Konventa Evropiane mbi Shtypjen e Terrorizmit”, Strasburg, 27.1.1979 ratifikuar me ligjin nr. 8642, datë 13.7.2000. Fletore Zyrtare nr. 22, datë 19.7.2000, faqe 1087.

“Konventa ndërkombëtare kundër Marrjes së Pengjeve”, Nju-Jork 17.12.1979, ratifikuar me ligjin nr. 8837, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare 22, datë 19.7.2000, faqe 1087.

“Konventa mbi Mbrojtjen Fizike të Materialit Bërthamor”, Vjenë më datë 3.3.1980, ratifikuar me ligjin nr. 8853, datë 31.1.2002. Fletore Zyrtare 12, datë 8.2.2002, faqe 19.

“Protokollin mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme të Dhunës në Aeroport që i shërbejnë Aviacionit Civil Ndërkombëtar”, Montreal, 24.2.1991 ratifikuar me ligjin nr. 8835, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 56, datë 21.12.2001, faqe 1785.

“Konventa mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Llundrimit Detar”, Romë, 10.3.1998, ratifikuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001. Fletore Zyrtare nr. 60, datë 31.12.2001, faqe 1886.

“Protokollin mbi Shtypjen e Akteve të Paligjshme kundër Sigurisë së Platformave Fikse, të Vendosura në Platformën Kontinentale”, Romë, 10.3.1988, ratifikuar me ligjin nr. 8850, datë 27.12.2001. Fletore Zyrtare nr. 60, datë 31.12.2001, faqe 1886.

“Konventa mbi Etiketimin e Eksplozivëve Plastikë për Qëllim Zbulimi”, Montreal, 1.3.1991, ratifikuar me ligjin nr. 9020, datë 6.3.2003. Fletore Zyrtare nr. 21, datë 28.3.2003, faqe 649.

“Konventa Ndërkombëtare mbi Ndalimin e Bombardimeve Terroriste”, Nju-Jork, 15.12.1997,



ratifikuar me ligjin nr. 8836, datë 22.11.2001. Fletore Zyrtare nr. 57, datë 21.12.2001, faqe 1801.

“Konventa ndërkombëtare për luftën kundër financimit të terrorizmit” Nju-Jork, 10.1.2000, ratifikuar nga parlamenti Shqiptar me ligjin nr. 8865, datë 14.3.2002. Fletore Zyrtare, nr. 7, datë 5.4.2002, faqe 170.

“Konventa Evropiane (Strasburgut), për pastrimin, depistimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit”, ratifikuar me ligjin nr. 8646, datë 20.7.2000. fletore Zyrtare, nr. 23, datë 4.8.2000, faqe 1183.

“Konventa e Këshillit të Evropës, mbi pastrimin, kërkimin dhe konfiskimin e procedurave të krimit të organizuar dhe financimit të terrorizmit”, datë 6.5.2005, nënshkruar më 22 dhjetor 2005, hyrë në fuqi më 1 maj 2008.

“Konventa e Këshillit të Evropës për pastrimin, kërkimin, kapjen dhe konfiskimin e produkteve të krimit dhe për financimin e terrorizmit”, ratifikuar me ligjin nr. 9646, datë 27.11.2006. Fletore Zyrtare nr. 134, datë 22.12.2006, faqe 5221.

Ratifikimi i “Protokollit ndryshues i konventës evropiane për shtypjen e terrorizmit”, ratifikuar me ligjin nr. 9230, datë 13.5.2004. Fletore Zyrtare nr. 38, datë 16.6.2004, faqe 2793.

Për ratifikimin e “Konventës evropiane për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme” me ligjin nr. 9265, datë 29.7.2004.

“Konventa Ndërkombëtare për Shtypjen e Akteve të Terrorizmit Nuklear (Bërthamor) (2005)”, nënshkruar nga vendi ynë.

1.1.2.2 Marrëveshje dypalëshe në fushën e luftës kundër terrorizmit

Planifikimi dhe kryerja e aktiviteteve terroriste është një proces i vështirë që rrallë herë ndodh brenda territorit të një vendi dhe në zbatim të Strategjisë Globale të OKB-së për Terrorizmin e cila kërkon bashkëpunim në nivel global, rajonal dhe kombëtar, në zbatim të rekomandimit të rezolutës së Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 49/60 (1995). Shqipëria ka nënshkruar dhe po zbaton 21 marrëveshje bashkëpunimi me vende të rajonit, Evropës dhe SHBA-të, në fushën e sigurisë dhe shkëmbimit të informacionit për verifikimin dhe luftën kundër terrorizmit, konkretisht:

1. Me Slloveninë – mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të paligjshëm të drogës dhe krimit të organizuar, nënshkruar më 24.11.1993, në Tiranë.

2. Me Kroacinë – për bashkëpunimin policor, 20 janar 2014.

3. Me Egjiptin – protokoll mbi bashkëpunimi në fushën e luftës kundër terrorizmit, nënshkruar në Kajro, më 24.10.1995.

4. Me Hungarinë – mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, trafikut të drogës dhe krimit të organizuar, nënshkruar në shkurt 1999 dhe ratifikuar me ligjin nr. 8623, datë 15.6.2000.

5. Me Rumaninë – mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, të luftës kundër krimit të organizuar, të trafikut të paligjshëm të substancave narkotike e psikotrope, si edhe aktivitete të tjera ilegale, nënshkruar më 7.6.2002, në Bukuresht.

6. Me Malin e Zi – mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikut të paligjshëm si dhe veprimtarive të tjera të paligjshme”, nënshkruar në Podgoricë, Mal i Zi, më 31 tetor 2003.

7. Me Maqedoninë – mbi bashkëpunimin në luftën ndaj terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope e prekursiveve, migracionit të paligjshëm dhe veprimtarive të tjera të paligjshme, nënshkruar në Shkup, Maqedoni, më 17.6.2004.

Në kuadër të bashkëpunimit rajonal në luftën kundër terrorizmit Protokollin ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Maqedonisë “Për bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit”, më 3.2.2018, në Ohër, Maqedoni.

8. Me Bullgarinë – mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm dhe akteve të tjera kriminale, nënshkruar në Tiranë, më 29 janar 2007.

9. Me Francën – mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë së brendshme, nënshkruar në Paris, më 15.5.2008.

10. Me Gjermaninë – mbi bashkëpunimin në fushën e sigurisë, nënshkruar më 31 maj 2013 dhe ratifikuar me ligj më 23 janar 2014.

11. Me Bosnjë-Hercegovinën – mbi bashkëpunimin në luftën kundër krimit veçanërisht terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogave dhe krimit të organizuar, nënshkruar më 24.3.2009, hyrë në fuqi më 4.3.2010.



12. Me Kosovën – mbi bashkëpunim të ndërsjellë në fushën e sigurisë. Miratuar me VKM nr. 429, datë 20.5.2015.

13. Me Sllovakinë – mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikut të paligjshëm të lëndëve narkotike, substancave psikotrope e prekursorëve të drogës dhe krimeve të tjera. Miratuar me VKM nr. 485, datë 10.6.2015.

14. Me SHBA – marrëveshja e bashkëpunimit midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së SHBA, “Për shkëmbimin e informacionit për verifikimin e terrorizmit”, si dhe Protokollit Operacional, të Ratifikuara me ligjin nr. 72, datë 7.7.2016, Memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet Qeverisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, “Për rritjen e bashkëpunimit për të parandaluar udhëtimin e terroristëve dhe për të luftuar migracionin e paligjshëm dhe krimet e rënda që lidhen me to”, miratuar në parim me VKM nr. 153, datë 1.3.2017.

15. Me Serbinë – mbi bashkëpunimin në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm ndërkombëtar të drogës dhe terrorizmit ndërkombëtar, nënshkruar më 11.3.2010, hyrë në fuqi më 1.3.2012.

16. Me Letoninë – mbi bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikimit të paligjshëm të drogave narkotike, substancave psikotrope dhe prekursorëve, nënshkruar më 16.12.2009.

17. Me Italinë – protokollin mes Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Italiane “Mbi forcimin e bashkëpunimit dypalësh në luftën kundër terrorizmit dhe trafikimit të qenieve njerëzore”, nënshkruar më 3 nëntor 2017 në Tiranë, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit.

1.1.2 Kuadri institucional

Përpjekjet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm kërkojnë përfshirjen dhe bashkëpunimin e aktorëve publik e privat nga niveli qendror tek ai vendor me qëllim garantimin e ndërveprimit, koordinimit dhe ndarjes së informacionit midis aktorëve të përfshirë në këtë proces.

Institucionet që kanë një rol thelbësor në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm janë:

Ministria e Brendshme (MB) luan një rol thelbësor në zbatimin e kësaj strategjie duke u fokusuar tek ushtrimi i veprimtarisë së saj në fushën e përgjegjësisë shtetërore që lidhet specifikisht me luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit por edhe me rendin e sigurinë publike, në kuadër të bashkërendimit me njësitë e vetëqeverisjes vendore. Ministria e Brendshme dhe institucionet e saj të varësisë si: *Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore, Strukturat e sigurisë publike dhe ato të policimit në komunitet të Policisë së Shtetit dhe Akademia e Policisë* ushtrojnë detyra të rëndësishme që lidhen me arritjen e objektivave dhe realizimin e masave të Strategjisë edhe Planit të Veprimit.

Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH), e cila ka për mision parandalimin e përhapjes së radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet realizimit të përpjekjeve të lokalizuara, fuqizimit të të rinjve, familjes, grave dhe pakicave, duke i kanalizuar këto përpjekje drejt rrjeteve fetare, kulturore dhe arsimore si dhe përfshirjes së medias dhe shoqërisë civile. QKEDH-ja luan një rol kryesor në monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër terrorizmit duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse në drejtim të përmbushjes së përgjegjësisë të tyre. Ndër të tjera, me rëndësi konsiderohet edhe zhvillimi i kapaciteteve të aktorëve të përfshirë në identifikimin dhe parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm. Gjithashtu, ky institucion dizenjon, zbaton dhe monitoron vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera projekte dhe veprimtari që kanë në fokus kundërshtimin e radikalizimit dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm.

Ministria e Drejtësisë (MD) nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Shërbimit të Provës luajnë një rol të rëndësishëm në kundërshtimin dhe parandalimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm, duke qenë se ky fenomen gjen terren të favorshëm tek të dënuarit që vuajnë masën e dënimit në këto institucione.



Përveç institucioneve të sipërpërmendura, janë edhe **Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** (MSHMS), **Ministria e Arsimit dhe Sportit** (MAS), **Ministria e Financave dhe Ekonomisë** (MFE) dhe **Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore** që luajnë një rol të rëndësishëm në adresimin e faktorëve nxitës e shtytës si dhe në identifikimin e hershëm të shenjave të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çojnë në terrorizëm, duke mundësuar kështu parandalimin dhe rehabilitim/riintegrimin e individëve të prekur nga ky fenomen.

Në luftën kundër terrorizmit përfshihen një numër i madh e institucioneve shqiptare, si:

Ministria e Brendshme:

Policia e Shtetit

Në përbërje të Policisë së Shtetit funksionon Drejtoria e Antiterrorit, me shtrirje strukturore në të gjithë territorin e vendit. Funksionet kryesore të Drejtorisë janë parandalimi, identifikimi, gjurmimi dhe hetimi i personave të dyshuar si të përfshirë në vepra terroriste.

Agjencia e Administrimit të Aseteve Kriminale (AAPSK) për administrimin e fondeve dhe të pasurive të sekuestruara e konfiskuara.

Shërbimi Informativ Shtetëror

Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH), i krijuar me ligjin nr. 8391, datë 28.10.1998, mbledh informacion nga jashtë në funksion të sigurimit kombëtar, kryen veprimtari kundërzbulimi për ruajtjen e integritetit, të pavarësisë e të rendit kushtetues. SHISH mbledh informacion për terrorizmin, për prodhimin dhe trafikun e narkotikëve, për prodhimin e armëve të dëmtimit në masë, për krimet kundër mjedisit, mbledh informacion për krimin e organizuar, krime që cenojnë sigurinë kombëtare.

Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme. Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykata vetë posaçme për veprat penale. Çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata

kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktime vetë Kodit Penal.

Ministria e Mbrojtjes

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, në varësi të ministrit të Mbrojtjes dhe funksionon bazuar në ligjin nr. 65/2014, “Për Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes”. Ligji përcakton mënyrat e marrjes, administrimit dhe shpërndarjes së informacionit të klasifikuar kundër terrorizmit.

Ministria e Financave:

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP) shërben si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Kjo drejtori funksionon si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtari të mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit. Në kuadër të ushtrimit të funksioneve mbikëqyrëse, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD) bashkëvepron me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të realizimit të misionit të saj për garantimin e sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

Banka e Shqipërisë

Banka e Shqipërisë, në kuadër të ushtrimit të funksioneve si autoritet mbikëqyrës, për subjektet nën juridiksionin e saj, të kontrollojë zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë, nëpërmjet strukturave të saj, siguron bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër krimin të organizuar po kundër terrorizmit dhe financimit të tij, në zbatim të ligjit nr. 10193, datë 3.12.2009, “Për marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja në çështjet penale”. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe ajo e Shërbimit të Provës kanë një rol të rëndësishëm për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit edhe për faktin që këto fenomene janë shpesh të pranishme në mjediset apo shërbimet e këtyre institucioneve.



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë rol të rëndësishëm për adresimin e faktorëve nxitës e shtytës dhe parandalimin e fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, por dhe rehabilitimin e riintegrimin e individëve të prekur.

2.1 Arritjet dhe mësimet

Në luftën tonë kundër terrorizmit, kemi mbështetur idenë e veprimit të gjithë bashkë, me një qasje gjithëpërfshirëse dhe të balancuar, në nivel global, rajonal dhe kombëtar.

Qeveria Shqiptare, e ka vlerësuar luftën kundër terrorizmit si një prioritet kombëtar, duke qenë ndër vendet e para që në zbatim të Rezolutës 2178 (2014) ndërmoi hapa konkretë të reflektuara në legjislacionin kombëtar. Duke ndryshuar Kodin Penal, u synua adresimi i problematikave të luftëtarëve të huaj terroristë, duke e konsideruar të paligjshme dhe të ndëshkueshme pjesëmarrjen, organizmin apo çdo nxitje për pjesëmarrje në veprime ushtarake të një vendi të huaj. Të vendosur për të arritur rezultate të prekshme dhe për të treguar progres real, janë marrë masa për rishikimin, forcimin dhe ndryshimin e mekanizmave aktualë të kontrollit të financimit të terrorizmit dhe ngrirjes së asetëve për individë dhe subjekte të përfshirë në aktivitet terrorist.

Bazuar në studimet dhe raportet e riskut rezulton se kërcënimi real prej terrorizmit në Shqipëri është në nivel të ulët me përjashtim të disa rasteve kur niveli i kërcënimit është rritur në “mesatar”. Shqipëria nuk ka regjistruar akte e viktima terroriste të mirëfillta por është prekur nga fenomeni i pjesëmarrjes së luftëtarëve terroristë, zhvendosur së bashku me familjet e tyre në zonat në konflikt. Aktualisht, evidentohen shtetas shqiptarë, kryesisht gra dhe fëmijë, të strehuar në qendrat e pritjes për t’u riatdhesuar.

Për Policinë e Shtetit, parandalimi dhe lufta kundër terrorizmit mbetet një fushë kyçe për bashkëpunimin operacional dhe shkëmbimin e informacionit me shërbimet antiterror në vendet e rajonit, Itali, Kosovë, Mal i Zi, Maqedoni, me INTERPOL, EUROPOL, Qendrën Evropiane Kundër Terrorizmit, Oficerët Ndërlidhës, Qendrën për Verifikimin e Terrorizmit të FBI-së (TSC-SHBA) analogia e së cilës është krijuar në Drejtorinë Antiterrorizmit në Drejtorinë e

Përgjithshme të Policisë së Shtetit, agjencitë ligjzbatuese dhe shërbimet partnere në BE.

Shqipëria merr pjesë dhe përfaqësohet me kontribut konkret në të gjitha aktivitetet, grupet e punës së Koalicionit Global D-ISIS, dhe forumet e organizatave ndërkombëtare, ku vendet anëtare shkëmbejnë praktikat më të mira që lidhen me zbatimin e Strategjisë Globale të luftës kundër terrorizmit (UNGCTS) të OKB-së dhe Planin e Veprimit të Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm.

Shqipëria radhitet në ato vende që e kanë mbështetur fuqimisht GCTS dhe Planin e Veprimit, me bindjen se do të shërbente si një udhëzues i suksesshëm në përpjekjet tona të përbashkëta të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në zbatim të kërkesave të këtij Plan Veprimi por edhe në planet tona kombëtare duhet të parashikohen hapa konkrete në fusha prioritare, si:

- Dialogu dhe parandalimi i konflikteve;
- Forcimi i qeverisjes së mirë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe forcimit të shtetit ligjor;
- Pjesëmarrja e të rinjve;
- Barazia gjinore dhe forcimi i rolit të grave;
- Komunikimi strategjik në internet dhe median sociale etj.;

Shqipëria ka ofruar kontributin e saj në realizimin e Platformës Rajonale të luftës kundër Radikalizimit dhe Ekstremizmit të Dhunshëm dhe fenomenit të Luftëtarëve të Huaj Terroristë, në Evropën Juglindore, të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal (RCC).

Strategjia e BE-së kundër Terrorizmit dhe Plani i Përbashkët i Veprimit kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar nga BE dhe të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor, në Tetor 2018, është dokumenti kryesor politik në këtë fushë. Në këtë kuadër, më 9 tetor 2019, midis Shqipërisë dhe KE-së, u firmos marrëveshja mbi veprimet parësore që do ndjekë Shqipëria gjatë viteve 2019 -2020, për secilin nga pesë objektivat e përcaktuara në Planin e Përbashkët të Veprimit kundër terrorizmit në Ballkanin Perëndimor. Ky plan ka si objektiv shkëmbimin efektiv të informacionit dhe bashkëpunimin operacional mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe agjencive ligjzbatuese të BE-së.

Strukturat e antiterrorit tashmë kanë kapacitetet operacionale, logjistikën e nevojshme për kryerjen e



operacioneve me metoda speciale të cilat ndihmojnë në parandalimin dhe goditjen e veprave penale me qëllime terroriste por në këtë drejtim ka nevojë për investime dhe mbështetje të vazhdueshme në përshtatje me zhvillimet teknologjike dhe dinamikat e zhvillimit të kërcënimeve terroriste. Njëkohësisht po punohet për rritjen e mëtejshme të këtyre kapaciteteve në bashkëpunim me misionet policore të atashuara prej vitesh në vendin tonë, si: PAMECA V dhe ICITAP.

Në vazhdimësi janë kryer trajnime duke rritur kapacitetet e duhura profesionale dhe logjistike të të gjitha strukturave për të përballuar me sukses situatat e ndryshme që janë objekt i punës së tyre në fushën kundër terrorizmit.

Vendi ynë ka bërë analizën e përgjithshme dhe nen për nen të legjislacionit për luftën kundër terrorizmit dhe po punon për përputhjen plotësisht të Kuadrit Ligjor për Luftën kundër Terrorizmit dhe parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm, me “Acquis” e BE-së.

Në funksion të strukturave antiterror është krijuar Njësia për Verifikimin e Terrorizmit dhe Sigurinë, e cila shërben për shkëmbimin e informacioneve me Qendrën Ndërkombëtare kundër Terrorizmit (ISC) dhe me Qendrën Evropiane kundër Terrorizmit (ECTC) në Europol, për verifikimin e shtetasve shqiptarë dhe të huaj të përfshirë/lidhur në veprimtari terroriste, si dhe njësia për Hetimin e Financimit të Terrorizmit, bazuar kjo edhe në rekomandimet e MoneyVal.

Duke qenë se ashpërsimi i masave ligjore pengon por nuk eliminon fenomenin, çështja e ndalimit të pjesëmarrjes së qytetarëve shqiptarë në konflikte të huaja është synuar të trajtohet në rrënjët e problemit, që janë mungesa e kohezionit social dhe zhvillimi ekonomik, të cilat përbëjnë shtysën dhe motivin për radikalizim. Gjithashtu kjo strategji parashikon një qasje të re dhe integruar për sa i përket mbledhjes e trajtimit të informacionit dhe problematikave të identifikuar. Pavarësisht ashpërsimit të masave në funksion të mbrojtjes e garantimit të sigurisë kombëtare është e rëndësishme të theksojmë se këto masa respektojnë parimet themelore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, veçanërisht ato të lirisë së shprehjes dhe informacionit.

Për kriminalizimin dhe ndëshkimin e terrorizmit, strukturat e specializuara të luftës kundër terrorizmit, në vazhdimësi e kanë trajtuar e ndjekur fenomenin e luftëtarëve të huaj terroriste dhe janë zhvilluar hetime për individë organizatorë, financues dhe pjesëmarrës në konflikte jashtë vendit.

Krijimi dhe zhvillimi i një rrjeti jo vetëm kombëtar por dhe rajonal, në funksion të forcimit të kapaciteteve të shkëmbimit të informacionit ndërmjet vendeve të rajonit për çështje që kanë të bëjmë me parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar janë konsideruar me shumë rëndësi.

Në luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, zhvillimi i strategjive gjithëpërfshirëse në nivel kombëtar, është thelbësor, jo vetëm për luftën kundër radikalizmit dhe rekrutimit, por edhe për të vlerësuar siç duhet dhe **mundësinë e riintegritimit**.

Duke synuar gjithnjë parandalimin, dhe bashkërendimin e përpjekjeve globale të luftës kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, institucionet shqiptare e kanë mbështetur suksesin e veprimit në pasurinë e vlerave dhe traditave tona kombëtare e fetare dhe në hartimin e zbatimit e paketave të posaçme strategjike, sociale, politike, ligjore, edukative dhe ekonomike.

Për të mundësuar mbështetjen e viktimave të terrorizmit, në bashkëpunim me vendet partnere dhe agjencitë e inteligjencës, Shqipëria ka marrë masat e kontrollit të kufirit, pritjes dhe intervistimit të të kthyerve potencialë në pikat e kalimit në kufi, mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave me Interpol dhe partnerët strategjikë, për identifikimin në terren dhe kryerjen e procesit të riatdhesimit të tyre.

Aktualisht, veçanërisht në këtë kontekst, do të tregohet vëmendje e shtuar për të vënë në jetë politika efikase shtetërore, jo vetëm për hetimin dhe çuarjen përpara drejtësisë, por edhe për riatdhesimin, rehabilitimin dhe riintegrimin e qytetarëve shqiptarë dhe familjarëve të tyre, që u bashkuan me kauzën e ISIL dhe kanë marrë pjesë në konfliktin në Siri.

Siç përmendet edhe më lart, Shqipëria nuk ka regjistruar akte e viktime terroriste të mirëfillta, por është përballur me fenomenin e luftëtarëve të huaj terroriste, të shoqëruar edhe me gra e fëmijë, në zonat në konflikt në Siri/Irak, duke u përballur këta



të fundit me tmerrin e luftës dhe humbjen e prindërve dhe të afërmeve të tyre.

Në periudhën midis viteve 2013–2015 rreth 144 shtetas shqiptarë u larguan drejt Irakut dhe Sirisë për të marrë pjesë në luftërat që u zhvilluan në këto shtete. Dukuria e largimit u ndalua në 2015, vit prej të cilit nuk ka më të larguar nga vendi ynë. Në vitet e fundit shteti shqiptar ka marrë masa për riatdhesimin e të larguarve.

Pas gjashtë vitesh pune në kuadër P/LKEDH dhe kundër përhapjes së nxitësve dhe faktorëve që e ushqejnë, ose e mundësojnë ekstremizmin e dhunshëm, vërehen përmirësime të konsiderueshme në disa prej nxitësve të matur të EDH, si më poshtë.

-Përmirësimi i kuadrit ligjor me qëllim ndalimin, ndëshkimin e shtetasve shqiptar që kanë në fokus t'i bashkohen celulave terroriste, duke evidentuar veprat penale për rekrutimin e personave për kryerjen e veprave me qëllimeve terroriste ose të financimit të terrorizmit;

- Forcimi i koordinimit, bashkëpunimit dhe partneritetit në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar, ndërmjet agjencive qeveritare, organizatave joqeveritare, sektorit privat, komuniteteve fetare dhe mediave, në identifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve efektive;

- Forcimi i qëndresës së komunitetit dhe zvogëlimi i tërheqjes ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve, krijimit të programeve dhe politikave të arsimit, punësimit dhe parandalimit nga policia në komunitet;

- Realizimi i hulumtimit në nivel vendor si mjet për të kuptuar kushtet, faktorët dhe shkaqet që nxisin radikalizimin që mund të kalojë në dhunë dhe qëndresën e komunitetit ndaj ekstremizmit të dhunshëm;

- Ulja e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale dhe median audiovizive si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive;

- Ndjekja e procesit të koordinimit të të gjithë strukturave shtetërore për rehabilitimin dhe riintegrimin e shtetasve të kthyer nga zonat e konflikteve, njëherazi duke koordinuar punën dhe orientuar partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë mbështetës të këtij procesi, për mundësimin e mbështetjes financiare në kohën e duhur.

Përmes urdhrin nr. 169, datë 1.11.2018, të Kryeministrit është hartuar një Plan Ndërinstitucional Veprimi “Për pritjen dhe trajtimin e shtetasve shqiptarë që kthehen nga zonat e konflikteve në Siri dhe Irak”, ku për të gjitha institucionet shqiptare parashikohen detyra konkrete, për asistencë mjekësore, psikologjike, sociale, ekonomike, si dhe ngritjen e kapaciteteve logjistike e njerëzore për pritjen, shoqërimin, si dhe masat për rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre.

Republika e Shqipërisë, përveç se është karakterizuar nga ekstremizmi me bazë radikale fetare ballafaqohet edhe me forma tjera, siç janë ato me motive nacionaliste apo etnike për të arritur qëllime të caktuara politike. Si pasojë e indoktrinimit nga ideologjitë radikale/ekstremiste, qoftë ato nacionaliste apo fetare, një numër i caktuar i shtetasve shqiptarë kanë përfunduar në zonat e konflikteve në Siri dhe Irak, të rekrutuar në radhët e organizatave terroriste.

Ndër tendencat kryesore vazhdon të mbetet ekstremizmi me bazë radikale fetare, si rezultat i indoktrinimit me ideologji radikale ekstremiste islamiste të importuara në Shqipëri nga rryma të ndryshme shkollimi të vendeve të Lindjes së Mesme. Pasojat nga këto ideologji tashmë janë evidente, duke filluar nga: bashkimi i dhjetëra shtetasve shqiptarë në zonat e konflikteve në radhët e organizatave terroriste. Disa prej tyre tashmë të vrarë, familje që kanë ngelur në zonat e konflikteve, me tendencë për përhapjen e ideologjive ekstremiste të dhunshme, krijimin e barrierave ndaj harmonisë dhe njëkohësisht pengesë e tolerancës fetare, si dhe ajo që është më shqetësuese rritjen e kërcënimeve për sulme terroriste.

Pavarësisht kundërshtimit të vazhdueshëm dhe rezistencës ndaj këtyre ideologjive, pjesë të caktuara të shoqërisë që ishin më të cenueshme, të gjendur të ekspozuar ndaj këtyre ideologjive, kanë rënë viktimë e tyre duke vazhduar thellimin në ekstremizëm dhe radikalizëm.

Më tej prirjet globale në aspektin e ekstremizmit, si dhe fillimi i konflikteve në Lindje të Mesme, veçanërisht në Siri dhe Irak, ku u konsoliduan grupet dhe organizatat terroriste, është shfrytëzuar si moment për radikalizim të theksuar dhe këto konflikte u shndërruan në një fushë veprimi për luftëtarët e huaj terroristë (LHT) nga gjitha Evropa dhe më gjerë, duke përfshirë Ballkanin Perëndimor dhe Republikën e Shqipërisë.



Siç është parë nga shembuj të shumtë në Evropë, individët e radikalizuar mund të kryejnë akte të dhunës ekstreme edhe ndaj popullsisë dhe institucioneve edhe në shtetin e tyre të origjinës, prandaj dhe rreziku që Shqipëria do të mund të jetë në shënjestër për një sulm të tillë terrorist edhe pse i ulët nuk mund të përjashtohet.

Si rezultat i bashkimit të këtyre shtetasve shqiptarë në organizata terroriste janë shënuar edhe thirrje publike nga ana e tyre për sulme terroriste në Shqipëri dhe rajon, por edhe janë shënuar tentativa për kryerjen e akteve terroriste të parandaluara nga institucionet e sigurisë në Shqipëri.

Me gjithë faktin që organizatat terroriste kanë humbur territor dhe kontroll në vatrat e krizës, në aspektin ideologjik ato vazhdojnë të kenë mbështetje dhe të shtrijnë ndikimin në vende tjera, duke përfshirë edhe rajonin tonë dhe më gjerë.

2.2.1 Analiza e situatës

Republika e Shqipërisë si anëtare e koalicionit ndërkombëtar kundër terrorizmit nga viti 2001 e në vazhdim, ka mbështetur aleatët dhe partnerët në luftën kundër terrorizmit, dhe e ka konsideruar atë prioritet kombëtar dhe për këtë qëllim ajo ka analizuar, hartuar e miratuar kuadrin e nevojshëm ligjor në përputhje me legjislacionin e BE-së, si dhe ka ngritur kapacitetet e nevojshme operationale e logjistike për të parandaluar dhe luftuar çdo kërcënim ndaj sigurisë kombëtare e ndërkombëtare nga veprimtari terroriste.

Terrorizmi konsiderohet kërcënim nga të gjitha shtetet e rajonit e më gjerë. Vlerësohet se grupet terroriste ndërkombëtare nuk kanë mundur deri tani të shtrijnë rrjetet e tyre në Shqipëri, por vendi ynë mund të përdoret si strehë apo tranzit për grupe të tilla.

Strategjia Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025, është vazhdim i Strategjisë Ndërsektoriale të Luftës kundër Terrorizmit 2011–2015, si detyrim i vendit për përmbushjen e prioriteteve të përcaktuara për të luftuar terrorizmin me të gjitha format e shfaqjes së tij, si dhe nevoja e implementimit të objektivave që dilnin nga detyrimet ndërkombëtare të miratuara nga Këshilli i Sigurisë i OKB-së, Strategjinë e BE-së kundër terrorizmit dhe Konventën Evropiane dhe Protokollin shtesë të saj për parandalimin e terrorizmit, ku adresohet edhe fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë (LHT).

2.2.2 Faktorët e riskut dhe kërcënimet nga ekstremizmi i dhunshëm dhe terrorizmi në Shqipëri

Zhvillimet e kohëve të fundit, si ato në Lindjen e Mesme, në Afrikën e Veriut, sulmet e organizatave të terrorit ndërkombëtar të ISIS, Al Kaedës apo të tjerë, e kanë çuar në një nivel tërësisht të ri, sfidën kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në Shqipëri nuk janë evidentuar grupe terroriste që zhvillojnë aktivitet brenda vendit apo më gjerë, por gjatë viteve 2012–2015, rreth 144 shtetas² shqiptarë shkuan në Siri dhe Irak për luftuar në konfliktet e armatosura në këto vende. Numri i këtyre luftëtarëve nga Shqipëria që largohen për të marrë pjesë në konfliktin në Siri dhe Irak ra në zero në fund të vitit 2015. Nuk përjashtohet mundësia e aktivizimit të tyre duke marrë në konsideratë zhvillimet aktuale në konfliktin sirian (humbja e territoreve dhe kontrollit të ISIL/DAESH).

Po sipas këtij raporti disa prej këtyre luftëtarëve rreth 45 janë kthyer në Shqipëri dhe në këtë kuadër sfidë përbën deradikalizimi dhe riintegrimi i luftëtarëve të huaj pas kthimit në atdhe. Për këtë arsye, qeveria shqiptare ka kërkuar dhe ka siguruar nga parlamenti ndryshimin e kodit penal (neni 265/a, b, c) mbi pjesëmarrjen e shtetasve shqiptarë në konflikte të armatosura në vende të tjera.

Rreziku i paraqitur prej luftëtarëve të rikthyer konsiston në lidhjet e tyre potenciale me ekstremistët në rajon apo Evropë, në lidhjet që mund të mbajnë me ekstremistët në zonat e konfliktit, në mundësinë e përdorimit të mediave sociale për thirrje për t'iu bashkuar luftimeve, në informacionin që disponojnë sesi mund të shkohet në Siri. Nga ana tjetër, personat e kthyer mund të konsiderohen të trajnuar dhe me eksperiencë në përdorimin e armëve dhe të eksplozivëve, duke rritur gjasat e aktivitetit terrorist brenda vendit, apo edhe në rajon.

Në vitin 2016 përfundoi gjykimi dhe u shpallën fajtorë 9 të pandehur, të akuzuar për “Rekrutim të personave për kryerjen e veprimeve terroriste”. Ky grup personash ishte rasti i parë i hetimit dhe i gjykimit për rekrutimin e të ashtuquajturve “Luftëtarë të Huaj”.

² Raporti i vitit 2018 i Komisionit Evropian



Në lidhje me këtë fenomen shtetas shqiptar që kanë udhëtuar drejt vendeve të konfliktit nuk është evidentuar ndonjë zinxhir apo fluks financimesh, por mendohet se i kanë mbuluar vetë këto shpenzime.

Faktorët që mund të ndikojnë në rekrutimin e shtetasve shqiptarë drejt vendeve të konfliktit janë: situata aktuale në nivel ndërkombëtar e sipërpërmendur, niveli i ulët ekonomik, papunësia, varfëria, niveli i ulët arsimor, ndikimi i komuniteteve fetare jo zyrtare me tendencë radikale dhe përdorimit i mjeteve online të propagandës.

Shqipëria në historikun e saj nuk ka qenë objekt i akteve terroriste, por në nëntor të vitit 2016 një operacion i koordinuar rajonal kundër terrorizmit çoi në arrestimin e katër individëve në Shqipëri. Operacioni ndërpreu një sulm potencial për një ndeshje të futbollit për kualifikueset e Kupës së Botës nga Shqipëria dhe Izraeli, që u zhvillua në Shkodër. Gjithashtu, në vitin 2017 janë kryer pesë operacione të tjera, ku 12 të dyshuar janë arrestuar me akuza për vepra terroriste.

Si rrjedhojë e zhvillimeve ndërkombëtare, në Shqipëri janë futur koncepte të tilla si, radikalizimi fetar dhe ekstremizmi i dhunshëm, të cilat mund të përbejnë një kërcënim të mundshëm për akte terroriste.

Rrezikshmëria e radikalizimit dhe ekstremizmit me frymëzim ideologjik, fetar apo nacionalist konsiston pikërisht në faktin se ushqejnë veprimtaritë terroriste. Në ditët tona vëmendja kryesore është e fokusuar pikërisht në terrorizmin që shfrytëzon radikalizmin me bazë religjioze fetare.

Ndër metodat e radikalizimit dhe rekrutimit në vendin tonë përmendim propagandën nëpërmjet përdorimit të internetit, ligjëratës e predikimeve në ambiente jashtë juridiksionit të autoriteteve fetare të njohura në Republikën e Shqipërisë. Grupet më të targetuara vlerësohet të jenë moshat 20–35 vjeç.

Nga një prespektivë gjeografike rezulton se fenomeni është përqendruar në qytetet Elbasan, Pogradec, Librazhd, Bulqizë, Cërrik, Kukës, Dibër, Kavaja dhe në zonat rurale që rrethojnë këto qytete. Faktorët që kanë ndikuar mendohet të jenë: radikalizimi i hershëm, niveli i ulët arsimor dhe teologjik, probleme ekonomike dhe sociale, bullizmi, shëndeti mendor, premtimet për dhënie ndihme financiare.

Për sa u përket faktorëve që kanë ndikuar ndjeshëm në minimizimin e rrezikut të përfshirjes së shtetasve të vendit tonë në fenomenet e radikalizimit/ekstremizmit

ekstremizmit/radikalizmit me matricë religjioze, janë toleranca reciproke dhe bashkëjetesa shekullore mes besimeve në vend, fakti se besimi fetar në vendin tonë ka një kuptim krejt përëndimor dhe nuk nënkuptohet si mënyrë jetese, fakti se dukshëm dominon identiteti kombëtar mbi atë fetar.

Megjithatë disa nga faktorët të cilët ndikojnë në radikalizimin dhe ekstremizmin që çon në shfaqjen e akteve të dhunës janë:

- **Nxitësit socio-ekonomikë** – faktorë të tillë, si: varfëria absolute apo relative, fragmentimi social, përjashtimi social, diskriminimi dhe veprimtaria e paligjshme ekonomike sjellin zhgënjimin me sistemin politik dhe ekonomik. Kur nevojat e papërbushura ndërthuren me trajtimin e padrejtë të qytetarëve nga institucionet shtetërore (fenomene që po marrin më shumë përhapje për shkak të pandemisë), mund të lindë ndjenja e pakënaqësisë me shtetin dhe shoqërinë. Në mënyrë të veçantë, të rinjtë e papunë apo të izoluar mund të jenë të cenueshëm nga propaganda e ideologjive ekstremiste që mbrojnë përdorimin e dhunës për të protestuar kundër rendit ekzistues dhe për të bërë të mundur ndryshimet e dëshiruara si dhe për përfitime personale. Propaganda e ekstremizmit të dhunshëm mund të jetë veçanërisht tërheqëse për ta për shkak të premtimeve për punëve me fitim dhe zonave të përbashkëta të veprimit. Perceptimet për diskriminimin shoqëror ndaj një individi apo komuniteti (ose të djave) mund të jenë në një kuptim të gjerë nxitës i ekstremizmit të dhunshëm. Ndonëse në Shqipëri diskriminimi shoqëror me motiv fetar nuk evidentohet dukshëm, ngaqë shumica e shqiptarëve janë tolerantë ndaj grupeve të tjera fetare, ka disa faktorë që kërkojnë vëmendjen e aktorëve përkatës. Vihet re një rritje e konsiderueshme të grupeve fetare që ofrojnë të mira ekonomike apo materiale për ata që praktikojnë fenë e tyre, krahasuar me vitin 2018.

- **Nxitësit politikë** – nxitësit politikë lidhen me gjendjen aktuale dhe të perceptuar të demokracisë, qeverisjen dhe funksionimin e shtetit ligjor në një vend. Edhe pse kanë kaluar 30 vjet që nga rënia e sistemit komunist, Shqipëria ka akoma rrugë për krijimin e një sistemi të një demokracie të



konsoliduar, në drejtim të pavarësisë, efektivitetit dhe llogaridhënies së pushtetit legjislativ dhe atij ekzekutiv gjë që ndikon në besimin e qytetarëve të qeverisja dhe shteti ligjor. Nxitësit “Korrupsioni i përhapur dhe pandëshkueshmëria e elitave me lidhje të forta” dhe “Perceptimi se sistemi ndërkombëtar është thelbësisht i padrejtë dhe armiqësor me shoqëritë/popujt myslimanë” kanë marrë mbështetje edhe në grupe të caktuara të shqiptarëve. Disa nxitës që mund të mos jenë probleme të ngutshme sipas shumicës së shqiptarëve mund të jenë të tillë për grupe të caktuara, si njerëzit që banojnë në zona të izoluar, për besimtarët praktikantë, apo për shqiptarët që i përkasin një grupi të caktuar fetar. Në një kontekst të tillë, grupet ekstremiste të dhunshme e kanë më të lehtë ta promovojnë veten si alternativë e drejtë përkundër elitave të perceptuara imorale ose të padrejta qeverisëse. Besimtarët praktikantë priren më pak të jenë dakord se njerëzit duhet të përdorin dhunën për të arritur këtë ndryshim dhe kanë më shumë gjasa se të tjerët për të thënë se besimtari i vërtetë duhet të denoncojë anëtarët e komunitetit të tij fetar që shprehin pikëpamje ekstremiste fetare.

- **Nxitësit kulturorë** – perceptimi i rrezikut të mundshëm për identitetin e njerëzve dhe mënyrën e tyre të jetesës mund të jetë nxitës i rëndësishëm për ekstremizmin e dhunshëm, siç ishte rasti me Shtetin Islamik të Irakut dhe Sirisë. Parakushti më i rëndësishëm që njerëzit të bien pre e kësaj propagande është se ata duhet të jenë një ndjesi më të fortë të përkatësisë ndaj një komuniteti fetar rajonal apo edhe global sesa ndaj një popullate apo kulture vendase. Ndërkohë që shumica e të anketuarve nuk mendojnë se ka qëndrime armiqësore ndaj Islamit, përçindja e shqiptarëve që janë dakord me pohimin “Perëndimi është armiqësor dhe sulmon vazhdimisht vendet dhe kulturën islame” është rritur në krahasim me vitet e mëparshme. Vlen të theksohet se interpretimi ekstremist i një besimi nuk implikon domosdoshmërisht praninë e ekstremizmit të dhunshëm. Këto gjetje sugjerojnë nevojën për të vazhduar monitorimin e ndikimit të huaj të çështjet e brendshme fetare, ndërkohë që duhet të vazhdohet me dialogun gjithëpërfshirës. Duke u mbështetur te vlerat kombëtare, si toleranca fetare, ky dialog do të bëjë të mundur që qëndrimet jostandarde të mos tjetërsohen - duke ekuilibruar kështu çdo ndikim të huaj që do të synonte të

ndërhynte në identitetin e tij. Në këtë drejtim, autoritetet fetare, në mënyrë të veçantë, mund të luajnë një rol vendimtar.³

Disa nga faktorët të cilët mund të ndikojnë për shfaqjen e akteve terroriste janë:

- Pozita gjeostrategjike e vendit tonë dhe tensionet e konfliktet me bazë etnike në rajon;

- Keqpërdorimi i lehtësive që krijon lëvizja e lirë e shtetasve;

- Rreziku i depërtimit nëpërmjet imigrantëve të rregullt, të personave me tendencë terroriste, të larguar nga vendet në konflikt për të shkuar në Evropë;

- Interneti, rrjetet sociale dhe teknologjia e përparuar, ndihmojnë në propagandimin dhe përhapjen e radikalizmit/ekstremizmit.

Ndër kërcënimet e mundshme të terrorizmit me të cilat mund të ballafaqohet vendi ynë janë:

- **Indoktrinimi me ideologji radikale/ekstremiste** e bazuar kryesisht përmes propagandës në internet të cilat indoktrinojnë dhe rekrutojnë personat në moshë të re për t'i përdorur për qëllime të organizatave terroriste.

- **Kërcënimet nga terrorizmi kibernetik**, sfidat që burojnë nga epoka kibernetike të cilat cenojnë elementët e sigurisë kombëtare.

- **Migracioni i parregullt**, duke marrë parasysh pozitën gjeografike të vendit tonë e cila favorizon lëvizjet migratore shqetësim ngelet mundësia që luftëtarët e huaj terroristë nga vendet tjera të shfrytëzojnë kalimin tranzit, duke u përzierë edhe me emigrantët e parregullt me synim udhëtimin e tyre drejt vendeve të BE-së.

- **Prania në vendin tonë e kontigjenteve të shtetasve të huaj, të cilëve shteti shqiptar u ka ofruar azil humanitar**, bazuar në marrëveshje me vendet aleate, apo konventat ndërkombëtare, të cilëve u rrezikohet jeta në vendet e origjinës (MEK, GITMO, afganë etj.).

- **Organizatave nacionaliste me baza etnike**, të cilat janë të predispozuar që kohë pas kohe të përdorin dhunën, të provokojnë incidente ndëretnike, ndonjëherë edhe me mbështetjen e vendeve të treta për arritjen e qëllimeve politike.

- **Sulmet terroriste** qoftë nga pjesëtarët e organizatave terroriste përmes luftëtarëve të huaj

³ Studimi “Ekstremizmi I Dhunshëm në Shqipëri 2021, Vlerësim Kombëtar i nxitësve, formave dhe rreziqeve” - IDM



terroristë, celulave të fjetura por edhe nga simpatizantët dhe mbështetësit që mund të inspirohen për kryerjen e akteve të dhunshme.

- **Veprimi indoktrinues i predikuesve radikale, apo imamëve të vetëshpallur**, që përkrahin ideologjinë ekstremiste të organizatave militante terroriste;

- **Veprimi i aktorëve/elementëve të vetmuar**, të cilët janë vetëradikalizuar nga ideologji ekstremiste, kryesisht nga propaganda online dhe që mund të ndërmarrin akte të dhunshme, të pakoordinuara apo të paorientuara nga drejtues/komandantë terroriste, në funksion të

përbushjes së kauzës së ideologjisë ekstremiste që mbështetin;

ndikimi i mundshëm i luftës së agresionit të Rusisë kundër Ukrainës në proceset e radikalizimit dhe ekstremizmi i dhunshëm në rajon me impakt edhe në vendin tonë.

Situata aktuale e ndjekjes penale të veprave me qëllime terroriste

Në një analizë mbi të dhëna statistikore e raportime të prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, gjendja e hetimeve të veprave me qëllime terroriste në vitin 2019 dhe 9-mujorin 2020 është si më poshtë:

VEPRA PENALE ME QËLLIME TERRORISTE	Viti 2019			9-mujori 2020		
	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. për gjykim	Nr.pand.dërg.gjykim	Nr. Proc. Regj	Nr. Proc. për gjykim	Nr.pand.dërg.gjykim
Neni 230 Vepra me qëllime terroriste	3	0	0	3	0	0
Neni 230/a Financimi i terrorizmit	3	0	0	2	0	0
Neni 230/b Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	0	0	0	0	0	0
Neni 230/c Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit	0	0	0	0	0	0
Neni 230/ç Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	0			0	0	0
Neni 231 Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	0	0	0	1	0	0
Neni 232 Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	2	0	0	0	0	0
Neni 232/a Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	4	1	1
Neni 232/b Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	0	0	0	1	0	0



Neni 233 Krijimi i turmave të armatosura	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234 Prodhimi i armëve luftarake	0	0	0	0	0	0	0
Neni 234/a Organizata terroriste	2	0	0	0	0	0	0
Neni 234/b Banda e armatosur	0	0	0	0	0	0	0

2.2.3 Dënimet

Nga raportet vjetore të Prokurorisë së Përgjithshme për intervalin kohor 2015–2018, për veprat penale me qëllime terroriste, rezulton informacioni si më poshtë:

Veprat penale me qëllime terroriste

Veprat Penale me Qëllime Terroriste	Veprat Penale me Qëllime Terroriste													Totali
	Neni 230 - Vepra me qëllime terroriste	Neni 230/a - Financimi i terrorizmit	Neni 230/b - Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin	Neni 230/c - Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose të ushtrimit të detyrës e profesionit	Neni 230/ç - Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur	Neni 231 - Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit	Neni 232 - Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	Neni 232/a - Nxiti, thirja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	Neni 232/b - Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste	Neni 233 - Krijimi i turmave të armatosura	Neni 234 - Prodhimi i armëve luftarake	Neni 234/a - Organizata terroriste	Neni 234/b - Banda e armatosur	
2015	Nr. Proc. Regj.	6	0	0	0	0	1	0	5	0	0	0	0	12
	Nr. Proc. për gjykim	0	0	0	0	0	1	0	2	0	0	0	0	3
	Nr. Pand. Regj.	0	0	0	0	0	1	0	7	0	0	0	0	8
	Nr. Pand. për gjykim	0	0	0	0	0	1	0	10	0	0	0	0	11
	Nr. Pand. dënuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
2016	Nr. Proc. Regj.	1	0	0	0	0	0	3	0	1	0	1	0	6
	Nr. Proc. për gjykim	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Nr. Pand. Regj.	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Nr. Pand. për gjykim	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1
	Nr. Pand. dënuar	0	1	0	0	0	9	0	0	0	0	0	0	10
2017	Nr. Proc. Regj.	1	3	1	0	0	0	0	0	1	0	0	0	6
	Nr. Proc. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. Pand. Regj.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. Pand. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. Pand. dënuar	0	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0	1
2018	Nr. Proc. Regj.	0	4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	4
	Nr. Proc. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. Pand. Regj.	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. Pand. për gjykim	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
	Nr. Pand. dënuar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0



Siç vihet re edhe nga sa më sipër për periudhën 2015–2018, rezultojnë 11 persona të dënuar për kategorinë e veprave të mësipërme, nga të cilët 10 persona për veprën penale të parashikuar nga neni 231 i Kodit Penal “Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit”. Në total këta individë janë dënuar me 126 vjet burg, ku dënimet për secilin prej tyre varion 7–18 vjet. Ndërkohë rezulton vetëm një i dënuar për veprën penale të “Financimit të terrorizmit”.

2.2.4 Masat e marra në luftën kundër terrorizmit

Gjatë implementimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit 2016–2020 janë ndërmarra masa të rëndësishme në kuadrin ligjor, institucional dhe të ngritjes së kapaciteteve.

- Reagimi i Shqipërisë ndaj rrezikut për akte terroriste apo financimin e tij deri tani ka qenë nëpërmjet masave si më poshtë:

- Ndryshimet ligjore me ligjin nr. 144/2013 dhe ligjin nr. 98/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë”, ku përveç nenit 265 të Kodit Penal, “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve”, u shtuan *nenet 265/a, 265/b dhe 265/c përkatësisht “Pjesëmarrja në veprime luftarake në një shtet të huaj”, “Organizimi për pjesëmarrje në veprime luftarake në një shtet të huaj”, “Thirrja për pjesëmarrje në veprime luftarake të dhunshme në një shtet të huaj”.*

- Ngritja e Njesisë për Hetimin e Financimit të Terrorizmit, në përbërje të Drejtorisë së Antiterrorit, në zbatim të rekomandimeve të MoneyVal në funksion të hetimit të veprës penale të “Financim i terrorizmit”.

- Hartimi dhe miratimi i Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit 2016–2020, miratuar me VKM nr. 930, datë 18.11.2015.

- Hartimi i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, me VKM nr. 930, datë 18.11.2015. Aktualisht kjo strategji është duke u rinovuar duke e trajtuar parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta dhe të koordinuara për reduktimin e kërcënimeve të sigurisë kombëtare nga këto fenomene.

- Miratimi i “Strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013–2020” dhe Planit të Veprimit

për vitet 2013–2016, me VKM nr. 663, datë 17.7.2013, strategji e cila synoi zhvillimin e politikave të duhura për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë në vend, nëpërmjet:

a) rritjes së efikasitetit të standardeve të menaxhimit të personelit në çdo agjenci apo strukturë;

b) rritjes dhe forcimit të masave në drejtim të parandalimit të akteve terroriste dhe ekstremizmit;

c) rritjes së kapaciteteve operacionale dhe goditjes së krimit të organizuar bazuar në vlerësimin e kërcënimeve dhe hetimeve proaktive;

d) rritjes së bashkëpunimit me strukturat e brendshme dhe partnerët rajonale të BE-së, si dhe institucionet relevante të sistemit të Kombeve të Bashkuara për luftën ndaj krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme, krimit financiar dhe korrupsionit;

e) rritjes së kapaciteteve investiguese dhe orientimin e këtyre strukturave drejt inteligjencës.

Kjo strategji është rinovuar me strategjinë për luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda 2021–2025 dhe planit të veprimit për zbatimin e saj 2021–2022.

- Miratimi i strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla e të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024 dhe planit të saj të veprimit 2019–2021 i rinovuar së fundmi për periudhën 2022–2024 ku parashikohen një sërë masash për kontrollin e armëve të vogla e të lehta, municioneve dhe eksplozivëve duke reduktuar aksesin dhe burimet e personave dhe organizatave terroriste në sigurimin e armëve apo lëndëve plasëse për t’i përdorur ato për kryerjen e akteve terroriste.

- Krijimi i “Qendrës së Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH)” si institucion koordinues për çështjet e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm.

- Një vit më vonë nga hartimi i VKM-së nr. 930, datë 18.11.2015 u emërua Koordinatori Kombëtar kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (KEDH), me qëllim bashkërendimin e zbatimit të strategjisë kombëtare. Pothuajse dy vjet më vonë (VKM 737, dhjetor 2018), Zyra Kombëtare e Koordinatorit të KEDH-së u shndërrua në Qendrën e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH e njohur edhe si Qendra CVE) si agjenci në varësi të Kryeministrit.

- Miratimi i strategjisë kombëtare për luftën



kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planit të veprimit me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 930, datë 18.11.2015, e cila u përqendruar në tri fusha prioritare: shtrirja dhe angazhimi i komunitetit; luftimi i propagandës ekstremiste duke promovuar vlerat demokratike; dhe hartimi i politikave afatgjata gjithëpërfshirëse kundër ekstremizmit të dhunshëm.

- Kryerja e disa hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta ndërkombëtare të cilat janë finalizuar me ndalimin, arrestimin dhe dënimin e individëve të dyshuar për veprimtari të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

- Anëtarësimi i strukturave të Policisë së Shtetit në Pikat Fokale “HYDRA”, “DOLPHIN” dhe “TRAVELLERS”.

- Rritja e bashkëpunimit në nivel operacional dhe në shkëmbimin e shpejtë të informacionit midis strukturave ligjzbatuese në vend.

- Monitorimi në territorin e Republikës së Shqipërisë të individëve shtetas shqiptarë dhe të huaj të dyshuar për përfshirje në konfliktin e armatosur jashtë vendit, në bashkëpunim me shërbimet partnere të huaja dhe agjencitë inteligjente e ligjzbatuesenë vend, si: SHISH, Prokuroria/SPAK, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, AISM etj.

- Përfshirja e **18 individëve** nga Shqipëria, të dyshuar për veprimtari kriminale në fushën e terrorizmit, në “**Lista e brendshme e personave të shpallur**”, me VKM, bazuar në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”.

- Implementimi nga Policia e Shtetit e Programit “*Kundër ekstremizmit të dhunshëm përmes policimit në komunitet*”.

- Hartimi dhe implementimi nga institucionet përgjegjëse i Planit dhe Planit Shtesë të Veprimit Ndërshtetëror, “*Për pritjen dhe riintegrimin e shtetasve që pritet të kthehen nga vendet e konfliktit Siri/Irak*”, miratuar me Urdhër të Kryeministrit nr. 169, datë 1.11.2018 dhe nr. 148 datë 5.11.2019.

- Vendi ynë së fundmi ka aprovuar Strategjinë për Mbrojtje Kibernetike 2021–2023 qëllimi i së cilës është mbajtja e një hapësire kibernetike të besueshme e të sigurt, strategji e cila shtrin efektet edhe në parandalimin e terrorizmit kibernetik.

- Aplikimi i programit për “Shkollat për Komunitete më të Sigurt” me qëllim edukimin e të rinjve, trajnimin e mësuesve në të gjithë Shqipërinë

për rreziqet e radikalizimit të dhunës në mesin e të rinjve.

- Nënshkrimi, implementimi dhe zbatimi i disa marrëveshjeve e protokolleve të bashkëpunimit me disa vende të rajonit, Evropës dhe SHBA-së, në fushën e sigurisë dhe luftës kundër terrorizmit (aktualisht 21 marrëveshje e protokolle bashkëpunimi).

- Miratimi i strategjisë ndërsektoriale të sigurisë në komunitet 2021–2026 dhe planit të saj të veprimit 2021–2023 ka luajtur një rol të rëndësishëm në implementimin e programeve të policimit në komunitet dhe implementimin e programeve të rehabilitimit dhe riintegrimet por edhe në rritjen e rolit të mekanizmave parandalues si Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike, duke parashikuar masa për rritjen e efektivitetit të tyre në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit si edhe duke ndërgjegjësuar dhe forcuar kapacitetet e aktorëve të vijës së parë për identifikimin dhe referimin e rasteve të evidentuara.

- Ndryshimet kushtetuese të vitit 2016 parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale dhe një prokurorie të posaçme, me kompetencë lëndore sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës. Kodi i Procedurës Penale, i ndryshuar, në nenin 75/a të tij, detajonte kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, duke përcaktuar kompetencën për kategori të caktuara të veprave penale dhe kompetencën për kategori të caktuara subjektsh. Sa më sipër, veprat penale me qëllime terroriste që ishin në kompetencë të gjykatës për krime të rënda, nuk u përfshinë në kompetencë të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, por gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Për pasojë edhe kompetenca në hetimin e tyre i takonte prokurorive pranë gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa në shkronjën “b” të nenit 75/a, përcaktohej se përfshihen në kompetencën e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar çdo vepër penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal. Si rrjedhim, kompetenca lëndore e hetimit të veprave me qëllime terroriste, me krijimin e Prokurorisë së Posaçme i përkiste gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ndërsa çdo vepër penale e kryer nga organizata terroriste (një formë e



veçantë e organizatës kriminale, e përbërë nga dy ose më shumë persona, që kanë një bashkëpunim të qëndrueshëm në kohë, me synim kryerjen e veprave me qëllime terroriste), sipas përcaktimeve të Kodit Procedurës Penale, u përcaktua në kompetencë të Prokurorisë së Posaçme. Në rastet e procedimeve të lidhura ndërmjet tyre dhe që nuk mund të ndaheshin, pasi rezultoi pjesërisht në kompetencë të gjykatës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe pjesërisht në kompetencë të gjykatave të zakonshme dhe kur rezultonte se subjekt i procedimit ishte një organizatë terroriste, në bazë të nenit 80 të Kodit të Procedurës Penale, kompetenca për këto raste i takonte gjykatës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në këto kushte, me qëllim eliminimin e vështirësive që u hasën për ndjekjen penale të veprave me qëllime terroriste dhe financimin e terrorizmit u miratuan me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, kompetencat lëndore të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, bazuar në nenin 135 të Kushtetutës. Në sferën e juridiksionit të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar u përfshinë edhe gjykimi i veprave penale me qëllime terroriste sipas neneve vijuese: neni 230 “Vepra me qëllime terroriste”, neni 230/a “Financimi i terrorizmit”, neni 230/b “Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera, që financojnë terrorizmin”, neni 230/c “Dhënia e informacioneve nga persona që ushtrojnë funksione publike ose në ushtrim të detyrës a profesionit”; neni 230/9 “Kryerja e shërbimeve dhe veprimeve me persona të shpallur”; neni 231 “Rekrutimi i personave për kryerjen e veprave me qëllime terroriste ose të financimit të terrorizmit”; neni 232 “Stërvitja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”; neni 232/a “Nxitja, thirrja publike dhe propaganda për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”; neni 232/b “Kanosja për kryerjen e veprave me qëllime terroriste”; neni 233 “Krijimi i turmave të armatosura”; neni 234 “Prodhimi i armëve luftarake”; neni 234/a “Organizata terroriste”; neni 234/b “Banda e armatosur”. Kalimi i kompetencës së hetimit të veprave me qëllime terroriste nga prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm te SPAK

çfarë ka sjellë edhe nevojën e reflektimit të kësaj përgjegjësie të re në implementimin e masave dhe aktiviteteve të parashikuara në planin e veprimit të strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër terrorizmit.

Prioritet i Prokurorisë në luftën kundër terrorizmit është goditja në të gjitha format e shfaqjes së tij dhe përmbytja e këtij angazhimi ka në fokus rritjen e cilësisë së hetimit dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me agjencitë e specializuara në këtë fushë, si dhe orientimi drejt një politike të ashpër dënimi.

Kjo është e lidhur ngushtësisht me forcimin e kapaciteteve për hetimin e veprave penale që lidhen me terrorizmin nëpërmjet përmirësimit të teknologjisë dhe trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore që hetojnë këto vepra. Ndjekja e praktikave më të mira të luftës kundër terrorizmit, si dhe analizimi i legjislacionit shqiptar, përbën bazën për procesin e trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar për hetimin e veprave penale që lidhen me terrorizmin.

2.2.5 Financimi i terrorizmit

Faktorët që ndikojnë në cenueshmëri (dobësitë) të sistemit dhe që mund të shfrytëzohen apo mund të lehtësojnë veprimtarinë e terroristëve

1. Pozicioni gjeostrategjik i Shqipërisë (flukse të mëdha të qarkullimit të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve ndërkombëtare), krijon kushte që vendi të synohet jo vetëm si një pikë transiti i mundshëm për trafiket dhe aktivitetet e paligjshme, por edhe për përhapjen e sindromës së terrorizmit, veçanërisht atij me baza fundamentaliste.

2. Prania e individëve dhe grupeve që mbështesin ose promovojnë ekstremizmin e dhunshëm

Në vendin tonë ka të dhëna për ekzistencën e mbështetësve të veçantë të ideologjive radikale. Nuk janë evidentuar figura drejtuese në radhët e mbështetësve dhe nuk operojnë në formë të mirëorganizuar por veprimtaria zhvillohet nga grupime të fragmentizuara që zhvillojnë aktivitet të pakoordinuar me njëri tjetrin.

3. Vështirësitë në kontrollet e kufijve

Mbetet problem niveli i ulët i deklarimeve në kufi. Edhe gjatë 2015–2018 ndër të tjera është venë re se:



- paraja fizike ka një përdorim të lartë, mirëpo deklarimet në kufi janë ende të ulëta dhe në pika të veçuara kufitare,

- disporporcion midis numrit të deklarimeve në hyrje (numër i vogël) dhe deklarimeve në dalje;

- rastet sporadike të dedektimit të mosdeklarimit, ndëshkimi në nivel të ulët dhe mos konfiskimi i shumave.

- Edhe nga një analizë sektoriale e kryer nga DPPPP-ja, për periudhën janar–tetor 2016, vihet re se situata është e njëjtë.

- Fluksi i madh e pasagjerëve dhe automjeteve sidomos gjatë sezonit të pushimeve, shton mundësinë për kalim të sasive të parasë fizike të padeklaruar.

4. Përdorimi i gjerë i parasë fizike

Ekzistenca e një ekonomie ku përdorimi i parasë fizike është i lartë, krijon mjaft avantazhe për personat e përfshirë në veprimtari kriminale duke siguruar anonimitet dhe mundësinë për të mos lënë gjurmë.

5. Përdorimi i mjeteve të reja të komunikimit për propagandë

Hapësira kibernetike, të cilën çdo njeri mund ta përdorë pa kufij kohorë dhe gjeografikë, jep në mënyrë të padiskutuar avantazhe dhe mundësi për hakerat. Propaganda terroriste vazhdimisht po zhvendoset në platforma të reja dhe të ndryshme dhe sasia e informacionit të shkëmbyer, qoftë publikisht apo në hapësira private, po rritet.

Në funksion të rekrutimit të anëtarëve të rinj kërkohen fonde, që më pas shfrytëzohen duke përdorur rrjetet sociale, të cilat përveç rekrutimit shërbejnë dhe si një instrument efikas propagande dhe mbledhje fondesh. Përdorimi i internetit siguron një mekanizëm me kosto të ulët në fazat fillestare të rekrutimit ndërkohë që për hapat e mëtejshëm ka kosto shtesë. Shfrytëzimi i mediave sociale për qëllime të rekrutimit dhe propagandës terroriste, është bërë një çështje prioritare për luftën kundër financimit të terrorizmit, pasi shumë organizata terroriste kanë shfrytëzuar mediat sociale për të siguruar fonde nga mbështetësit. Organizatat terroriste më komplekse, investojnë fonde të konsiderueshme në drejtim të operacioneve të sofistikuara propagandistike, që përfshijnë botimin e revistave dhe gazetave, administrimin e faqeve të internetit dhe përdorimin e programeve audiovizive për të promovuar mesazhet dhe pikëpamjet e tyre.

Listimi i brendshëm

Një nga ligjet me karakter administrativ në bazë të së cilit funksionon dhe ushtron detyrat DPPPP është ligji nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i cili ka si objektiv kryesor bllokimin dhe sekuestrimin e fondeve/pasurive, nëpërmjet parandalimit dhe goditjes së veprimtarive të terroristëve dhe e atyre që mbështesin dhe financojnë terrorizmin apo të atyre, për të cilët ka dyshime që kanë kryer, po kryejnë ose kanë qëllim/tentojnë të kryejnë veprimtari të tillë.

Për të kryer këtë detyrim, në ligj parashikohen dy mënyra listimi (nenet 14 dhe 15) sipas të cilave, në mënyrë të shkurtuar:

- e para, ka lidhje me miratimin me VKM të listave të personave të shpallur bazuar në vendimet/rezolutat detyruese të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, proces i cili tashmë kryhet në vendin tonë.

- e dyta, ka lidhje me procedurën e brendshme të shpalljes, e pavarur nga e para, sipas së cilës listimi bëhet me indicie të brendshme nga institucione të mirë përcaktuara⁴, bazuar në parimet dhe/ose detyrimet:

⁴ Neni 15. Procedura e brendshme e shpalljes.

Organet përgjegjëse, organet e zbatimit të ligjit, shërbimet informative, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave që, gjatë ushtrimit të detyrave dhe funksioneve të tyre, kanë marrë dijeni ose kanë dyshime të bazuara në indicie për përfshirje personash, në çdo formë, në vepra të terrorizmit dhe të financimit të tij, të kryera apo që tentohet të kryhen, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara t’i propozojnë menjëherë Ministrin të Financave përfshirjen e tyre në listën e personave të shpallur, si dhe marrjen e masave të parashikuara në këtë ligj.

Për shqyrtimin e rasteve të propozuara, sipas pikës 1 të këtij neni, dhe ato të parashikuara në pikën 2 të nenit 5 të këtij ligji, Ministri i Financave mund të thërrasë një komitet të posaçëm këshillimor, me përfaqësues në nivel të lartë drejtues nga Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Prokuroria e Përgjithshme, Shërbimi Informativ i Shtetit, Banka e Shqipërisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Ministri i Financave mund t’i propozojë Këshillit të Ministrave përfshirjen e personave të propozuar sipas pikës 1 të këtij neni, në listën e personave të shpallur.

Këshilli i Ministrave, brenda 15 ditëve nga marrja e propozimit nga ministri i Financave, mund të vendosë për përfshirjen e personave apo subjekteve të propozuara nga ministri i Financave, sipas pikës 3 të këtij neni, në listën e personave të shpallur.



- e rezolutës 1373 (2001)⁵ të Këshillit të Sigurimit (KS) të Kombeve të Bashkuara,

- të çdo marrëveshjeje ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë apo të vendimeve të BE-së apo vendimit të një shteti tjetër, që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Procedura e dytë, pra shpallja e brendshme, e cila nuk ka lidhje me të parën, është thelbi i sistemit parandalues pasi parashikon detektimin proaktiv, shpalljen dhe njoftimin e KS të OKB-së dhe është e pa ndikuar nga procedimi i mundshëm penal apo pasuror⁶.

Gjatë viteve 2015–2018, në zbatimin e detyrimit për propozim për listim sipas procedurës së brendshme janë listuar si persona të shpallur 20 individë. Nga viti 2018 e në vijim nuk rezultojnë që nëpërmjet kësaj procedure të jenë shpallur subjekte të tjera.

Tab. 17: Lista me personat e shpallur

Viti 2015 ⁷	Viti 2016 ⁸	Viti 2017 ⁹	Viti 2018
2 individë të shpallur	13 individë të shpallur	5 individë të shpallur	-

Në vitet 2015–2017, nga 20 individë të shpallur, 2 individë janë përfshirë në listën e brendshme në bazë të propozimit të një institucioni të huaj dhe pjesa tjetër në bazë të propozimeve të institucioneve vendase.

Raportet e Aktivitetit të Dyshimtë (RAD) për financim të terrorizmit (FT)

DPPPP si njësi e inteligjencës financiare ka si detyrë thelbësorë mbledhjen e rasteve të dyshimta/sinjalizimet, analizimin e tyre, sigurimin e të dhënave shtesë kur duhen dhe referimin e këtyre

⁵ Rezolutë bazë me karakter të përgjithshëm e cila ju bën thirrje shteteve që të bashkëpunojnë, detektojnë dhe të bëjnë propozime për listim në KS të OKB-së për personat e dyshuar si terrorist/financues etj.

⁶ Neni 26 Procedimi penal dhe pasuror. “Pavarësisht nga zbatimi i dispozitave të këtij ligji, prokuroria dhe gjykata, në zbatim të dispozitave procedurale penale apo atyre të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, mund të procedojnë me sekuestrimin dhe konfiskimin e fondeve dhe të pasurive të tjera të bllokuara përkohësisht ose të sekuestruara, në zbatim të këtij ligji”

⁷ VKM Nr. 589 datë 1.7.2015

⁸ VKM Nr. 769 datë 2.11.2016

⁹ VKM Nr. 228 datë 21.3.2017

rasteve në agjencitë e zbatimit të ligjit dhe në Shërbimin Informativ të Shtetit (SHISH). Më poshtë paraqiten të dhëna në lidhje me raportet e aktivitetit të dyshimte të dërguar në DPPPP nga subjektet raportuese dhe rastet e referuara.

Tab. 18: RAD të dërguar në DPPPP nga subjektet raportuese dhe rastet e referuara nga DPPPP-ja

Viti	Nr. i RAD me dyshime për FT	Nr. i referimeve me dyshime për FT
2015	6	2
2016	29	8
2017	12	5
2018	2	2
2019	5	4
Totali	54	21

Duke iu referuar tabelës së mësipërme rastet kur subjektet raportuese kanë dyshuar për financim terrorizmi janë të pakta në numër.

RAD me këto tipologji kryesisht janë dërguar nga subjektet banka (57%) dhe nga subjektet financiare jobankë për shërbimin e transfertës së parave (38%).

Pas analizimit të rasteve të dërguara, DPPPP gjatë 2015–2019 ka referuar në total 21 raste. Megjithëse pas analizimit të mirëfilltë që DPPPP ka bërë ndaj RAD-ve dhe mbledhjes së të dhënave shtesë për to, kryesisht nuk kanë rezultuar dyshime për FT.

Tab. 19: Nr. i referimeve të dërguara nga DPPSH për kategorinë e veprave penale në fushën e terrorizmit

Viti	Nr. i referimeve
2018	5 raste
2019 (3 M)	3 raste

2.2.6 Të dhëna nga raporte ndërkombëtare për situatën e Shqipërisë në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin

Më poshtë paraqiten disa të dhëna të marra kryesisht në burime të hapura, në lidhje me vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare për luftën kundër terrorizmit në vendin tonë.

Sipas raportit të Komisionit Evropian të vitit 2022¹⁰ rezulton se:

Shqipëria ka një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e financimit të

¹⁰ <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>



terrorizmit dhe ka bërë mjaft hapa përpara lidhur me përafrimin me blloqet kryesore të acquis-it të BE-së. Ajo është palë në të gjitha konventat e Këshillit të Evropës kundër terrorizmit, përfshirë ato që mbulojnë konfiskimin dhe sekuestrimin e produkteve të krimit dhe financimin e terrorizmit. Autoritetet duhet të sigurojnë zbatimin efektiv të sanksioneve financiare të synuara të mandatuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, ndër të tjera, duke rritur përfshirjen e institucioneve financiare dhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm, dhe përmes inspektiveve efektive, në përputhje me planin e veprimit të FATF-së. Duhet të vazhdojë puna për parandalimin e risqeve të financimit të terrorizmit në rast të instrumentalizimit të organizatave jofitimprurëse nga grupe të radikalizuara.

Që prej dhjetorit të vitit 2020, vazhdon të zbatohet strategjia kombëtare ndërsektorale kundër terrorizmit dhe plani i veprimit. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) është e vjetër dhe plani i saj i veprimit ka përfunduar, dhe Shqipëria duhet t'i japë përparësi miratimit të strategjisë dhe planit të ri të veprimit. Strategjia e re duhet të jetë plotësisht në përputhje me politikën e BE-së dhe parimet kyç të P/KEDH-së.

Shqipëria ka vazhduar të shënojë progres të mirë në zbatimin e marrëveshjes dypalëshe me BE-në lidhur me operacionalizimin e Planit të Përbashkët të Veprimit për Luftën kundër Terrorizmit për Ballkanin Perëndimor.

Drejtoria Antiterrorizëm e Policisë së Shtetit është organi kryesor i luftës kundër terrorizmit, nën juridiksionin e Prokurorisë së Posaçme dhe Gjykatave të Posaçme. Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes janë po ashtu funksionale në këtë fushë. Personeli i policimit në komunitet i PSH-së është përfshirë në përpjekje parandaluese dhe të paralajmërimit të hershëm. Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është përgjegjëse për ngritjen e kapaciteteve, koordinimin e veprimtarive të P/KEDH-së ndërmjet institucioneve qeveritare dhe mbikëqyrjen e zbatimit të planit të veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm. Në prill të vitit 2022, Qendra e Koordinimit kundër Ekstremizmit të Dhunshëm u transferua nga Kryeministria në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Ky kalim garanton më së miri se varësia e strukturore ofron vazhdimësinë e punës së qendrës dhe se qendra do të vazhdojë të ketë autoritetin dhe burimet për të realizuar funksionin e vet të rëndësishëm të koordinimit ndërinstitucional në fushën e ekstrimizmit të dhunshëm. Për këtë do të vazhdojë puna e bërë në vitet e fundit për të përmirësuar kapacitetet e institucioneve për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel vendor; komunitetet vendore dhe këshillat vendore të sigurisë duhet të forcojnë më tej punën e tyre parandaluese. Gjithashtu nevojitet të përmirësohen masat dhe kapacitetet për të trajtuar përmbajtjet terroriste në internet.

Bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacioneve të ndjeshme me partnerët ndërkombëtarë mbetet i kënaqshëm. Megjithëse është arritur progres, Shqipëria duhet t'i përdorë në mënyrë më proaktive produktet, shërbimet dhe kapacitetet e platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit të Europolit. Ajo duhet të vazhdojë të bashkëpunojë me Njësinë e Referimit në Internet të Europolit. Ajo ka marrë pjesë në mënyrë aktive në zbatimin e nismës së Ballkanit Perëndimor kundër terrorizmit, në kuadër të Qeverisjes Integruese të Sigurisë së Brendshme (IISG).

Shqipëria duhet të vazhdojë të përqendrohet te riintegrimi dhe rehabilitimi i personave të kthyer nga Siria, dhe te hetimi dhe ndjekja penale e personave të dyshuar për vepra penale. Ajo duhet të forcojë mekanizmat e menaxhimit të rasteve dhe referimit për të kthyerit dhe individët në risk për radikalizim. Radikalizimi në burgje dhe përmbajtja terroriste online vazhdojnë të jenë çështje që duhen trajtuar. Po ashtu, Shqipëria duhet të vazhdojë të hetojë lidhjet ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit, si dhe të sigurojë harmonizim me legjislacionin e BE-së për eksplozivët dhe prekursorët e tyre, dhe të përditësojë treguesit për Pikën Fokale për Armët e Zjarrit në bazë të rekomandimeve të Këshillit, të korrikut 2021.

Më datë 26 mars 2020, Këshilli i BE-së vendosi të hapë negociatat e anëtarësimit me Republikën e Shqipërisë, duke marrë parasysh progresin e arritur mbi reformat dhe përmbushjen e kushteve të përcaktuara mbështetur dhe në raportin e përditësuar të Komisionit, mars 2020 i cili vlerëson dukshëm progresin e bërë nga Shqipëria.



Sipas raportit të vitit 2020¹¹, të DASH-it:

- Shqipëria vazhdoi të mbështesë përpjekjet ndërkombëtare kundër terrorizmit në 2020 dhe vazhdoi pjesëmarrjen e saj në Aleancën Globale për të mposhtur ISIS-in,

- Shqipëria penalizon veprimet terroriste, financimin e terrorizmit, kryerjen e transaksioneve me personat në listat e sanksioneve të Kombeve të Bashkuara (UN), rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve për kryerjen e veprimeve terroriste, nxitjen e akteve terroriste, krijimin dhe pjesëmarrje në organizata terroriste apo në konflikt të armatosur jashtë vendit.

- Drejtoria e Antiterrorit (DAT) në Policinë e Shtetit ka punuar ngushtë me agjencitë amerikane për të harmonizuar kërkesat e qeverisë shqiptare me ekspertizën dhe burimet që ofrojnë Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nëpërmjet pjesëmarrjes në programin e Asistencës kundër Terrorizmit në Departamentin e Shtetit, DAT është trajnuar për hetimet kundër terrorizmit, metoda special të hetimit, identifikimin dhe sekuestrimin e provave digjitale. Qeveria Shqiptare ka zhvilluar me partnerët ndërkombëtar plane kontigjence dhe kapacitete për të parandaluar dhe përgjigjur ndaj sulmeve terroriste të objektivave të butë “soft targets”.

- Agjencitë ligjzbatuese bashkëpunojnë gjerësisht me Interpol dhe organe të tjera ligjzbatuese ndërkombëtare. Shqipëria vazhdon punën për zbatimin e Rezolutës 2396 në lidhje me Informacionin e Avancuar të pasagjerëve (API) dhe të dhënat e pasagjerit (PNR), i cili përmirëson kontrollin e pasagjerëve në Aeroporte. Ligji është miratuar në mars 2020 dhe Shtetet e Bashkuara dhe Shqipëria e forcuan angazhimin për zbatimin e këtij ligji.

- Në vitin 2020 Shqipëria filloi zbatimin e një regjimi më të rreptë në burgje për të dënuarit e konsideruar të rrezikshëm, të quajtur neni 41-bis, në të cilin përfshihen dhe të dënuarit për vepra me qëllime terroriste.

- Shqipëria vazhdoi të punojë me FATF dhe MONEYVAL për të adresuar dobësitë e identifikuara në pastrimin e parave/luftën kundër financimit të regjimit të terrorizmit. Nga 40 Rekomandimet e Task-Forcës së Veprimit

Financiar, Shqipëria është vlerësuar “e përputhur” në 5 rekomandime dhe “e papërputhur” në 1 rekomandim. Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave është pjesë e Grupit Egmond.

- Qendra Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm është shumë aktive në koordinimin e planit të veprimit për Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe donatorëve ndërkombëtarë dhe përpiqet të garantojë bashkëpunimin e të gjitha ministrive duke mënjanuar dublikimin e përpjekjeve.

- Policia e Shtetit ka përfshirë në programet e saj të policimit në komunitet masa për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm. Shefat e Policimit në Komunitet janë trajnuar nga qeveria Amerikane për të implementuar projekte me qeveritë lokale duke synuar detektimin e radikalizimit.

- Sipas raportit të vitit 2017 të EUROPOL për situatën e terrorizmit:

- Në disa pjesë të rajonit të Ballkanit Perëndimor, ideologjia radikale islamike e promovuar nga predikuesit radikalë dhe /ose udhëheqësit e disa grupeve selafist, duke sfiduar dominimin tradicional të islamit të moderuar në rajon, ka fituar terren të konsiderueshëm. Bosnja dhe Hercegovina, e ashtuquajtura rajoni i Sanxhakut (me Serbinë dhe Malin e Zi), territoret shqipfolëse në Serbi, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në Kosovë dhe në Shqipëri, kohët e fundit u konsideruan si pikat kryesore të radikalizimit, rekrutimit dhe aktiviteteve lehtësuese të FTF-ve të destinuar për Sirinë.

Në nëntor të vitit 2016, autoritetet kompetente të Shqipërisë, Kosovës dhe të Republikës së Maqedonisë së Veriut penguan shfaqjen e dy sulmeve terroriste të planifikuara për t'u kryer në territorin e tyre, me 19 arrestime në Kosovë dhe gjashtë në Shqipëri dhe në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Sipas Raportit të EUROPOL¹² për terrorizmin në vitin 2021:

“Shqipëria, raportoi nëntë hetime të zhvilluara për vepra me qëllime terroriste që përfshinin 14 individë. Të dhënat nuk përbënin grup dhe përfshinin të kthyerit, të burgosur të radikalizuar dhe mbështetës të xhibadizmit.”

12

¹¹ <https://www.state.gov/reports/country-reports-on-terrorism-2020/albania/>

https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Tesat_Report_2021_0.pdf



Sipas raportit të Europol¹³ të vitit 2022 për terrorizmin:

“Në vitin 2021, është raportuar vetëm një Incident për vepra me qëllime terroriste në Ballkanin Perëndimor. Në prill 2021 një 34-vjeçar u arrestua, pasi qëlloi me thike pesë persona në një xhami në Tiranë. Gjatë procesit gjyqësor, autori u vlerësua se nuk kishte probleme të shëndetit mendor dhe u vendos dërgimi në një spital psikiatrik.”

2.2.7 Drejtimit kryesore që do të trajtohen në këtë strategji

Detyrimi i organit të prokurorisë që në përputhje me legjislacionin penal vendas, të ushtrojë ndjekjen penale për luftëtarët e huaj, kur merr dënimin për kryerjen e veprave penale.

Vëmendja e shtuar në mbikëqyrjen e ekzekutimit të vendimeve penale, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera shtetërore në zbatimin e programeve të përshtatshme për të dënuarit që kanë kryer vepra me qëllime terroriste.

Kujdes i veçantë i duhet kushtuar kohës dhe vendit të caktuar për paraburgimin dhe vuajtjen e dënimit, duke mbajtur në vëmendje të drejtat e njeriut dhe nevojat e sigurisë.

Duke mbajtur në konsideratë garantimin e një procesi që respekton të drejtat e njeriut dhe mbi të gjitha mosdiskriminimin, kërkesat në caktimin e masave të sigurimit dhe dënimit si dhe caktimi i vendit të vuajtjes së dënimit, duhet të sigurojnë ndëshkimin e duhur që të pengojë veprimtarinë terroriste, të parandalojë radikalizimin brenda sistemit të burgjeve, të ulë recidivizmin dhe të synojë riintegrimin.

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë.

Dëshmitarëve, informatorëve, bashkëpunëtorëve duhet t'u sigurohet mbrojtje në përputhje me ligjin, në mënyrë që të garantohet pjesëmarrja në procesin penal dhe mbrojtja e integritetit fizik të tyre dhe i familjarëve. Në këtë kuptim, përfshirja në programin e mbrojtjes mund të jetë një alternativë, ashtu si konsiderimi si dëshmitar me identitet të fshehur etj. Rol të rëndësishëm në proces kanë edhe viktimat e këtyre veprave dhe mbrojtja e asistencës ndaj tyre duhet të jetë e garantuar.

Koordinimi dhe analizimi i informacionit të agjencive të ndryshme.

Sigurimi i bashkëpunimit dhe koordinimi është

vendimtar për të parandaluar terrorizmin. Shkëmbimi i informacionit në kohë reale nga burime të ndryshme, si: agjenci ligjzbatuese, agjenci bankare, shërbime inteligjente, partnerë ndërkombëtarë etj., dhe analiza e kujdesshme e tij, duke përdorur edhe ekspertizën e këtyre institucioneve, është një mjet i rëndësishëm në këtë drejtim. Informacioni i shkëmbyer ndërmjet institucioneve informative në parim është informacion “sekret shtetëror” e për pasojë ka një sërë masash të posaçme mbrojtjeje. Kur është rasti kërkohen masat e përshtatshme mbrojtëse edhe gjatë procesit penal, si gjykimi me dyer të mbyllura, teknika të veçanta të marrjes në pyetje etj..

Përdorimi i metodave speciale të hetimit

Kuadri ynë ligjor mundëson përdorimin e mjeteve të posaçme për kërkimin e mbledhjen e provave për të hetuar një çështje penale dhe parandaluar pasojat e saj. Këto mjete, janë veçanërisht eficiente në hetimin e veprave penale me qëllime terroriste.

Goditja e mjeteve të tjera që përdoren për të përgatitur e kryer vepra terroriste.

Lufta ndaj veprave të tjera penale që shërbejnë për të përgatitur terrenin për kryerjen e veprave me qëllime terroriste, është një nga kushtet më të rëndësishme në luftën ndaj terrorizmit. Kështu, informacioni mbi aktivitetet financiare të të dyshuarve terroristë mund të japë të dhëna me vlerë në hetimet kundër terrorizmit, duke ndihmuar në zbulimin e planeve të rrjeteve terroriste, identifikimin e bashkëpunëtorëve etj.; ndjekja e veprave penale që lidhen me kultivimin e trafikimit të drogës ndërpret një burim të ardhurash që shndërrohen në fonde për trajnimin e terroristëve; hetimi e dënimi i mbajtjes e trafikut të armëve, armëve shpërthyesë e municionit, mbajtjes e trafikimit të lëndëve plasëse, djegëse, helmuese apo radioaktive, kalimit të paligjshëm të kufirit, krimet kibernetik.

Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi ndërkombëtar duhet të jetë eficient në kohë dhe në mjete të përdorura, jo vetëm nëpërmjet kërkesave për ekstradim, letërporosi etj. por edhe nëpërmjet ndarjes së informacionit në kohë reale nëpërmjet pikave të kontaktit, ngritjes së skuadrave të përbashkëta hetimore etj., në përputhje me kuadrin ligjor konkret.

13

https://www.europol.europa.eu/cms/sites/default/files/documents/Tesat_Report_2022_0.pdf



3.1 Vizioni i strategjisë

3.1.1 Vizioni

“Shqipëria, një shoqëri e sigurt pa kërcënime terroriste, me realitetin dhe imazhin e një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë.”

Vizioni i strategjisë bazohet në vizionin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020 *“Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë”*. Në kuadër të shtyllës së ‘Mirëqeverisjes, Demokracisë dhe shtetit të së Drejtës’, SKZHI paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive sektoriale që synojnë **parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe uljen e kërcënimeve terroriste** nëpërmjet:

- rritjes së rezultateve në luftën kundër terrorizmit përmes vendosjes dhe përdorimit të një sistemi efikas të vlerësimit të riskut, shoqëruar me forcimin institucional të njësive të angazhuara në këtë fushë.

- rritje në numrin e operacioneve që përdorin metoda të hetimeve speciale;

- rritje në numrin e operacioneve ndërkombëtare të përbashkëta; dhe

- rritje në shkallën e zbulimit dhe parandalimin e veprave me qëllime terroriste;

- ngritjes së një rrjeti të sigurt komunikimi për shkëmbimin e informacionit midis agjencive të angazhuara në luftën kundër terrorizmit.

- efikasitetit të hetimeve të krimeve kibernetike; me përmbajtje radikaliste, ekstremiste dhe terroriste;

- parandalimi dhe ulja e kërcënimeve terroriste;

- konsolidimi shërbimit të inteligjencës dhe atij hetimor drejt një shërbimi më bashkëkohor në procedura, mjete dhe teknologji;

- forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm synon të reformohet dhe të ngrejë kapacitetet e saj duke marrë përgjegjësitë e duhura në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm, të konsolidojë dhe institucionalizojë aktivitetet e saj trajnuese me të gjithë aktorët shtetërore e joshetërore, të zhvillojë më tej komunikimin strategjik në interes të ndërgjegjësimit, të zgjerojë produktet e saj analitike dhe vlerësimet e specializuara. Në interes të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm do të ngrejë mekanizma

institucionalë që do rrisin dhe formalizojnë bashkëpunimin me institucionet ligjzbatuese dhe do të synohet normimi i këtij bashkëpunimi me synim mbështetjen sa më mirë të përmbushjes së përgjegjësisë së saj. Qendra kundër Ekstremizmit të Dhunshëm synon të rrisë efektshmërinë duke punuar në drejtim të kompjuterizimit/digjitalizimit për mbledhjen e të dhënave, me qëllim vlerësimin e situatës dhe realizimin e ndërhyrjeve për parandalimin e akteve të ndryshme terroriste nga institucionet përkatëse, por edhe duke mbështetur riintegrimin e personave të radikalizuar në një mënyrë efikase me një qasje institucionale të integruar.

Theksi për arritjen e vizionit të kësaj strategjie do të vihet në parandalimin e akteve terroriste, duke përdorur një përgjigje të koordinuar nga institucionet shtetërore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Çdo reagim duhet patjetër të marrë në konsideratë faktin se një sulm terrorist nuk do të jetë i suksesshëm nëse ekzistojnë planet e parandalimit të sulmeve terroriste dhe strukturat e nevojshme me qasje gjithëpërfshirëse për mbledhjen e trajtimit efikas të informacionit, ndërveprimit, dhe reagimit të shpejtë.

Për të arritur këtë objektiv, do të jetë e nevojshme që të evitohen dëmet nga aktet e mundshme terroriste dhe ekstremiste duke:

- Ndjekur sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme persona të përfshirë në terrorizëm.

- Mbrojtur zonat që janë shumë të rëndësishme për funksionimin e vendit dhe duke reaguar në mënyrë efektive në rastin e një incidenti.

Të parashikohen e përfundojnë aktet e nevojshme ligjore dhe normative për objektet e infrastrukturën kritike të vendit që mund të jenë objekt i sulmeve terroriste dhe që mund të sjellin pasoja të rënda për vendin. Për këtë fakt të parashikohen edhe rrugët për zgjidhjet e situatave që mund të lindin nga përgatitjet apo tentativat e mundshme terroriste.

Në përgjithësi, theksi i objektivave specifike në lidhje me parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm, fokusohet në ndërgjegjësimin e institucioneve të ndryshme shtetërore me përgjegjësi në këtë fushë në fuqizimin e strukturave të posaçme dhe mandatimin e roleve shtesë të tyre që do të ndihmojnë në ngritjen e një entiteti shtetëror



potencial për koordinimin e përpjekjeve mbarë shtetërore në kryerjen vlerësimeve periodike të nevojave, kryerjen e analizave dhe vlerësimeve funksionale ndaj fenomenit, shkëmbimin e informacionit të nevojshëm me struktura inteligjente dhe ligjzbatuese. Zgjerimi i përgjegjësive do të mbështetëse dhe të garantojë rolin bashkërendues dhe koordinues në nivel kombëtar, si bërthamë qendrore, duke shfrytëzuar përvojën praktike dhe aspektet pozitive të fituara gjatë viteve të fundit në punën e kryer pranë komuniteteve në rrezik dhe familjeve të luftëtarëve të huaj të kthyer në Shqipëri, dhe parandalimit të fenomenit. Për arritjen e këtij qëllimi do të zhvillohet një analizë ligjore dhe funksionale në lidhje me kapacitetet dhe strukturat kombëtare në fushën e ekstremizmit duke identifikuar mangësitë dhe boshllëqet në kapacitetet parandaluese dhe ato të lajmërimit të hershëm, inteligjente dhe hetimore si dhe ato goditëse e reaguese. Në varësi të gjetjeve do të hartohet kuadri i nevojshëm ligjor dhe institucional për plotësimin e kapaciteteve dhe nevojave kombëtare në këtë drejtim.

Hartimi i udhëzuesit të indikatorëve/treguesve, shenjave të hershme që shfaqin personat e radikalizuar do të jetë një dokument që do të sjellë një qasje të re për hartimin e raporteve të të indikatorëve, duke synuar në lehtësimin e punës së QKEDH-së dhe të ministrive të linjës, të cilat janë përgjegjëse për grumbullimin e informacionit dhe konkretizimin e tij në raporte periodike vjetore mbi progresin e arritur në drejtim të masave prioritare të parashikuara për periudhën 2023–2025.

Gjithashtu, një aspekt ku QKEDH-ja synon të fokusohet është komunikimi strategjik i cili është një proces ku kërkohet ekuilibër ndërmjet dhënies së qartë të mesazhit, pa stigmatizuar grupe të veçanta dhe synon të ndërgjegjësojë aktorët e vijës së parë.

Një ndër bashkëpunëtorët kyç për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm është shoqëria civile.

3.1.2 Misioni

“Krijimi i kapaciteteve, sistemeve efektive kombëtare, koordinimit e bashkëpunimit kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar për parandalimin e radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm, luftën kundër terrorizmit, hetimin dhe mbrojtjen nga aktet terroriste, si edhe për rehabilitimin dhe riintegrimin e individëve të radikalizuar ose të kthyerve nga zonat e konfliktit.”

3.1.3 Indikatorët e impaktit dhe indikatorët e rezultatit

- Impakti ekonomik

Kjo strategji do të ketë një impakt të drejtpërdrejtë në ekonominë e vendit, pasi do të krijojë një mjedis më të sigurt për sektorin privat ku nëpërmjet sigurisë së komuniteteve dhe partnershipit publik-privat të lidhur me rritjen e punësimit dhe mirëqenies sociale. Hetimi i financimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit dhe rritja e kapaciteteve zbuluese ka impakt në përmirësimin e nivelit ekonomik, uljen e papunësisë dhe varfërisë, dhe krijon kushte për uljen e gjasave të rekrutimit të personave të caktuar të cilët bëhen rrezik potencial për të kryer akte terroriste. Programet që lidhen me ndërgjegjësimin, ngritjen dhe rritjen e kapaciteteve të aktorëve të vijës së parë, edukimin, krijimin e mundësive për punësimin dhe angazhimin e të rinjve në aktivitete afër komunitetit, rehabilitimit, riintegrimin, risocializimin dhe deradikalizimin e të kthyerve nga zonat e konfliktit. Këta faktorë sjellin uljen e rasteve të radikalizimit dhe anëtarësimit në organizata terroriste, duke ndikuar edhe në krijimin e një mjedisi të sigurt për investime të brendshme dhe të huaja.

-Impakti social

Pasojat e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit shtrihen edhe në rrafshin social të një vendi. Ato ndikojnë negativisht në elementët socialë dhe etikë të një shoqërie, vlerat morale dhe normat shoqërore, integritetin e individit, sferën private, perceptimin e sigurisë publike etj. Ekstremizmi i dhunshëm, ashtu si krimi i organizuar, është një kërcënim për sigurinë në vend. Niveli i ulët arsimor, ndikimi i komuniteteve fetare jo zyrtare me tendencë radikale që nxit dhunën ekstreme dhe përdorimi i mjeteve online të propagandës fetare shpesh herë janë bërë faktorë për radikalizimin e individëve që zhvillojnë prirje për të kryer akte terroriste. Individët që vijnë kryesisht nga zonat e thella rurale, zonat pa investime në infrastrukturë, pa arsim, zona të cilat kanë probleme socio-ekonomike, kthehen në potencial të mundshëm për t'u radikalizuar dhe për të kryer akte terroriste. Megjithatë, edhe zonat urbane, sidomos kryeqyteti, janë shndërruar në zona të nxehta “hotspot” për përhapjen e ideologjive radikale që çojnë në terrorizëm, si rasti i shtetasve që kanë udhëtuar drejt zonave të



konfliktit në Siri dhe Irak. Nga kjo pikëpamje, strategjia do të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e aspektit social dhe etik të shoqërisë shqiptare, duke promovuar vlerat morale dhe normat shoqërore, integritetin dhe etikën, sferën private, perceptimin e sigurisë publike etj.

- Impakti mjedisor

Aktet terroriste zhvillohen në forma të ndryshme dhe disa prej tyre kanë impakt të drejtpërdrejtë në mjedis. Kjo ndodh në rastet kur për të realizuar këto akte përdoren substanca të dëmshme, kimike, radioaktive dhe biologjike. Përdorimi i substancave kimike në një sulm terrorist, i ashtuquajtur terrorizëm kimik, është një formë e një terrorizmi jokonvencional. Nga kjo pikëpamje, strategjia do të luajë një rol të rëndësishëm në forcimin e kontrollit të substancave me natyrë toksike, radioaktive, kimike dhe biologjike të rrezikshme dhe në rritjen e sigurisë për parandalimin e përdorimit të tyre në mjedis, por edhe në përdorimin e armëve të shkatërrimit në masë duke kontrolluar trafikimin e tyre dhe transportimin e tyre. Gjithashtu, duke shtuar vëmendjen dhe prezencën në zonat e mbrojtura mjedisore, do të garantohet mbrojtja e burimeve të tyre natyrore.

- Impakti ndërsektorial

Angazhimi i një sërë institucionesh shtetërore dhe kapacitetesh njerëzore, rritja e shkëmbimit të informacionit dhe aksesueshmërisë së tij si dhe rritja e bashkëpunimit ndër-institucional. Implementimi dhe monitorimi i strategjisë së re, për shkak të gamës së gjerë të fushave që do të mbulojë, do të angazhojë një sërë institucionesh shtetërore dhe një numër të madh kapacitetesh njerëzore. Njëpërmjet bashkëpunimit ndërsektorial, strukturat do të koordinojnë përpjekjet për realizimin e masave në zbatim të planeve të veprimit në fushën e ekstremizmit të dhunshëm, krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme, terrorizmit dhe krimit kibernetik me fokus përmbajtjen terroriste online.

Indikatorët e impaktit për realizimin e vizionit dhe qasjeve të strategjisë do të jenë:

- Indeksi i kërcënimit terrorist në vend (qasja parandaluese – kërcënimi terrorist në vend në nivelin “i ulët”);

- Indeksi i eficiencës së hetimeve në fushën e terrorizmit (qasja hetuese).

PJESA II QËLLIMI I STRATEGJISË DHE OBJEKTIVAT SPECIFIK

Institucionet e Republikës së Shqipërisë me kohë kanë identifikuar kërcënimet dhe kanë ngritur shqetësime mbi pasojat e mundshme nga përhapja e ideologjive ekstremiste dhe radikaliste që çojnë në terrorizëm në Republikën e Shqipërisë.

Bazuar në këto shqetësime dhe kërcënimet e identifikuara, institucionet e Republikës së Shqipërisë, ndër të parat në rajon, kanë ndërmarrë veprime dhe aktivitetet konkrete, në përballjen me ekstremizmin e dhunshëm që çojnë në terrorizëm, kryesisht të fokusuar në një qasje strategjike me katër komponentë:

- parandalimi;
- hetimi;
- reagimi, rehabilitimi dhe riintegrimi
- mbrojtja.

QASJA 1: PARANDALIMI I EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT

Parandalimi i terrorizmit lidhet me ndalimin e përhapjes së ideologjive ekstremiste dhe radikalizimit që çon në terrorizëm. Institucionet e vendit në bashkëpunim e koordinim shumë të ngushtë me shoqërinë civile dhe komunitetin fetar kanë hartuar strategjinë ndërsektoriale dhe planet e veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit, të cilat janë fokusuar në parandalimin, minimizimin e faktorëve shtytës që mund të ndikojnë në radikalizëm, deradikalizimin e personave të radikalizuar, riintegrimi i tyre në shoqëri, hetimin dhe ndjekjen penale të autorëve që kryjnë vepra me qëllime terroriste. Për këtë qëllim, është bërë i mundur fuqizimi i aktorëve të vijës së parë në bashkëpunim me ministritë e linjës, agjencitë ligjzbatuese, autoritetet vendore, komunitetet fetare, shoqëria civile, sektorin privat etj., në përputhje me objektivat dhe synimet e Strategjisë Ndërsektoriale për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit 2023–2025.

Parandalimi radikalizimit që çon në terrorizëm, ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit përmes sinjalizimit të hershëm do të arrihet përmes objektivave të mëposhtëm:

- mbajtjes së nivelit të kërcënimit terrorist në nivel “të ulët” duke parandaluar kërcënimet terroriste, financimin e terrorizmit, intensifikuar



masat për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individ të dyshuar për vepra me qëllime terroriste, forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit brenda strukturave të antiterrorit, agjencive inteligjente dhe ligjzbatuese në vend që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit;

- parandalimit të radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin ndërkombëtar, bilateral, rajonal, kombëtar, duke parandaluar radikalizimin nëpërmjet internetit, rritjen e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë darknet-in, parandalimin e radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar dhe me prodhuesit e aplikacioneve në internet, komunikimin strategjik;

- konsolidimit të njohurive dhe vlerësimit të natyrës së kërcënimeve të terrorizmit në vendin tonë përmes identifikimit të hershëm të grupeve të synuara dhe metodave radikale duke vlerësuar dhe analizuar faktorët që çojnë në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm;

- rritjes së kapaciteteve të strukturave të antiterrorit, qendrës së koordinimit kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe strukturave/agjencive të inteligjencës për zhvillimin e vlerësimeve të riskut, analizave dhe verifikimeve paraprake për ekstremizmin dhe terrorizmin;

- ndërgjegjësimit, informimit, zhvillimit të komunikimit strategjik dhe shpërndarjen e kundërnarrativave të ekstremizmit dhe terrorizmit, përmes shkëmbimit të përvojës dhe ekspertizës me vendet e rajonit, krijimin e një rrjeti komunikimi të vazhdueshëm e shkëmbimi të informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të përfshira me qëllim krijimin e programeve dhe manualeve për informimin dhe ndërgjegjësimin ndaj çështjeve që lidhen me rrezikun e radikalizimit, ekstremizmit të dhunshëm dhe pasojave të akteve terrorizmit;

- uljes së rrezikut për radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm, si dhe rrezikut të rekrutimit në sistemin e burgjeve dhe në shërbimin e provës dhe të hartimit të programeve pilot të deradikalizimit dhe riintegritimit në shoqëri të miturve të radikalizuar pas largimit të tyre nga institucionet penitenciare dhe shërbimit të provës;

- rritjes së kapaciteteve profesionale të aktorëve

të vijës së parë për parandalimin e ekstremizmit, radikalizmit të dhunshëm dhe përfshirjes në akte terroriste kryesisht të të rinjve.

QËLLIMI I POLITIKËS 1: MBAJTJA E KËRCËNIMIT TERRORIST NË NIVEL “TË ULËT”

Kjo do të arrihet me forcimin dhe rritjen e masave për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individ të dyshuar për vepra me qëllime terroriste dhe forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit brenda strukturave të policisë së shtetit, agjencive inteligjente dhe ligjzbatuese në vend që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit.

Objektivi specifik 1.1: Parandalimi i terrorizmit

Masa 1.1.1: Kryerja e hetimeve proaktive për parandalimin e akteve të mundshme terroriste, ndaj grupeve dhe individëve ekstremistë që nxisin dhe mbështesin dhunën

Masa 1.1.2: Kryerja e trajnimeve bashkëkohore të strukturave antiterror në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, mbi teknologjitë dhe sistemet e reja për përdorimin e metodave speciale të hetimit

Masa 1.1.3: Kryerja e analizave të përbashkëta të institucioneve të gjurmimit, hetimit, lidhur me grupe kriminale dhe terroriste në hetim dhe të hetuara/gjykuara për terrorizëm

Masa 1.1.4: Vlerësimi i Kërcënimeve Lokale në vend-dislokimet e përhershme të FARSH, si instrumenti informues për Autoritetet e Drejtimit dhe Komandimit të FARSH

Masa 1.1.5: Bashkëpunimi me MM/FARSH në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit (awareness) të personelit ndaj kërcënimit terrorist në vendin tonë dhe vendeve ku angazhohen në kuadër të misioneve ndërkombëtare

Masa 1.1.6: Analiza e profileve të riskut dhe reagimi i shpejtë i strukturave ndërkufitare për parandalimin e personave të dyshuar për terrorizëm ose akteve terroriste

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së rasteve terroriste të parandaluara, përmes hetimeve proaktive

- Indeksi i rritjes së kapaciteteve profesionale për përdorimin e metodave speciale të hetimit

Rezultate të pritshme:

- Rritja e numrit të rasteve të parandaluara, ndër rastet e mundshme terroriste në vendin apo



nëpërmjet vendit tonë, përmes hetimeve proaktive ndaj grupeve dhe individëve ekstremistë që nxisin dhe mbështesin dhunën

- Rritja e numrit të trajnimeve bashkëkohore të strukturave antiterror në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë, mbi teknologjitë dhe sistemet e reja për përdorimin e metodave speciale të hetimit

- Rritja e numrit të rasteve të parandaluara për akte/vepra të mundshme terroriste në vendin apo nëpërmjet vendit tonë, përmes analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit, lidhur me grupe kriminale të hetuara dhe gjykuara për terrorizëm.

Objektivi specifik 1.2: Parandalimi i financimit të terrorizmit

Masa 1.2.1: Kryerja e hetimeve për parandalimin e financimit të terrorizmit.

Masa 1.2.2: Rritja e numrit të trajnimeve të specializuara në fushën e hetimit të financimit të terrorizmit.

Masa 1.2.3: Kryerja e analizës mbi individë/grupe që dyshohet se kryejnë vepra penale lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.

Masa 1.2.4: Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera midis DPPPP, DPT, DPD, dhe institucioneve të tjera të sigurisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në vend për veprat penale të lidhura me financimin e terrorizmit.

Masa 1.2.5: Analizimi i Raporteve të Aktivitetit të Dyshuar për Financim të Terrorizmit dhe dërgimi i informacioneve në organet ligj zbatuese nëse pas verifikimeve përmbajnë dyshime për Financim të Terrorizmit.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së referimeve për financim të terrorizmit.

- Indeksi i rritjes së kapaciteteve profesionale për të detektuar dhe hetuar financimin e terrorizmit

- Indeksi i rritjes së hetimeve të përbashkëta të strukturave të antiterrorit me homologet dhe partnerët.

- Indeksi i rritjes së ndërveprimit midis PSH/DAT, DPT, DPD, DPPPP dhe institucioneve të tjera të sigurisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në vend për financimin e terrorizmit.

Rezultate të pritshme:

- Dhënia e aksesit të strukturave të antiterrorit në databazat e çdo institucioni pjesë e kësaj

strategjie dhe strategjive të tjera përbërëse për shkëmbimin e të dhënave që ndihmojnë në hetimin dhe parandalimin e terrorizmit dhe financimit të tij

- Zbatimi i standardeve dhe mekanizmave të përshtatshme për hetimin e financimit të terrorizmit, duke u fokusuar në mënyrë të veçantë në standardet e BE-së, kërkesave që rrjedhin nga rezolutat e KS të OKB dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtarë në këtë fushë.

- Rritja e numrit të trajnimeve të specializuara në fushën e hetimit të financimit të terrorizmit.

- Rritja e numrit të rasteve të parandaluara përmes identifikimit dhe analizës së situatës së grupeve kriminale që kryejnë apo dyshohet se kryejnë vepra penale lidhur me terrorizmin dhe financimin e terrorizmit.

- Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera midis DPT, PD, DPPPP dhe institucioneve të tjera të sigurisë me institucionet e tjera ligjzbatuese në vend për veprat penale që lidhen me financimin e terrorizmit.

- Rritja e numrit të hetimeve të përbashkëta të strukturave të antiterrorit.

Objektivi specifik 1.3: Intensifikimi i masave për ndjekjen dhe monitorimin e situatës lidhur me shtetasit shqiptarë LHT që mund të kthehen nga zonat e konfliktit Siri/Irak, si dhe çdo individë të dyshuar për vepra me qëllime terroriste

Masa 1.3.1: Mbajtja nën monitorim të vazhdueshëm të personave të kthyer LHT dhe ata që mund të kthehen nga zonat e konfliktit.

Masa 1.3.2: Lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit/operacioneve të përbashkëta me agjencitë inteligjente në vend dhe ato ndërkombëtare lidhur me LHT.

Masa 1.3.3: Monitorimi i rrjeteve sociale dhe mediave elektronike në lidhje me LHT dhe individët e dyshuar për terrorizëm.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së nivelit të parandalimit të kërcënimeve terroriste nga LHT, si rrjedhojë e monitorimit të situatës së personave të kthyer nga zonat e konfliktit.

Rezultate të pritshme

- Krijimi i sistemeve për monitorimin e vazhdueshëm të personave të kthyer dhe ata që mund të kthehen nga zonat e konfliktit.



- Rritja e numrit të marrëveshjeve të bashkëpunimit/operacioneve të përbashkëta me agjencitë inteligjente në vend dhe ato ndërkombëtare lidhur me LHT.

- Identifikimi dhe parandalimi i rasteve të terrorizmit përmes monitorimit të rrjeteve sociale dhe mediave elektronike në lidhje me LHT dhe individët e dyshuar për terrorizëm.

Objektivi specifik 1.4: Forcimi i bashkëpunimit dhe koordinimit të agjencive inteligjente, ligjzbatuese për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe në luftën kundër terrorizmit në vend dhe me shërbime homologe/partnere

Masa 1.4.1: Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera ndërmjet strukturave të PSH dhe institucioneve inteligjente e ligjzbatuese në vend.

Masa 1.4.2: Rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacioneve për verifikimin e terrorizmit në bazë të marrëveshjeve dypalëshe me të gjitha shërbimet homologe e partnere: Europol, SELEC, INTERPOL, Interforza, TSC-SHBA.

Masa 1.4.3: Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera për identifikimin e vendndodhjes dhe kapjen e personave në kërkim ndërkombëtar për vepra me qëllime terroriste.

Masa 1.4.4: Kryerja e hetimeve/operacioneve të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë për individë/grupe të dyshuara për veprimtari që lidhen me terrorizmin brenda dhe jashtë vendit.

Masa 1.4.5: Përdorimi me proaktivitet i produkteve, shërbimeve e platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit Europol.

Masa 1.4.6: Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i të dhënave informative mbi treguesit/indiktorët mbi radikalizimin që ekstremizmi me natyrë fetare, etnike dhe ideologjike me qëllim sinjalizimin e veprimtarive të dyshimta me natyrë terroriste.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i efektivitetit të informacioneve të shkëmbyera midis institucioneve brenda vendit si dhe me shërbimet partnere.

Rezultate të pritshme

- Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera midis institucioneve brenda vendit si dhe me shërbimet e specializuara në BE, Europol, SELEC dhe INTERPOL.

- Rritja e bashkëpunimit dhe shkëmbimi i informacioneve për verifikimin e terrorizmit në

bazë të marrëveshjeve dypalëshe me të gjitha shërbimet homologe sipas nevojës.

- Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera për identifikimin e vendndodhjes dhe kapjen e personave në kërkim ndërkombëtar për vepra me qëllime terroriste.

- Rritja e numrit të hetimeve/operacioneve të përbashkëta me partneret ndërkombëtarë për individë/grupe të dyshuara për veprimtari që lidhen me terrorizmin brenda dhe jashtë vendit.

- Forcimi i kapaciteteve hetimore/identifikuese dhe parandaluese përmes përdorimit me proaktivitet të produkteve, shërbimeve e platformave të komunikimit të Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit Europol.

Objektivi specifik 1.5: Fuqizimi i komuniteteve dhe institucioneve publike për identifikimin dhe raportimin e rasteve të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit (sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm objektivi specifik nr. 1.1 me masat 1.1.1-1.1.32)

Masa 1.5.1: Analizë ligjore dhe funksionale në lidhje me kapacitetet dhe strukturat kombëtare në fushën e ekstremizmit duke identifikuar mangësitë dhe boshllëqet në kapacitetet parandaluese dhe ato të lajmërimit të hershëm, inteligjente dhe hetimore si dhe ato goditëse e reaguese, si dhe përgatitje të kuadrit ligjor dhe institucional për të plotësuar kapacitetet dhe nevojat kombëtare duke bërë ndryshimet e nevojshme ligjore, funksionale dhe strukturore të QKEDH-së.

Masa 1.5.2: Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat e përkatëse në sistemin e burgjeve dhe Shërbimit të Provës në Ministrinë e Drejtësisë për sa i përket identifikimit, analizës, hetimit dhe vlerësimit të shkaqeve që çojnë në radikalizëm si dhe të metodave të rekrutimit në Sistemin e Burgjeve dhe në Shërbimin e Provës.

Masa 1.5.3: Trajnime për personelin e institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) dhe shërbimit të provës, mbi shenjat e hershme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 1.5.4: Trajnime fillestare dhe të vazhduara për forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve të burgjeve dhe shërbimit të provës në lidhje me instrumentet e vlerësimit të shenjave për identifikimin e personave në rrezik, menaxhimin e rasteve dhe shkëmbimin e informacionit.



Masa 1.5.5: Zhvillimi i sesioneve të informimit dhe ndërgjegjësimit të personave që trajtohen në sistemin e burgjeve dhe shërbimin e provës, në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm.

Masa 1.5.6: Këshillime në grup të kryera me individë të burgosur dhe individë të përfshirë në institucionet vendore të shërbimit të provës në lidhje me çështjet e ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 1.5.7: Hartimi i programeve profesionale për individë vulnerabel ndaj radikalizmit në sistemin e burgjeve dhe shërbimit të provës.

Masa 1.5.8: Mbështetja me programe trajnimi për punësim për të rinjtë në rrezik radikalizmi dhe që ndodhen në institucionet penitenciare.

Masa 1.5.9: Hartimi i protokolleve dhe manualeve për përgatitjen e daljes nga burgu apo shërbimi i provës i fëmijëve, të rinjve, grave (grupet vulnerabel) dhe referimi i rasteve me potencial problematik).

Masa 1.5.10: Hartimi i programeve pilot të deradikalizimit dhe riintegritimit në shoqëri të të miturve të radikalizuar pas largimit të tyre nga institucionet penitenciare dhe shërbimit të provës.

Masa 1.5.11: Përfshirja e skuadrave (për ndihmë ligjore falas) pro-bono të studentëve të Fakultetit të Drejtësisë në aktivitete parandaluese dhe informuese për rreziqet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm për individë në institucionet peritenciare dhe Shërbimin e Provës.

Masa 1.5.12: Trajnime të prokurorëve dhe gjyqtarëve për çështje që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Masa 1.5.13: Trajnime informuese me qëllim parandalimin e radikalizmit bazuar në hartën e përditësuar të hotspotëve nga ana e strukturave policore.

Masa 1.5.14: Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve institucionale për të identifikuar nevojat profesionale, teknike, infrastrukturore për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 1.5.15: Kryerja e trajnimeve për punonjësit e patrullës së përgjithshme mbi ndërgjegjësimin kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe shenjat e hershme të radikalizimit, me fokus të rinjtë.

Masa 1.5.16: Trajnime të oficerëve të policimit në komunitet rreth tendencave të radikalizimit, metodave të rekrutimit, radikalizimit.

Masa 1.5.17: Trajnime të oficerëve të pikave kufitare rreth tendencave të radikalizimit, metodave të rekrutimit, radikalizimit dhe mekanizmave të referimit të problematikave të lidhura me këto fenomene.

Masa 1.5.18: Përgatitja e raporteve të vlerësimit për ecurinë e procesit të riintegritimit të familjeve të kthyer nga zonat e rrezikut.

Masa 1.5.19: Zhvillimi i konceptit të koordinatorëve rajonalë duke përcaktuar përgjegjësitë e tyre, procedurat dhe formatet për raportim me qëllim ngritjen dhe fuqizimin e pozicionit të koordinatorëve rajonalë për çështje të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit në komisaritet e policisë, NJVV-të, në të gjithë territorin.

Masa 1.5.20: Bashkëpunim dhe koordinim me strukturat përkatëse me qëllim identifikimin, hetimin dhe analizën e zonave në rrezik për të kuptuar mënyrat e ndikimit, pikat e dobëta në sistemin e Forcave të Armatosura në Republikës së Shqipërisë që çojnë në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.

Masa 1.5.21: Përditësimi i kurrikulës për trajnimin e personelin e Forcave të Armatosura të Republikën e Shqipërisë për format e reja të shfaqjes së ekstremizmit dhe të radikalizimit.

Masa 1.5.22: Kryerja e vlerësimit të kapaciteteve në mjediset shkollore me qëllim identifikimin e rasteve të shfaqjes së ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 1.5.23: Harmonizimi i aktiviteteve të QKEDH me programet ekzistuese për angazhimin e të rinjve në kuadrin e nismës “Shkollat si Qendra Komunitare” në zonat me rrezik të lartë dhe realizimi i tyre me mbështetjen e aktorëve të ndryshëm të shoqërisë civile.

Masa 1.5.24: Krijimi i programeve të ndryshme në shkolla ku janë identifikuar shenja të para të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit me aktivitete që fuqizojnë dhe forcojnë kohezionin social, qëndrueshmërinë komunitare dhe personale kundër ekstremizmit të dhunshëm në komunitete të ndryshme nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Masa 1.5.25: Trajnime të mësuesve për identifikimin dhe menaxhimin e nxënësve që përfshihen në radikalizëm dhe ekstremizëm të dhunshëm.



Masa 1.5.26: Vlerësimi i treguesve socio-shëndetësorë përkundrejtë faktorëve statikë, dinamikë dhe rrethorë që lidhen me zhvillimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit, në zonat/grupet në rrezik më të lartë (personat në rrezik radikalizimi dhe ekstremizmi, personat e identifikuar si të radikalizuar dhe ekstremistë dhe personat në rrezik riradikalizimi duke bashkëpunuar me aktorë të tjerë në nivel lokal)

Masa 1.5.27: Organizimi i trajnimeve kaskadë për personelin e kujdesit shëndetësor/shëndetit publik dhe mbrojtjes sociale si dhe personelin e administratës publike, për njohjen dhe zbatimin e këtyre udhëzuesve.

Masa 1.5.28: Krijimi dhe funksionimi i një rrjeti ToT mbi shëndetin mendor dhe fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm në terma të shkaqeve dhe pasojave dhe të shëndetit mendor të lidhur me këtë fenomen.

Masa 1.5.29: Analizë dhe vlerësim i kriterëve të sigurisë dhe mbrojtjes së infrastrukturave kritike kundër rrezikut potencial të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Masa 1.5.30: Zhvillimi i kapaciteteve të rrjetit të koordinatorëve me qëllim parandalimin e radikalizmit bazuar në aktorët e përfshirë sipas hartës së azhurnuar nga ana e strukturave të Ministrisë së Brendshme.

Masa 1.5.31: Vlerësime, analiza dhe ngritja e kapaciteteve për identifikimin e rreziqeve të financimit të aktiviteteve të propagandës, radikalizmit, nxitjes së ekstremizmit të dhunshëm nga subjekte të ndryshme.

Masa 1.5.32: Ngritja dhe fuqizimi i pozicionit dhe kapaciteteve identifikuese dhe monitoruese të koordinatorëve, për çështje të ekstremizmit të dhunshëm, financimit të terrorizmit dhe proceseve RRR në DVP, Prefektura, NJVV, DPPP, IEVP, Bashkitë dhe në të gjithë territorin.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i seancave të këshillimit në grup të kryera me individë të burgosur dhe individë të përfshirë në institucionet vendore të shërbimit të provës në lidhje me çështjet e EDH të përfunduara.

- Numri i të burgosurve vulnerabël ndaj radikalizmit të cilët kanë përfunduar programet e dedikuara të punësimit.

- Numri i oficerëve të patrullës së përgjithshme të trajnuar çdo vit mbi ndërgjegjësimin kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe shenjat e hershme të radikalizimit, me fokus të rinjtë.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit të punonjësve dhe target grupeve të caktuara lidhur me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm;

- Ulja e ekspozimit të grupmoshave ndaj radikalizimi dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Objektivi specifik 1.6: Analizimi dhe adresimi i faktorëve nxitës për individët që janë në rrezik për t'u radikalizuar apo përfshirë në ekstremizëm të dhunshëm dhe forcimi i komuniteteve vulnerabël përmes përfshirjes së tyre në shoqëri dhe tregun e punës (sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm objektivi specifik nr. 1.2 me masat 1.2.1-1.2.7)

Masa 1.6.1: Zbatimi i programit kombëtar të daljes nga skema e ndihmës ekonomike për përfituesit e ndihmës ekonomike me prioritet në zonat me rrezikshmëri më të lartë ndaj fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm; (<http://qeverisjavendore.gov.al/keshillikonsultativ/ep-content/uploads/2021/01/16.-Programi-Kombetar-per-daljen-nga-skema-e-ndihmes-ekonomike.pdf> (2020–2022 dhe sipas rinovimit të këtij plani)

Masa 1.6.2: Sensibilizimi i bizneseve dhe komunitetit në tërësi me qëllim që të jenë më të hapur dhe joparagjykses ndaj personave të radikalizuar dhe individëve të kthyer nga vendet e luftës në lidhje me çështje të punësimit.

Masa 1.6.3: Ngritja e kapaciteteve për identifikimin, vlerësimin, analizën dhe shkëmbimin e informacionit për faktorët ideologjikë politikë edhe me ndikim të huaj mbi rrezikun e radikalizmit që çon në ekstremizëm të dhunshëm dhe terrorizëm.

Masa 1.6.4: Ngritja e kapaciteteve për identifikimin, vlerësimin, analizën dhe shkëmbimin e informacionit për faktorët nxitës të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm të ngritura mbi stereotipe me bazë fetare që çon në terrorizëm.

Masa 1.6.5: Ngritja e kapaciteteve për identifikimin, vlerësimin, analizën dhe shkëmbimin e informacionit për faktorët socio-ekonomike nxitës të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çon në terrorizëm.

Masa 1.6.6: Fuqizimi i kapaciteteve të anëtarëve të mekanizmit referues të këshillave vendorë të



sigurisë publike mbi radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Masa 1.6.7: Hartimi i një Procedure Standarde Veprimi për fuqizimin e komuniteteve, riintegrimin dhe rehabilitimin e familjeve të kthyer ose të radikalizuara.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i personave, përfitues të ndihmës ekonomike në zonat hot-spot, të përfshirë në programet e punëve publike.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e ndërgjegjësimit të bizneseve për të punësuar individë të kthyer nga vendet e lindjes dhe rritja e përfituesve të ndihmës ekonomike nga programet e punëve publike.

QËLLIMI I POLITIKËS 2: NDËRPRERJA E AKTIVITETEVE TË FAQEVE DHE PLAT-FORMAVE DIGJITALE SI DHE INDIVIDËVE QË TËRHEQIN NJERËZ NË TERRO-RIZËM

Objektivi specifik 2.1: Parandalimi i radikalizimit nëpërmjet internetit

Masa 2.1.1: Krijimi i një sistemi të aksesit të kontrolluar për grup-moshat e reja në site dhe faqe online të cilat mund të kenë përmbajtje propagandiste.

Masa 2.1.2: Krijimi i hapësirave për denoncimin e faqeve/profileve të dyshimta në faqet zyrtare të P.SH, AKCESK, QKEDH etj.

Masa 2.1.3: Zhvillimi i spoteve ndërgjegjëse për t'u shpërndarë te përdoruesit e internetit, nëpërmjet profileve zyrtare të agjencive shtetërore apo faqeve zyrtare të internetit.

Masa 2.1.4: Kryerja e monitorimeve të faqeve të internetit nga agjencitë ligjzbatuese për mesazhe/profile radikale, ekstremiste e terroriste.

Indikatorë të matshëm:

-Indeksi i uljes së ekspozimit të grupmoshave të reja në faqe online me përmbajtje propagandiste.

-Indeksi i rritjes së identifikimit të profileve me përmbajtje terroriste përmes monitorimit të burimeve të hapura.

Rezultate të pritshme:

- Bllokimi i të gjitha faqeve (links; në raste të caktuara edhe domaine) apo i aplikacioneve që në përmbajtje kanë propagandë terroriste, në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike (ofruesit e shërbimit internet – ISP), sipas përcaktimeve ligjore.

- Rritja e kontrollit dhe ulja e ekspozimit të grupmoshave të reja ndaj propagandës që çon në radikalizim përmes internetit dhe faqeve me këtë përmbajtje.

Objektivi specifik 2.2: Rritja e prezencës së strukturave të antiterrorit në mjedisin virtual përmes kontrollit dhe monitorimit të hapësirave virtuale përfshirë darknet-in

Masa 2.2.1: Rritja e kapaciteteve përmes trajnimeve specifike për identifikimin e profileve në rrjete sociale me përmbajtje terroriste

Objektivi specifik 2.3: Parandalimi i radikalizimit dhe rekrutimeve terroriste duke rritur bashkëpunimin bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar dhe me prodhuesit e aplikacioneve online

Masa 2.3.1: Zhvillimi i takimeve bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare

Masa 2.3.2: Lidhja e marrëveshjeve për bashkëpunim brenda fushës

Masa 2.3.3: Pjesëmarrja në konferenca, workshop-e etj.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi rritjes së nivelit të bashkëpunimit bilateral, rajonal dhe ndërkombëtar brenda fushës

Rezultate të pritshme:

- Rritja e numrit të takimeve bilaterale, rajonale dhe ndërkombëtare të zhvilluara.

- Rritja e numrit të marrëveshjeve të lidhura për bashkëpunim brenda fushës për shkëmbimin e informacionit.

- Rritja e pjesëmarrjes në konferenca, workshop-e etj. duke sjellë rritjen e nivelit të informimit dhe ekspertizës.

QËLLIMI I POLITIKËS 3: NJOHJA E KËRCËNIMEVE TË TERRORIZMIT NË VENDIN TONË PËRMES IDENTIFIKIMIT TË HERSHËM TË GRUPEVE TË SYNUARA DHE METODAVE RADIKALE

Objektivi specifik 3.1: Vlerësimi dhe analizimi i faktorëve që çojnë në radikalizim dhe ekstremizëm të dhunshëm

Masa 3.1.1: Hartimi i protokolleve dhe sistemeve të ndarjes së informacionit për të mbledhur, sistemuar dhe ndarë të dhëna nga një gamë e gjerë burimesh, me qëllim që të mundësohen reagime dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 3.1.2: Zhvillimi i protokolleve specifike për personat e radikalizuar në Shqipëri, duke iu përshtatur karakteristikave dhe veçorive që mbart



ky fenomen në vendin tonë dhe shpërndarja e tyre profesionistëve të vijës së parë, për evidentimin dhe sinjalizimin e hershëm të tyre..

Masa 3.1.3: Krijimi i një databaze për rastet e identifikuarra dhe mbledhja e të dhënave për nxënësit e shkollave që shfaqin sjellje me risk të lartë.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së nivelit analitik dhe të përpunimit të informacionit.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e bashkëpunimit në nivel rajonal dhe ndërkombëtar për identifikimin e faktorëve që çojnë individët drejt radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

- Reagime dhe përpjekje parandaluese efektive dhe në kohë ndaj radikalizimit.

QËLLIMI I POLITIKËS 4: ZGJERIMI I KAPACITETEVE OPERACIONALE TË POLICISË DHE KAPACITETEVE TË INSTITUCIONEVE TË INTELIGJENCËS

Objektivi specifik 4.1: Rritja e parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin

Masa 4.1.1: Kryerja e analizave dhe vlerësimeve të riskut.

Masa 4.1.2: Krijimi i profileve të subjekteve të dyshuar për veprimtari radikale/ekstremiste dhe terroriste.

Indikatorë të matshëm

- Indeksi i rritjes së kapaciteteve për vlerësimin e riskut nga radikalizimi.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e parandalimit nëpërmjet zhvillimit të vlerësimeve të riskut, analizave dhe kërkimeve për radikalizimin dhe terrorizmin.

QËLLIMI I POLITIKËS 5: ZHVILLIMI I KOMUNIKIMIT STRATEGJIK

Objektivi specifik 5.1: Shkëmbimi i përvojës dhe ekspertizës me vendet e rajonit

Masa 5.1.1: Zhvillimi i takimeve dhe webinarëve të vazhdueshme me profesionistë nga vendet e rajonit për shkëmbimin e eksperiencave.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së përvojës dhe ekspertizës në fushën e terrorizmit dhe radikalizimit.

Objektivi specifik 5.2: Krijimi i një rrjeti komunikimi të vazhdueshëm për shkëmbimin e informacioneve mes institucioneve dhe strukturave të

përshira me qëllim krijimin e mekanizmave për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm

Masa 5.2.1: Krijimi i kundërnarrativave për terrorizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, duke pasqyruar rreziqet dhe dëmet që këto fenomene i shkaktojnë shoqërisë por edhe trajtimi i grupeve në rrezik dhe shtresave më vulnerabël, për t'u shpërndarë në hapësirat mediatike dhe ato të rrjeteve sociale

Masa 5.2.2: Krijimi i programeve dhe manualeve për ndërgjegjësimin mbi terrorizmin

Masa 5.2.3: Ndërgjegjësim pro sjelljeve të shëndetshme dhe minimizimit të prirjes për të përdorur dhunën për zgjidhjen e çdo konflikti duke zhvilluar:

- sesione informuese me mësues dhe nxënës, zhvilluara nga përfaqësues të organizatës.

- seminare informimi dhe ndërgjegjësimi në klasa.

Masa 5.2.4: Hartimi i broshurave informuese për prindërit mbi njohjen dhe menaxhimin e shenjave të ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 5.2.5: Zhvillimi i aktivitetit informues dhe ndërgjegjësuës “Ditë e hapur edukative dhe ndërgjegjësuës” me nxënës, mësues, prindër dhe përfaqësues të komunitetit

Masa 5.2.6: Zhvillimi i programit “Njohja me konceptin dhe praktikën e ndërmjetësimit dhe zgjidhjes së konflikteve”

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së shkallës së informimit dhe ndërgjegjësimit të shtresave vulnerabël për ekspozim ndaj radikalizimit që çon në terrorizëm

Objektivi specifik 5.3: Komunikimi strategjik dhe kundërnarrativa online e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit (sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm objektivi specifik nr. 2.1 me masat 2.1.1-2.1.28)

Masa 5.3.1: Zhvillimi i anketimeve, mbledhja dhe shkëmbimi i të dhënave nga QKEDH për identifikimin e faktorëve të përhapjes së fenomenit radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm online në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.

Masa 5.3.2: Publikime të raporteve vjetore në faqen zyrtare të QKEDH-së.

Masa 5.3.3: Organizimi i seminareve, forumeve dhe konferencave.

Masa 5.3.4: Zhvillimi i trajnimeve me gazetarët.



Masa 5.3.5: Zhvillimi i tryezave të rrumbullakëta të diskutimit.

Masa 5.3.6: Kryerja e vizitave në terren.

Masa 5.3.7: Organizimi i takimeve rajonale.

Masa 5.3.8: Organizimi i forumeve me dëgjesa publike dhe histori njerëzore.

Masa 5.3.9: Zhvillimi i takimeve me rrjetin e koordinatorëve dhe aktorët e përfshirë për çështjet e parandalimit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 5.3.10: Organizimi i ekspozitës me imazhe (Video/Audio).

Masa 5.3.11: Zhvillimi i aktiviteteve informuese dhe edukuese në institucionet e arsimit parauniversitar.

Masa 5.3.12: Zhvillimi i sesioneve informuese, të parë në këndvështrimin gjinor, me pjesëmarrje të prindërve/komunitetit/nxënësve për njohjen e shenjave të hershme të ekstremizmit dhe radikalizmit.

Masa 5.3.13: Zhvillimi i sesioneve informuese/ndërgjegjësuese me qasje multisektoriale duke përfshirë aktorë të institucioneve të ndryshme në nivel lokal/rajonal në varësi të MSHMS-së, me qëllim njohjen e shenjave të hershme të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 5.3.14: Zhvillimi i leksioneve të hapura në auditorët e universiteteve në kuadër të marrëveshjes me Rektoratin e Universitetit të Tiranës.

Masa 5.3.15: Përfshirja në mënyre aktive e nxënësve me rrezik radikalizimi të ciklit parauniversitar në aktivitete ekstrakurrikulare dhe shkollore ku trajtohen, thellohen në mënyre kreative tematikat e parandalimit të radikalizmit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 5.3.16: Promovimi i “LINJËS SË KUQE” dhe raportimit për përmbajtje të paligjshme dhe propagandim të akteve të dhunës.

Masa 5.3.17: Informimi dhe ndërgjegjësimi i personave që trajtohen në sistemin e burgjeve dhe shërbimin e provës në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin që çon në terrorizëm.

Masa 5.3.18: Ndërgjegjësimi i personelit të FARSH për rrezikun e ekstremizmit të dhunshëm, shenjat e hershme të radikalizimit, dhe kategoritë që janë më të rrezikuara nga ky fenomen.

Masa 5.3.19: Zhvillimi i sesioneve informuese dhe trajnuese me drejtuesit e institucioneve

arsimore parauniversitare, mësuesit, psikologun, oficerin e sigurisë në shkollë ose punonjësin social të shkollës për ndërgjegjësim dhe aftësim për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe identifikimin e shenjave të hershme të ekstremizmit dhe radikalizimit të nxënësit.

Masa 5.3.20: Sensibilizimi i bizneseve dhe komunitetit në tërësi me qëllim që të jenë më të hapur dhe joparagjykses ndaj personave të radikalizuar dhe individëve të kthyer nga vendet e konfliktit në lidhje me çështje të punësimit.

Masa 5.3.21: Komunikim ndërinstytucional për ofrimin e një sërë shërbimesh sociale, shëndetësore (fizike dhe psikologjike), arsimore parauniversitare (arsimi formal dhe joformal), zhvillim profesional.

Masa 5.3.22: Mbulimi në mediumet tradicionale: televizionet dhe radio.

Masa 5.3.23: Mbulimi në mediumet e tjera tradicionale dhe online: gazetatat, revistat dhe mediat (portalet) online.

Masa 5.3.24: Zhvillimi i fushatave ndërgjegjësuese dhe kundër narrativave në rrjetet sociale.

Masa 5.3.25: Ndërtimi i një faqe online si landing page i integruar në websitet e aktorëve kryesore.

Masa 5.3.26: Realizimi dhe prodhimi i produkteve me përmbajtjes audiovizuale.

Masa 5.3.27: Dizenjimi, realizimi dhe prodhimi i produkteve me përmbajtje vizuale.

Masa 5.3.28: Ngritja e strukturës për të monitoruar mediat sociale lidhur me format e shprehjes së ekstremizmit të dhunshëm, radikalizmit që çon në veprime të dhunshme, indoktrinimit, propagandës, rekrutimit dhe analiza e tyre për përgatitjen dhe zhvillimin e kundërnarrativës dhe mesazheve pozitive.

Indikatorë të matshëm:

- Faqja online si landing page i integruar në websitet e aktorëve kryesore ka përfunduar dhe është funksionale.

Rezultate të pritshme:

Integrimi përmes një “landing page” të mesazheve dhe rubrikave kryesore të website, si dhe të rubrikës së denoncimit, të CVE në faqet e Ministrive dhe Agjencive të tjera shtetërore, përfshirë bashkitë e vendit, dizenjimi, arkitektura dhe përmbajtja si një platformë e integruar pritëse e informacionit dhe trafikut ardhur përmes kanaleve të tjera të komunikimit.



QASJA 2: HETIMI I VEPRAVE TË TERRORIZMIT, ZBULIMI DHE GODITJA E TERRORISTËVE/GRUPEVE TERRORISTE DUKE ELEMINUAR KËRCËNIMET E TERRORIZMIT

QËLLIMI I POLITIKËS 6: IDENTIFIKIMI, HETIMI, ZBULIMI E VEPRAVE PENALE NË FUSHËN E TERRORIZMIT DHE FINANCIMIT TË TIJ DHE GODITJA E INDIVIDËVE GRUPEVE TERRORISTE

Kjo do të arrihet nëpërmjet hetimit dhe zbulimit të veprave penale në fushën e terrorizmit dhe financimit të tij duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Bashkëpunimit dhe koordinimit me agjencitë inteligjente e ligjzbatuese SHISH, AISM, Prokurorinë, DPPP-FIU, DP Burgjeve, dhe CVE si dhe institucione që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit

Përmirësimit dhe rritjes sipas nevojës e kapaciteteve njerëzore, profesionale e logjistike të Drejtorisë së Antiterrorit.

Objektivi specifik 6.1: Hetimi i terrorizmit dhe burimeve të tij

Masa 6.1.1: Përgatitja dhe përfaqja e legjislacionit sipas standardeve të BE, në lidhje me luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm bazuar në mangësitë e konstatuara nga analizimi në kuadër të kapitullit 24 dhe 31.

Masa 6.1.2: Rritja e numrit të hetimeve proaktive ndaj individëve/grupeve të dyshuar për veprimtari terroriste dhe financim të tij, nëpërmjet metodave speciale të hetimit

Masa 6.1.3: Rritja e numrit të hetimeve paralele për financimin e terrorizmit për çdo rast referimi për vepra me qëllime terroriste sipas rekomandimit të FAFT/ICRG dhe Moneyval.

Masa 6.1.4: Rritja e numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta me institucionet homologe/partnere ndërkombëtare.

Masa 6.1.5: Kryerja e hetimeve të përbashkëta me agjencitë ligjzbatuese lidhur me individë/grupe kriminale të krimit të organizuar që mund të përfshihen edhe në aktivitete terroriste në Shqipëri, vendet e BE-së dhe më gjerë.

Masa 6.1.6: Shkëmbimi informacionit me homologët e partnerët ndërkombëtar për shtetas shqiptarë e të huaj, pjesë e grupeve të krimit të organizuar që mund të përfshihen edhe në

aktivitete terroriste në Shqipëri, vendet e BE-së dhe më gjerë.

Masa 6.1.7: Zbatimi i praktikave më të mira të vendeve të BE –së për hetimin e financimit të terrorizmit, si dhe kërkesave që rrjedhin nga rezolutat e KS të OKB dhe instrumentet e tjerë ndërkombëtarë në këtë fushë.

Masa 6.1.8: Ndjekja penale e LHT dhe individëve të dyshuar për terrorizëm dhe financimin të tij.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i eficiencës së hetimeve në fushën e terrorizmit

- Indeksi i përputhshmërisë së legjislacionit të brendshëm me legjislacionin e BE për luftën kundër terrorizmit në kuadër të kapitullit 24

- Indeksi i rritjes së hetimit për financimin e terrorizmit paralel me hetimin për krime në fushën e pastrimit të parave

Rezultate të pritshme:

- Realizimi i hetimeve proaktive ndaj individëve/grupeve të dyshuar, për veprimtari terroriste dhe financim të tij

- Referime për terrorizmin dhe financimin e terrorizmit

- Rritja e numrit të hetimeve paralele për financimin e terrorizmit për çdo rast referimi për vepra me qëllime terroriste sipas rekomandimit të FAFT/ICRG dhe Moneyval

- Rritja e numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta me institucionet homologe/partnere ndërkombëtare

- Rritja e numrit të rasteve të parandaluara si pasojë e identifikimit të individëve pjesë e organizatave kriminale ose grupeve të krimit të organizuar që mund të përfshihen edhe në aktivitete terroriste në shqipëri dhe vendet e BE-së dhe më gjerë

- Ndjekja penale e LHT dhe individëve të dyshuar për terrorizëm

Objektivi specifik 6.2: Bashkëpunimi dhe koordinimi me agjencitë inteligjente e ligjzbatuese dhe institucione që kanë detyrime në luftën kundër terrorizmit

Masa 6.2.1: Kryerja e analizave të përbashkëta midis institucioneve të gjurmimit, hetimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për terrorizëm, në funksion të marrjes së masave parandaluese

Masa 6.2.2: Shkëmbimi i informacioneve dhe analizave të përbashkëta ndërmjet Drejtorisë së



Antiterrorit dhe DPPPP, DPT, DPD, dhe institucioneve të tjera ligj zbatuese në vend, për hetimet e veprave penale në fushën e luftës kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së efektivitetit të hetimit, gjurmimit lidhur me grupe kriminale të hetuara e gjykuara për terrorizëm.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e numrit të informacioneve të shkëmbyera mes këtyre agjencive.

- Analiza të përbashkëta pune në funksion të hetimit të terrorizmit.

Objektivi specifik 6.3 Përmirësimi dhe rritja e kapaciteteve njerëzore, profesionale e logjistike të strukturave të antiterrorit

Masa 6.3.1: Trajnimi i vazhdueshëm me praktikat e teknikat më të mira bashkëkohore të strukturave të Drejtorisë së Antiterrorit.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i trajnimeve të strukturave të Drejtorisë së Antiterrorit mbi praktikat e teknikat më të mira bashkëkohore.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e nivelit të ekspertizës dhe kapaciteteve operacionale-hetimore.

QËLLIMI I POLITIKËS 7: PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË MBLEDHJES, RUAJTJES, ANALIZIMIT DHE SHPËRNDARJES SË INFORMACIONIT

Objektivi specifik 7.1: Krijimi i një sistemi të sigurt të komunikimit për transmetimin e informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit

Masa 7.1.1: Përmirësimi i standardeve të sigurisë (fizike, informacionit dhe sigurisë së rrjeteve të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit)

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së sigurisë së transmetimit të informacionit ndërmjet strukturave të përfshira në luftën kundër terrorizmit

Objektivi specifik 7.2: Vlerësimi periodik i nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm

Masa 7.2.1: Hartimi i raporteve periodike të vlerësimit të nivelit të rrezikut/kërcënimit të faktorëve dhe fenomeneve që prodhojnë radikalizëm apo ekstremizëm.

Masa 7.2.2: Vënia në funksion të sistemit të përbashkët të të dhënave dhe gjenerimi i raporteve me vlerë vendimmarrëse.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së cilësisë së analizimit të informacionit

Objektivi specifik 7.3 Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit me agjencitë inteligjente dhe ligjzbatuese në vend dhe ato të huaja me përgjegjësi në luftën kundër terrorizmit për përcaktimin e nivelit të kërcënimit terrorist në rrafshin ndërkombëtar modus operandi dhe ndikimit të tij në Shqipëri

Masa 7.3.1: Shkëmbimi i ndërsjelltë i informacioneve me agjencitë homologe ndërkombëtare mbi modus operandi të terroristëve dhe grupeve terroriste

Masa 7.3.2: Mundësimi i aksesit në raporte apo studime të vendeve të rajonit apo ndërkombëtare për zhvillimet e terrorizmit mbi bazën e marrëveshjeve të bashkëpunimit

Masa 7.3.3: Pjesëmarrje në takime, konferenca ose vizita studimore mbi dinamikën dhe format e reja të kërcënimeve terroriste

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së aksesit në raporte/vlerësime burimeve dhe programe të organizatave ndërkombëtare ose të vendeve të rajonit apo ndërkombëtare për modus operandi të kërcënimit terrorist ndërkombëtar

Objektivi specifik 7.4: Sigurimi i informacionit për terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin, sabotazhin dhe Armët e Dëmtimit në Masë dhe informimi i institucioneve vendimmarrëse, politikëbërëse, institucioneve dhe strukturave të tjera kompetente/përgjegjëse shtetërore dhe të zbatimit të ligjit

Masa 7.4.1: Shkëmbimi i informacionit, përdorimi i burimeve dhe programeve të organizatave ndërkombëtare për zbulimin e terrorizmit, ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, sabotazhit dhe trafikimit të Armëve e Dëmtimit në Masë

Masa 7.4.2: Informimi i strukturave vendimmarrëse mbi problematikat e raporteve të riskut ose zhvillimeve aktuale/të pritshme kombëtare ose të huaja në fushën e terrorizmit

Masa 7.4.3: Propozimi i zgjidhjeve dhe metodave bazuar në ekspertizën mbi zhvillimet dhe metodat bashkëkohore të inteligjencës



Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së shpejtësisë së shkëmbimit të informacionit me efekte vendimmarrëse

Objektivi specifik 7.5: Konsolidimi dhe forcimi i bashkëpunimit me: strukturat e specializuara të Policisë së Shtetit; institucionet e sistemit të sigurisë kombëtare; shërbimet inteligjente të vendeve aleate dhe partnere

Masa 7.5.1: Identifikimi i nevojave për marrëveshje dy ose shumëpalëshe për rritjen e bashkëpunimit në fushën e hetimit të terrorizmit dhe financimit të tij

Masa 7.5.2: Krijimi i rrjetit të pikave të përbashkëta të kontaktit dhe sistemeve elektronike të sigurta për shkëmbime dinamike të informacionit në funksion të hetimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për terrorizmin.

QASJA 3: REAGIMI, REHABILITIMI DHE RIINTEGRIMI

QËLLIMI I POLITIKËS 8: REAGIM NËPËRMJET FORCIMIT TË KAPACITETEVE TË INSTITUCIONEVE PËRKATËSE PËR TËNË PËRGJIGJUR SULMEVE TERRORISTE

Objektivi specifik 8.1: Konsolidimi i kapaciteteve të mbrojtjes civile, në nivelin qendror dhe atë lokal

Masa 8.1.1: Krijimi i kapaciteteve për përbashkëtimin e akteve terroriste brenda Republikës së Shqipërisë përmes trajnimeve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar të personelit të Forcave të Armatosura.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së kapaciteteve të reaguese ndaj sulmeve të mundshme terroriste.

QËLLIMI I POLITIKËS 9: REAGIM NËPËRMJET REDUKTIMIT DHE LEHTËSIMIT TË PASOJAVE TË FENOMENEVE TË RADIKALIZMIT, EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM DHE TERRORIZMIT

Objektivi specifik 9.1: Ngritja e kapaciteteve për menaxhimin e dhënies së ndihmës viktimave të terrorizmit sipas konventës evropiane për kompensimin e viktimave të terrorizmit

Masa 9.1.1: Hartimi i Planit për koordinimin ndërinstitucional në menaxhimin e krizave pas një akti terrorist.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së mekanizmave koordinues ndërinstitucional në menaxhimin e krizave pas një akti terrorist.

Objektivi specifik 9.2: Përmirësim i infrastrukturës dhe ngritja e kapaciteteve të institucioneve publike për rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit (sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm objektivi specifik nr. 3.1 me masat 3.1.1-3.1.14)

Masa 9.2.1: Koordinimi me NJVV për hartimin e protokollit të menaxhimit të rasteve të ekstremizmit të dhunshëm në nivel vendor.

Masa 9.2.2: Konsolidimi i kuadrit normativ për riorganizimin strukturor, rishikimin e misionit dhe përgjegjësisë të QKEDH, funksionimin dhe bashkëveprimin ndërinstitucional të saj me synim rritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e statusit institucional dhe zgjerimin e spektrit të përgjegjësisë të saj.

Masa 9.2.3: Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për parandalimin e radikalizmit online dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 9.2.4: Miratimi i protokollit dhe i aktit administrativ që përcakton institucionet përgjegjëse dhe afatet kohore në zbatimin e masave në trajtim të individët e radikalizuar dhe ekstremistët e dhunshëm.

Masa 9.2.5: Vendosja në funksion të QKEDH i një programi kompjuterik analitik me bazë të dhënash digjitale të dedikuara për përpunim informacioni për rastet dhe profilet që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në interes të analizave për rrezikun ndaj radikalizmit.

Masa 9.2.6: Ngritja e strukturës përgjegjëse në QKEDH për përdorimin e programit kompjuterik analitik me bazë të dhënash digjitale të dedikuara për rastet e ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 9.2.7: Ngritja e kapaciteteve të strukturës përgjegjëse për përdorimin e programit kompjuterik me bazë të dhënash digjitale të dedikuara për rastet e ekstremizmit të dhunshëm.

Masa 9.2.8: Trajnimi i strukturave rajonale dhe vendore të AKPA për përfshirjen e programet e nxitjes së punësimit të personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit;

Masa 9.2.9: Aftësimi i aktorëve të arsimit për të ndihmuar në procesin e deradikalizimit dhe të riintegrimit.

Masa 9.2.10: Zhvillimi i programeve pilot të deradikalizimit dhe riintegrimit që synojnë ndërhyrjet në zonat problematike, për arsimin bazë dhe të mesëm të lartë.



Masa 9.2.11: Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve pilot të deradikalizimit dhe riintegritit që synojnë ndërhyrjet në zonat problematike.

Masa 9.2.12: Ngritja e kapaciteteve dhe ndërveprimet mes administratorëve socialë, NJMF, punonjësve sociale të NJVRN dhe përfaqësuesve të mekanizmit kundër dhunës në familje për identifikimin e hershëm të rasteve të radikalizimit dhe EDH dhe rritjen e bashkëpunimit për adresimin e tyre.

Masa 9.2.13: Koordinimi me NJVV për raportimin pranë QKEDH të rasteve të menaxhuara nga NJVV (vlerësimi fillestar, vlerësimi i thelluar, hartimi i planit të ndërhyrjes, dhe ndjekja e zbatimit të PIN (plani individual i ndërhyrjes) për rastet që shfaqin shenjat e para të radikalizimit.

Masa 9.2.14: Ofrimi i mbështetjes psiko-sociale për fëmijët të kthyer nga zona të luftës të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe fëmijë në rrezik radikalizimi, të identifikuar si të radikalizuar.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i anëtarëve të strukturave rajonale dhe vendore të AKPA të trajnuar për përfshirjen në programet e nxitjes së punësimit të personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit;

- Numri i aktorëve të arsimit parauniversitar, të trajnuar, për të ndihmuar në procesin e deradikalizimit dhe të riintegritit;

- Numri i rasteve (familjeve) të radikalizuara të menaxhuara;

- Numri i fëmijëve të kthyer nga zona të luftës dhe që ndjekin arsimin parauniversitar, të mbështetur me shërbim psiko-social.

Rezultate të pritshme:

- Rritja e numrit të aktorëve shtetërorë të arsimit, që janë trajnuar;

- Hartimi i programve dhe moduleve për të trajnuar AKPA dhe programet për të mbështetur me shërbim psiko-social apo menaxhimin e rasteve;

Objektivi specifik 9.3: Fuqizimi ekonomik i personave të radikalizuar dhe familjeve të kthyer nga vendet e luftës përmes integritit dhe harmonizimit të ndërhyrjeve për kualifikime dhe punësim (sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm objektivi specifik nr. 3.2 me masat 3.2.1-3.2.8)

Masa 9.3.1: Identifikimi dhe referimi i personave në rrezik radikalizimi dhe ekstremizmi për regjistrimin si punëkërkues të papunë, në përputhje me legjislacionin për nxitjen e punësimit.

Masa 9.3.2: “Sigurimi/monitorimi i zbatueshmërisë së programeve të integritit social, të miratuara nga ministritë e linjës, bazuar në nevojat e kategorive vulnerable, sipas legjislacionit në fuqi, për të siguruar riintegritin e plotë të të kthyerve në komunitet”

Masa 9.3.3: Hartimi i protokolleve për përfshirjen e personave të radikalizuar në programet aktive të tregut të punës nëpërmjet shërbimeve të punësimit, programeve të nxitjes dhe programeve të formimit profesional.

Masa 9.3.4: Mbështetje e personalizuar për aplikime për punëkërkim i personave të radikalizuar dhe atyre të kthyer nga zonat e konfliktit.

Masa 9.3.5: Prioritizimi i personave të radikalizuar ose të kthyer nga zonat e konfliktit për përfitimin nga programi i nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit (VKM nr. 348, datë 29.4.2020 për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit).

Masa 9.3.6: Organizimi i trajnimeve (online/ në klasa) në lidhje me sipërmarrjen, hapjen e bizneseve dhe rritjen e biznesit të personave të radikalizuar dhe të kthyer nga vendet e luftës.

Masa 9.3.7: Organizimi i trajnimeve për punonjësit e migracionit (që trajtojnë shtetasit shqiptarë të kthyer dhe të huajt që punojnë) në strukturat e AKPA, për lidhjen ndërmjet radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe kategorive të ndryshme të e/immigrantëve.

Masa 9.3.8: Zhvillimi i seminareve me punonjësit e migracionit të strukturave të AKPA dhe strukturave të MB dhe QKEDH, mbi mënyrën/procedurat e bashkëpunimit kur evidentohen raste të radikalizimit apo ekstremizmit të dhunshëm apo potencialë.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i personave të radikalizuar dhe atyre të kthyer nga zonat e konfliktit të cilët kanë përfituar nga mbështetje e personalizuar për aplikime për punëkërkim.

- Numri i punonjësve të migracionit në strukturat e AKPA që mbulojnë gjithë territorin e vendit, të trajnuar për elementët njohës të personave të radikalizuar apo në risk radikalizimi apo ekstremizmi të dhunshëm.

Rezultate të pritshme:

- Ofrimi i mbështetjes së personave të radikalizuar dhe të kthyer nga zonat e konfliktit për aplikime për punëkërkim.



Objektivi specifik 9.4: Rritja e aksesit të personave të riuintegruar dhe të kthyer nga vendet e luftës në programet e strehimit social (sipas Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm objektivi specifik nr. 3.3 me masat 3.3.1-3.3.2)

Masa 9.3.1: Mbështetja me programe strehimi e familjeve me individë të radikalizuar të kthyer nga vendet e konflikteve.

Masa 9.3.2: Koordinimi me NJVV për ofrim asistence për aplikim dhe plotësimin e dokumentacionit në programet e strehimit social për personat e radikalizuar.

Indikatorë të matshëm:

- Numri i familjeve me persona të radikalizuar dhe/ose familje të kthyer nga lufta, të përfshirë në skemat e strehimit

QËLLIMI I POLITIKËS 10: PËRGATITJA PËR MENAXHIMIN E INCIDENTEVE TERRORISTE QË PËRFSHIJNË PËRDORIMIN E MATERIALEVE KIMIKE, BIOLOGJIKE, RADIOLOGJIKE, BËRTHAMORE DHE EKSPLOZIVE (CBRNE)

Do të hartohet procedura dhe zbatohen programe bashkëkohore ushtrimesh për zhvillimin e aftësive në gatishmërinë, parandalimin dhe përbalimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive, duke vënë në provë të plotë sistemet, praktikat dhe procedurat. Për këtë qëllim të evidentohen praktikat më të mira, të evidentohen pikat e dobëta dhe të sanksionohen ose të përcaktohen reagimet e duhura efikase ndaj një sulmi terrorist me përdorimin e materialeve CBRNE”.

Objektivi specifik 10.1: Reagimi i shpejtë sipas protokolleve ndërkombëtare ndaj incidenteve terroriste që përfshijnë përdorimin e materialeve kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRN)

Masa 10.1.1: Përmirësimi i shkëmbimit të informacionit në rastet e emergjencave ku përfshihen CBRN.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i uljes së kohës së shkëmbimit të informacionit në rastet e emergjencës ku përfshihen kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRNE)

QASJA 4: MBROJTJA

QËLLIMI I POLITIKËS 11: RRIJTJA E NIVELIT TË SIGURISË NË FUSHËN E TRANSPORTIT, TREGTISË, SHKËMBIMIT TË MALLRAVE DHE SHËRBIMEVE

Objektivi specifik 11.1: Reduktimi i rreziqeve që rrjedhin nga transferimet e ndaluara të mjeteve dhe materialeve që mund të përdoren për të kryer një sulm apo akt terrorist

Masa 11.1.1: “Shfrytëzimi i kapaciteteve kombëtare, për zbulimin në kohë të materialeve të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për prodhimin apo përdorimin e Armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyesë, Armëve të Dëmtimit në Masë”

Masa 11.1.2: “Shfrytëzimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative, për zbulimin e rrjeteve financiare kriminale që tentojnë përhapjen e Armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyesë, Armëve të Dëmtimit në Masë”.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional për parandalimin e akteve terroriste që rrezikojnë infrastrukturën kritike në vend

Objektivi specifik 11.2: Rritja e aftësive për të zbuluar aktivitetin terrorist duke përfshirë kontrollin dhe mbrojtjen e materialeve kimike, biologjike, radiologjike, bërthamore dhe eksplozive (CBRNE)

Masa 11.2.1: Mbikëqyrja e angazhimeve të Republikës së Shqipërisë në traktatet ndërkombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe sistemet e lëshimit të tyre, transferimin e armëve konvencionale dhe zbatimi i masave që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave për qëllime ushtarake.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i përbushjes së detyrimeve në traktatet ndërkombëtare që synojnë parandalimin e përdorimit të këtyre mallrave të ndaluara për qëllime ushtarake.

QËLLIMI I POLITIKËS 12: RRIJTJA E NIVELIT TË RUAJTJES DHE MBROJTJES SË INFRASTRUKTURËS KRITIKE

Objektivi specifik 12.1: Hartimi i planeve të bashkëpunimit midis strukturave ligjzbatuese dhe institucioneve përgjegjëse që kanë në administrim infrastrukturën kritike të vendit për parandalimin e akteve të mundshme terroriste

Masa 12.1.1: Bashkëpunimi në ndarjen e informacioneve kritike mbi aktivitete të karakterit terrorist, me agjencitë ligjzbatuese dhe të inteligjencës në vend dhe ato të vendeve partnere dhe anëtare të NATO-s.



Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i rritjes së zbulueshmërisë materialeve të përshtatshme dhe jashtë kontrollit, për prodhimin apo përdorimin e Armëve të zjarrit, lëndëve shpërthyes, Armëve të Dëmtimit në Masë

QËLLIMI I POLITIKËS 13: MBROJTJA NGA KËRCËNIMET TERRORISTE QË CENOJNË

VENDDISLOKIMET/INFRASTRUKTURËN, PAJISJET KRITIKE DHE SISTEMET E MBROJTJES DHE FARSH-së

Objektivi specifik 13.1: Identifikimi i nevojave dhe standardeve të mbrojtjes nga kërcënimet terroriste

Masa 13.1.1: Rishikimi i planeve të mbrojtjes të venddislokimeve, infrastrukturës kritike, sistemeve dhe paisjeve kritike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FARSH.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i përputhshmërisë me standardet evropiane të mbrojtjes së venddislokimeve, infrastrukturës kritike, sistemeve dhe paisjeve kritike të strukturave të mbrojtjes kombëtare.

Objektivi specifik 13.2: Konsolidimi i kapaciteteve informative dhe profesionale-operacionale

Masa 13.2.1: Bashkëpunimi dhe shkëmbimi i informacionit të klasifikuar me strukturat ligjzbatuese të Republikës së Shqipërisë si dhe me ato të NATO-s.

Masa 13.2.2: Realizimi i trajnimeve të vazhdueshme me partnerët për strukturat parandaluese, reaguese dhe pjesëmarrësve në misione paqeruajtëse të FA, në luftën kundër terrorizmit.

Indikatorë të matshëm:

- Indeksi i konsolidimit të kapaciteteve informative dhe operacionale të strukturave të mbrojtjes kombëtare

PJESA III: MASAT PRIORITARE

Plani i veprimit për rastet e akteve terroriste

PJESA IV: ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

4.1 Implementimi/zbatimi i strategjisë

Për të implementuar me efektivitet Strategjinë do të synohet përmbushja e objektivave strategjike, atyre specifike dhe indikatorëve/aktiviteteve nëpërmjet zbatimit të Planit të Veprimit.

4.2 Përgjegjësia dhe angazhimet institucionale

Ministria përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike:

- Të marrë përgjegjësinë e hartimit të nismave për koordinim, si dhe bashkëveprim midis institucioneve të ndryshme të përmendura në këtë strategji lidhur me strategjinë ndërsektoriale të parandalimit të ekstremizmit dhe luftës kundër terrorizmit.

- Të grumbullojë planet e veprimit apo programet e punës të të gjithë institucioneve të tjera dhe t'i bëjë pjesë të kësaj strategjie. Për këtë, të administrohet një dosje të veçantë sipas standardeve, e cila të mbahet nga Drejtoria e Antiterrorit.

- Të ndjekë dhe marrë iniciativën për ripunimin e përshtatjen e strategjive të tjera sektoriale me politikën dhe objektivat e parashikuara në këtë strategji.

- Të mundësojë ngritjen e kapaciteteve me burime njerëzore e logjistike të mirë trajnuara për parandalimin e ekstremizmit dhe luftës kundër terrorizmit me qëllim parandalimin dhe goditjen e këtyre dukurive në Shqipëri.

Policia e Shtetit – është mekanizëm institucional në kuadër të ministrisë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë publike e cila parandalon, zbulon dhe heton, në përputhje me legjislacionin penal dhe procedural penal, veprat penale dhe autorët e dyshuar të kryerjes së tyre.

Drejtoria e Antiterrorit – të hartojë detyra që ndihmojnë në sigurimin e informacioneve dhe masave policore dhe procedurale për parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen dhe reagimin ndaj të gjitha aktiviteteve terroriste.

Drejtoria për Krimet Ekonomike dhe Financiare – të hartojë objektiva dhe aktivitete strategjike në drejtim të përmirësimit ligjor dhe operacional të masave parandalimin dhe goditjen e individëve/grupeve të përfshirë në financimin e terrorizmit, si dhe shënjestrimin e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të tyre.

- **Spektori i Krimeve Kompjuterike** – të hartojë objektiva dhe aktivitete strategjike në drejtim të përmirësimit ligjor dhe operacional të masave për parandalimin dhe goditjen e individëve/grupeve të përfshirë në krimin kibernetik.

- **Zyra Qendrore Kombëtare Interpol Tirana** – të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të



rritjes së bashkëpunimit ndërkombëtar me agjencitë partnere nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta kundër terrorizmit.

- **Zyra Kombëtare Europol Tirana** – të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të rritjes së bashkëpunimit me agjencitë partnere të Europol nëpërmjet rritjes së shkëmbimit të informacioneve dhe numrit të hetimeve dhe operacioneve të përbashkëta kundër terrorizmit.

Drejtoria e Bashkëpunimit Koordinimit Ndërkombëtar dhe Marrëdhënieve me Publikun - Të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor, administrative dhe teknike të masave për bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Departamenti për Sigurinë Publike – të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të zgjerimit dhe rritjes së aftësive të policimit në komunitet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm.

Departamenti për Kufirin dhe Migracionin – të hartojë objektiva dhe aktivitete në drejtim të masave të sigurisë në kufi, mbikëqyrjes së lëvizjes së qytetarëve, migracionit të paligjshëm dhe fluksit të refugjatëve dhe mallrave me përdorim të dyfishtë si dhe armëve të shkatërrimit në masë.

Qendra Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKEDH) – të hartojë programe, punësimit dhe informimit në kuadër të parandalimit përmes policisë në komunitet të ekstremizmit dhe radikalizimit që çon në ekstremizëm si dhe uljen e ndikimit të propagandës ekstremiste në rrjetet sociale dhe rekrutimit në internet, duke shfrytëzuar mediat sociale si kanale të komunikimit për të promovuar narrativa alternative dhe mesazhe pozitive. Në vijim të miratimit të VKM-së nr. 826, datë 26.10.2020 lidhur me procesin e riatdhesimit të shtetasve shqiptarë të rikthyer nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, Qendra CVE ka si detyrim koordinimin ndër-institucional, mbështetjen dhe monitorimin e procesit të riatdhesimit dhe zhvillimin e programeve rehabilituese dhe reintegruese. Të kryejë analiza ligjore dhe funksionale në lidhje me kapacitetet dhe strukturat në fushën e ekstremizmit të dhunshëm, duke identifikuar mangësitë dhe boshllëqet në kapacitete, si dhe përgatitje të kuadrit ligjor dhe institucional për të plotësuar kapacitetet dhe nevojat kombëtare, duke bërë ndryshimet e

nevojshme ligjore, funksionale dhe strukturore të QKEDH.

Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara – të planifikojë detyra për administrimin e pasurive të sekuestruara të subjekteve të shpallura si financuese të terrorizmit, duke bllokuar burimet e të ardhurave të krijuara nëpërmjet tyre.

Ministria përgjegjëse për çështjet e drejtësisë – të planifikojë objektiva dhe aktivitete për bashkëpunimin e nevojshëm mes Prokurorisë, Interpolit dhe autoriteteve të huaja të drejtësisë në çështje që lidhen me luftën kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve – të planifikojë dhe zbatojë detyrat që lidhen me rritjen e sigurisë përreth individëve/grupeve të burgosurve për aktivitete që lidhen me ekstremizmin për të parandaluar ata nga rekrutimi i të burgosurve të tjerë.

Ministria përgjegjëse për çështjet e ekonomisë – të planifikojë dhe zbatojë detyrat që lidhen me aktet ligjore e normative sipas drejtimeve përkatëse të institucioneve në varësi, në funksion të parandalimit të akteve terroriste.

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave – të planifikojë objektiva dhe aktivitete si njësi e specializuar financiare për parandalimin dhe luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si qendër kombëtare e ngarkuar me mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen tek agjencitë e zbatimit të ligjit të të dhënave për veprimtaritë e mundshme të pastrimit të parave të financimit të terrorizmit.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave – të planifikojë detyra bashkëveprimi me strukturat e tjera të zbatimit të ligjit në funksion të garantimit të sigurisë dhe të rendit publik në porte dhe aeroporte, duke përfshirë dhe masat në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve – të planifikojë detyra për identifikimin e rasteve të pastrimit të parave, si dhe të krimeve në fushën ekonomike në kuadër të luftës kundër terrorizmit.

Banka e Shqipërisë – të planifikojë inspektime për subjekte nën juridiksionin e saj, detyra për kontrolluar zbatimin e programeve të luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen – të hartojë detyra të veçanta për arritjen e objektivave



të strategjisë për këtë institucion, sidomos në drejtim të shkëmbimit të informacionit, në krijimin e kapaciteteve dhe asetëve ushtarake, për përdorim të integruar të tyre edhe nga institucionet e tjera shtetërore, si dhe për vënien e tyre në dispozicion të organizmave ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër terrorizimit.

Agjencia e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes – të hartojë objektiva dhe aktivitete për përmirësimin e metodave teknike/speciale për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e informacioneve me qëllim të parandalimit të aktiviteteve terroriste që zhvillohen në dëm të sigurisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe vendeve partnere dhe atyre aleate brenda kuadrit të tyre ligjor. Thellim të marrëdhënieve të bashkëpunimit institucional me agjencitë/institucionet që kanë detyra të luftës kundër terrorizmit brenda dhe jashtë vendit.

Forcat e Armatosura – të hartojë objektiva dhe aktivitete për ndërmarrjen e veprimeve operacionale në raste të incidenteve të ndodhura nga veprimtaria e akteve terroriste.

Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve – të hartojë objektiva dhe aktivitete për zbatimin e regjimit dhe marrëveshjeve ndërkombëtare në fushën e mospërhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile – të kontribuojë në zbatimin e kësaj strategjie nëpërmjet planifikimit të detyrave dhe aktiviteteve, të cilat ndihmojnë për përballimin e emergjencave civile dhe fatkeqësive, të shkaktuara si pasojë e akteve terroriste.

Ministria përgjegjëse për Evropën dhe punët e jashtme:

Të ndihmojë me detyra të veçanta për arritjen e objektivave të kësaj strategjie, sidomos në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me homologët e huaj e organizatat ndërkombëtare.

Ministria përgjegjëse për arsimin dhe sportin:

Të marrë masa për zhvillimin e aktiviteteve mbi evidentimin dhe adresimin e problemeve në komunitet, për mënyrën e zgjidhjes së problemeve sociale, pasi një ndër arsyet e rekrutimit është dhe gjendja ekonomike e vështirë dhe niveli i ulët arsimor.

Ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit:

Të hartojë detyra për ndjekjen dhe të analizojë problemet mjedisore dhe vatrat e rrezikshme nga ku mund të vijnë pasojat infektive të rënda, duke informuar dhe marrë masat për eliminimin dhe parandalimin e përhapjes së pasojave.

Ministria e përgjegjëse për shëndetësinë:

Të hartojë detyra për ndjekje me përparësi funksionimin e sistemit të njoftimit, izolimit apo transportimit (të mostrave biologjike), si dhe analizimin e medikamenteve për parandalimin e sëmundjeve ngjitëse me karakter të veçantë.

Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet – është autoriteti kompetent kombëtar për mbrojtjen nga rrezatimet si dhe organi që rekomandon veprimet mbrojtëse për përballimin e emergjencave radiologjike. KMR në bashkëpunim me IFB dhe DPE dhe nëpërmjet Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Rrezatimeve” të riformulohet “KMR në bashkëpunim me IFBZ. IFBZ verifikon situatat e emergjencës dhe vlerëson ato nëpërmjet Rrjetit Kombëtar të Monitorimit të Rrezatimeve.

Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet – të mbikëqyrë zbatimin e të gjitha rregullave dhe procedurave që lidhen me sigurinë në punën me burime të rrezatimeve jonizuese për shmangien e aksidenteve radiologjike të hartojë dhe ndjekë detyrat në lidhje me sigurinë dhe sigurimin e burimeve radioaktive

Instituti i Fizikës Bërthamore – siguron të gjitha shërbimet e nevojshme teknike dhe shkencore për monitorimin e situatave emergjente gjatë çdo lloji aksidenti radiologjik nëpërmjet skuadrave të tij të emergjencave në terren dhe në laborator si dhe nëpërmjet informacionit të siguruar nga Rrjeti Kombëtar i Monitorimit të Rrezatimeve.

Ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë:

Të hartojë detyra për ndjekje për monitorimin e masave ligjore e normative për parandalimin e përhapjes së rrezikut bioterrorist kryesisht efekteve të sëmundjeve të ndryshme me origjinë mjedisore.

Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK)

Si institucion përgjegjës për hetimin, ndjekjen penale të terroristëve, ndëshkimin përfundimtar të tyre, konfiskimin e pasurisë dhe asetëve të fituara me anë të aktiviteteve terroriste.

Shërbimi Informativ Shtetëror – në përmbushje të misionit të tij ligjor të hartojë detyra



për intensifikim të mbledhjes dhe përpunimit të informacionit në fushën e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit, në funksion të vendimmarrjes strategjike, si dhe të paralajmërimit në kohë të organeve ligjzbatuese. Përgatitja periodike e vlerësimeve analitike mbi kërcënimin nga ekstremizmi i dhunshëm, terrorizmi në të gjitha format që shfaqet, si dhe sulmet hibride nga aktorë/entitete shtetërorë ose joshetëror. Forcimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit me shërbimet partnere dhe strukturat e inteligjencës dhe sigurisë së NATO-s. Të rrisë bashkëpunimin me Policinë e Shtetit dhe strukturat e tjera ligjzbatuese, që janë të përfshira në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë:

Të ndihmojë në planifikimin e detyrave për monitorimin dhe parandalimin e akteve terroriste ndaj infrastrukturës energjetike në vend.

Të hartojë aktivitete për koordinimin dhe zbatimin e masave përkatëse të sigurisë për parandalimin e akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në aviacionin civil, transportin rrugor, hekurudhor dhe portual.

Të hartojë aktivitete në bashkëpunim me mekanizma të pushtetit lokal për parandalimin e akteve dhe ndërhyrjeve të jashtëligjshme në infrastrukturën e furnizimit me ujë të popullatës. Të hartojë aktivitete dhe detyra për ndjekje për monitorimin e masave ligjore e normative për koncesione dhe privatizime në infrastrukturën e rëndësishme në vend.

Të kontribuojë në bashkëpunim me institucionet përkatëse në hartimin e masave normative dhe politikave për mbrojtjen e infrastrukturës kritike, objekteve të rëndësishme kombëtare dhe objekteve të rëndësishme të veçantë.

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor – të hartojë aktivitete për ndjekjen dhe zbatimin e rregullave standarde të kontrollit, duke garantuar kryerjen e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave të rrezikshme, sipas kuadrit ligjor në fuqi në përputhje me standardet evropiane.

Forca e Sigurisë Portuale – të hartojë aktivitete për ndjekje për monitorimin e sistemeve elektronike të kontrollit të hyrjeve dhe daljeve të gjithë personave, si dhe sistemeve automatike të kontrollit të trafikut të mjeteve detare, që futen dhe

dalën në territoret e porteve të Shqipërisë.

Autoriteti Aviacionit Civil – të hartojë dhe të mbikëqyrë aktivitetet që lidhen me organizimin e sigurisë në aviacionin civil në zbatim të legjislacionit kombëtar në fuqi dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Të ndërmarrë masat e nevojshme për zbatimin e Programit Kombëtar të Sigurisë në Aviacionin Civil.

Inspektorati qëndror:

Drejtoria e Inspektimit Hekurudhor – të hartojë aktivitete për ndjekje për forcimin e mekanizmave për sigurinë dhe mbrojtjen e instalimeve kryesore, impianteve, objekteve të rëndësishme dhe mjetet e transportit publik (trena) për parandalimin e akteve terroriste.

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP) – si institucioni rregullator dhe koordinues i rrjeteve të shpërndarjes së shërbimeve të komunikimeve elektronike, kryesisht shërbimeve të internetit dhe të telefonisë, të mbikëqyrë sigurinë e rrjeteve fizike dhe infrastrukturave të internetit dhe telefonisë nga sulme të gjithfarëlojshme, përfshirë këtu edhe ato me synime terroriste, me qëllim parandalimin e cenimit, paralizimit apo keqpërdorimit të rrjeteve dhe shërbimeve fizike përmes të cilëve personat juridikë, publikë apo privatë, si edhe qytetarët, kanë akses të pandërprerë dhe cilësor në përdorimin e internetit dhe të telefonisë.

4.3 Llogaridhënia dhe raportimi

Llogaridhënia

Ministria e Brendshme është institucioni përgjegjës që udhëheq hartimin e kuadrit strategjik dhe politikave në fushën e parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit, si edhe koordinimin dhe bashkërendimin e institucioneve të përfshira në këtë strategji.

Përfaqsa dhe rishikimi i dokumentit strategjik do të jetë sipas kërkesave të VKM nr. 290, datë 11.4.2020, “Për krijimin e bazës së të dhënave shtetërore të sistemit informatik të planifikimit të integruar (SIPI/IPSIS), për të siguruar përputhshmërinë me Sistemin IPSIS”.

Procesi i llogaridhënies, monitorimit dhe analizës vlerësuese do të bëhet nga strukturat koordinuese, në nivel kombëtar, si më poshtë:

- Grupi i menaxhimit të integruar të politikave (GMIP);



- Komiteti Drejtues Sektorial (KDS) për çështjet e rendit dhe sigurisë publike, i cili do të shqyrtojë dhe miratojë raportet në zbatim të politikave dhe objektivave të përcaktuar në këtë dokument strategjik.

- Zëvendësministri/at përgjegjës në rolin e koordinatorëve për çështjet e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Ministrinë e Brendshme për çdo orientim/miratim në nivel politik për inicimin, rishikimin dhe zhvillimin e politikave në këto fusha gjatë zbatimit të kuadrit strategjik.

Monitorimi

Monitorimi dhe vlerësimi i punës së institucioneve dhe strukturave që kanë detyrime për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit do të shërbejë për të ndjekur ecurinë e strategjisë, për të vlerësuar shkallën e realizimit të politikave, objektivave të saj dhe përmbushjes së masave dhe aktiviteteve.

Monitorimi i Planit të Veprimit i luftës kundër terrorizmit dhe i Planit të Veprimit për parandalimin dhe kundërshtimin e ekstremizmit të dhunshëm do të kryhet nga grupi për menaxhimin e integruar të politikave (GMIP), të miratuar me urdhrin e kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

Procesi i Monitorimit të Planit të Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit do të koordinohet nga struktura përgjegjëse për hartimin dhe koordinimin e strategjive të rendit dhe sigurisë publike në Ministrinë e Brendshme dhe Plani i Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm do të koordinohet nga institucioni përgjegjës që ndjek çështjet e ekstremizmit të dhunshëm në Ministrinë e Brendshme sipas legjislacionit në fuqi.

Me synim garantimin e përmbushjes së objektivave strategjike bazuar në këtë dokument strategjik, do të merren masat e mëposhtme:

- Do të monitorohen treguesit e përcaktuar në strategji;

- Do të rekomandohen ndryshime në programet sektoriale, duke pasur parasysh arritjet, rrethanat, risqet dhe rreziqet si dhe eksperiencat e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet

e progres raporteve të Bashkimit Evropian;

- Do të sigurohen konsultime me palët e interesit, përfshirë shpërndarjen sistematike të informacionit për publikun;

- Do të jepet kontribut në rritjen e konsistencës dhe integritetit të politikave dhe masave të sigurisë në të gjitha nivelet e administrimit, si dhe në përdorimin më të mirë të burimeve.

Në kuadër të zbatimit të objektivave dhe masave të planeve Monitorimi do të kryhet bazuar në raporte 6-mujore dhe vjetore për monitorimin dhe koordinimin e zbatimit të objektivave dhe masave të planeve të veprimit.

Përmirësimet në sistemin e monitorimit dhe vlerësimit synojnë të lehtësojnë/ndihmojnë në përafrimin e kuadrit strategjik dhe prioritetëve në fusha të ndryshme dhe të informojnë për politikën e vendit të lidhura sigurinë në komunitet. Fuqizimi dhe zgjerimi i kuadrit statistikor në institucionet përgjegjëse do të lehtësojë hartimin e politikave bazuar në evidenca/ të dhëna, si dhe do të mundësojë vlerësimin objektiv për përmbushjen e objektivave.

Raportimi

Institucionet duhet të raportojnë periodikisht për realizimin e masave, me periodicitet 6-mujor në Sistemin Informativ për Planifikimin Strategjik të Integruar (IPSIS) në Këshillin e Ministrave dhe në Sekretariatën Teknik Ndërinstitucional.

Të gjithë institucionet të ngarkuara me zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit të Ekstremizmit të dhunshëm dhe luftës kundër terrorizmit, do të hartojnë raporte mbi bazë 6-mujore dhe njëvjeçare në zbatim të detyrimeve të përcaktuara në këto dy plane veprimi, si dhe do të hedhin të dhëna në sistemin IPSIS. Mbledhja, përpunimi, analiza e raporteve periodike 6-mujore dhe njëvjeçare për zbatimin e Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm do të koordinohet nga struktura/institucioni përgjegjës për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm, duke respektuar kërkesat e sistemit IPSIS dhe procedurat përkatëse administrative. Ky raport i hartuar sipas kërkesave të sistemit IPSIS, si edhe gjetjet dhe rekomandimet e tij, duhet t'i përcillen strukturës përgjegjëse për hartimin dhe koordinimin e strategjive në fushën e rendit dhe sigurisë publike në Ministrinë e Brendshme, për t'u integruar me raportin përfundimtar të monitorimit të strategjisë.

Ministria e Brendshme do të jetë institucioni



lider, i cili do të mbledhë, përpunojë dhe analizojë raportet periodike 6-mujore dhe 1-vjeçare që do të përcillen nga të gjitha institucionet e ngarkuara në përmbushje të objektivave dhe masave përkatëse të parashikuara në planin e veprimit kundër terrorizmit.

Komiteti Drejtues Sektorial “punët e brendshme”, drejtuar nga ministri i Brendshëm, në zbatim të pikës 6 dhe 7, të urdhrit të Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”, do të shqyrtojë, diskutojë dhe miratojë raportet e progresit, të monitorimit të arritjes së synimeve dhe prioritetëve në zbatim të këtij dokumenti strategjik dhe të dy planeve të veprimit shoqëruese. Në vijimësi të takimeve të zhvilluara KDS analizon situatën e përmbushjes së detyrimeve nga çdo institucion përgjegjës duke bërë dhe sugjerimet përkatëse për përmirësim.

Një vlerësim përfundimtar, pas përfundimit të periudhës së zbatimit, do të analizojë të gjithë strategjinë dhe ndikimin e saj të përgjithshëm, ku do të vlerësohen rezultatet e masave të ndërmarra, burimeve të investuara dhe masën në të cilën janë arritur efektet e pritura. Vlerësimi përfundimtar do të kryhet duke analizuar të dhënat nga burime të ndryshme, duke përfshirë edhe gjetjet e monitorimit të performancës dhe vlerësimit të ndikimit të programeve aktive të sigurisë në komunitet. Po në këtë kuadër do të shërbejnë edhe raportet e vlerësimit të impaktit, si dhe raporte e studime të kryera nga shoqëria civile dhe donatorët.

Monitorimi i brendshëm do të vlerësojë progresin e bërë duke u mbështetur tek ecuria e indikatorëve:

Si indikatorë të brendshëm do të jenë indikatorët e parashikuar sipas objektivave specifike.

Si indikatorë të jashtëm do të jenë:

- vlerësimet e publikut, të qytetarëve dhe të bizneseve të ndryshme nëpërmjet matjes së perceptimit të publikut duke përdorur pyetësorë, intervista dhe organizuar forume të hapura;

- vlerësimet e institucioneve ndërkombëtare, në raporte periodike apo buletine; vlerësimet e vendeve të rajonit për treguesit e minimizimit të krimit të terrorizmit në Shqipëri.

Qeveria do të marrë në analizë punën e institucioneve të përmendura në këtë strategji në

drejtim të luftës kundër krimit të terrorizmit çdo vit, si dhe do të bëjë publike arritjet pas çdo fazë të implementimit të objektivave e planeve të veprimit, si dhe pasqyrojë arritjet kundër krimit të terrorizmit.

PJESA V. PLANET E VEPRIMIT DHE BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIM

Efektet financiare përllogariten nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planeve të Veprimit 2023–2025, në mënyrë të detajuar.

Ky kapitull përshkruan shpërndarjen në vija të përgjithshme të burimeve financiare që financojnë produktet e Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planeve të Veprimit 2023–2025. Efektet financiare janë përllogaritur nga çdo institucion bazuar në implementimin e aktiviteteve të masave përkatëse që janë të parashikuara në Planin e Veprimit të kësaj Strategjie. Efektet financiare përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara, si dhe nga buxheti i donatorëve për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Parandalimit të Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftës kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planeve të Veprimit 2023–2025, në mënyrë të detajuar.

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu Programin Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 dhe atë 2023–2025, si dhe konsultimet me institucionet e përfshira. Planet e Veprimit 2023–2025 janë shoqëruar me një kostim analitik të secilës masë në përmbushje të objektivave specifike.

Strategjia implementohet përmes dy planeve të veprimit përkatësisht Planit të Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planit të Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2023–2025. Kostot dhe shpenzimet janë detajuar në planet respektive të veprimit sipas programeve buxhetore dhe kodeve të produkteve të PBA 2023–2025. Kosto e Planit të Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit ka



ndryshuar si pasojë e ndryshimit të afateve të aktiviteteve të cilat fillojnë nga viti 2023 dhe shtrihen deri në vitin 2025. Gjithashtu bazuar në ndryshimin e institucionit përgjegjës dhe rishikimit të masave të parashikuara në programin buxhetor të Prokurorisë së Përgjithshme duke i përcaktuar ato tashmë mbi bazën e programit buxhetor “Veprimtaria e SPAK 03390” të Strukturës së Posaçme kundër Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit (SPAK), kurse programet buxhetore të institucioneve të tjera mbeten të pandryshuara.

I. Kostoja totale e strategjisë


Kosto totale e dy Planeve të Veprimit e integruar është në vlerën 2,363,960,315 lekë, ku 99% (ose 2,361,033,002 lekë) e të cilit financohet nga PBA 2023–2025 dhe vetëm 1% është me mbështetje nga donatorët. Aktivitetet e

parashikuara janë të financuara nga programet buxhetore të institucioneve përgjegjëse dhe nuk ka hendek financiar.


Financimi i Planeve të Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit dhe Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm për vitet 2023–2025 (në lekë) dhe në euro paraqitet si më poshtë:

	LEKË	EURO
KOSTO TOTALE INDIKATIVE	2,363,960,315	19,219,190
PBA 2023–2025	2,361,033,002	19,195,390
FINANCIM I HUAJ	2,927,313	23,799
HENDEK FINANCIAR 2023–2025	0	0

KOSTO E PLANIT TË VEPRIMIT NDARJA E SHPENZIMEVE



Të gjitha kostot e aktiviteteve janë pothuajse kosto korrente.



Sipas qëllimeve të politikave kostimi i Planeve të Veprimit të integruar përkatësisht: Planit të Veprimit të Luftës kundër Terrorizmit 2023–2025 dhe Planit të Veprimit të Parandalimit dhe Kundërshtimit të Ekstremizmit të Dhunshëm 2023–2025 paraqitet si më poshtë vijon:

QËLLIMET E POLITIKAVE	NATYRA E KOSTOVE	KOSTOT TOTALE 2023–2025	PLANIFIKUAR NË PBA 2023–2025 BUXHETI DHE DONATORËT	HENDEKU FINANCIAR 2023–2025
Qëllimi i politikës 1: Mbajtja e kërcënimit terrorist në nivel “të ulët”	Korente	369,067,601	369,067,601	0
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i politikës 2: Ndërprerja e aktiviteteve të faqeve dhe platformave dixhitale si dhe individëve që tërheqin njerëz në terrorizëm	Korente	458,503,800	458,503,800	0
	Kapitale	0	0	
Qëllimi i politikës 3: Kuptimi i kërcënimeve të terrorizmit në vendin tonë përmes identifikimit të hershëm të grupeve të synuara dhe metodave radikale.	Korente	303,019,200	303,019,200	0
	Kapitale	0	0	
